



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në
“Infermieri Kirurgjikale”**

ofruar nga

Institucioni i Arsimit të Lartë “Albanian University”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Asoc. Enkelejd Mëshilli

2. Doc. Dr. Julian Kraja

Korrik/2024

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” ofruar nga
Institucioni i Arsimit të Lartë “Albanian University”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Albanian University
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASh Nr. 479, Prot. datë 10.12.2012
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Nr. 6313/2 Prot. datë 18.07.2018
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	UMASR Nr. 405, datë 28.10.2020
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA Nr. 58, datë 05.07.2019
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit akademik
10	Kreditet në total (ECTS):	60 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	16 PAE/11 PAK v.a. 2022-2023 16 PAE/10 PAK v.a. 2021-2022 11 PAE/10 PAK v.a. 2020-2021
18	Numri i studentëve:	93 studentë v.a. 2021-2022 68 studentë v.a. 2020-2021 98 studentë v.a. 2019-2020
19	Komente / të tjera:	-



PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës

Albanian University (AU) është një Institucion jo publik i Arsimit të Lartë i krijuar me Vendimin e Ministrisë së Arsimit Nr. 197 datë 10.04.2004 dhe më pas riorganizuar me vendimin Nr. 603 datë 24.03.2011. AU bazon veprimtarinë e vet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë (neni neni 57, pika 6,7) dhe në Ligjin e Arsimit të Lartë nr. 80/2015. AU është akredituar me VBA Nr. 55, datë 26.05.2022. AU ka në përbërjen e vet tre (3) Njësi Kryesore dhe dhjetë (10) Njësi Bazë. Albanian University” ofron 44 programe studimi në tre cikle, përkatësisht: 16 programe studimi të ciklit të parë “Bachelor”; 22 programe studimi të ciklit të dytë, 12 “Master profesional”, 7 “Master i shkencave” dhe 3 programe të integruara të studimit të ciklit të dytë “Master i shkencave”; 6 programe studimi të ciklit të tretë, 4 “Studime të Doktoratës” dhe 2 “Studime Specializuese Afatgjata”.

Njësitë Kryesore të Albanian University janë:

- Fakulteti i Shkencave Mjekësore;
- Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike;
- Fakulteti i Shkencave Shoqërore.

Fakulteti i Shkencave Mjekësore ku ofrohet dhe programi i studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”, ka në përbërjen e vet:

- Departamentin e Stomatologjisë;
- Departamenti e Farmacisë;
- Departamenti e Infermierisë dhe Fizioterapisë.

Në varësi të Fakultetit të Shkencave Mjekësore është dhe Klinika Universitarre dhe Klinika e Fizioterapisë.

Departamenti i Infermierisë ofron 4 programe studimi të cilat janë Bachelor në “Infermieri”, Bachelor në “Fizioterapi”, Master Profesional në “**Infermieri Kirurgjikale**” dhe Master Profesional në “Terapi manuale”. Departamenti funksionon si njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore. Departamenti nxit, programon, bashkërendon, zhvillon, organizon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë kërkimore-shkencore, për programet respektive të studimit që ofron. Vizioni i Departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë në Albanian University është të jetë lider në drejtimin dhe transformimin e shkencës së infermierisë në Shqipëri, si dhe mënyrën se si mësohet dhe praktikohet infermieristika. Programi i studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” ofrohet që prej vitit 2013 bazuar në Vendimin Nr. 479, Prot. datë 10.12.2012. Programi i studimit është akredituar me VBA Nr. 32 datë 19.05.2017 dhe riorganizuar me Vendimin Nr. 6313/2 Prot. datë 18.07.2018.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Përshkrim përmbledhës

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Bachelor në “Infermieri” që ofrohet nga Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë të Fakultetit të Shkencave Mjekësore në Albanian University, filloi me marrjen e dokumentacionit të ofruar nga institucioni, si dhe ndarjen e punës për përgatitjen e pyetjeve dhe kërkesave për dokumentacion shtesë. ASCAL bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga AU, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm.

Në kuadër të procesit të jashtëm të vlerësimit është përgatitur agjenda nga ASCAL dhe është kryer vizita në datat 14-15 Dhjetor 2023. Dy ekspertët e përzgjedhur shoqëroheshin nga një specialist i ASCAL. Grupi i vlerësimit të jashtëm kishte në përbërje Prof. Asoc. Enkelejd Mëhilli dhe Dr. Julian Kraja. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm, ky grup pune u asistua edhe nga Koordinatorja Teknike e ASCAL, Znj. Aviola Bardhi. Për arsye të një impenjimi nga MAS, Znj. Bardhi u zëvendësua për takimin në Institucion nga Znj. Rajna Lila.

Bazuar në agjendën e përgatitur nga ASCAL u zhvilluan takimet me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe të Njesisë Bazë, grupin e vlerësimit të brendshëm, anëtarë të stafit akademik dhe studentët. Paralelisht, u zhvilluan dhe takime me përfaqësues të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave, me përfaqësues të Komisionit për Kurrikulat dhe Mësimin, me përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore, me përfaqësues të Zyrës së Koordinimit dhe mbështetjes ndaj studentit, me përfaqësues të Zyrës së Koordinimit të Kërkimit shkencor dhe Botimeve akademike, me përfaqësues të zyrës së Karrierës dhe Alumnit dhe me sekretarinë mësimore.

Paralelisht, u zhvillua vizita në ambientet e Fakultetit. Gjatë vizitës në Institucion u panë klasa, laboratorë të ndryshëm si dhe biblioteka. Kohëzgjatja e takimeve ishte ajo e parashikuara.

Me përfundimin e takimeve, GVJ takoi Drejtuesin e Departamentit ndërsa eksperti i ASCAL do të informonte koordinatorin Institucional mbi disa dokumenta shtesë. Në përfundim të vizitave, ekspertët në bazë të dokumentacionit të dorëzuar, takimeve të zhvilluara si dhe vizitës në ambientet e Institucionit hartuan Raportin e Vlerësimit të Jashtëm.

Nga hartimi i RVB dhe dokumentacioni i dorëzuar, GVJ konstaton se:

1. Në shumë raste nuk jepeshin evidenca për ato që raportoheshin;
2. Evidenca të cilat përshtateshin për më shumë se një fushë nuk raportoheshin;
3. Anëtarët e GVB nuk kanë njohuri të mira të Rregulloreve pasi në disa raste raportonin në RVB gjëra të kundërta me ato në Rregulloret.

Me datë 19.06.2024, GVJ dergoi draft RVJ-në nëpërmjet sistemit në Institucion dhe me datë 28.06.2024, po nëpërmjet sistemit, IAL solli komentet e saj. GVJ pasi mori në shqyrtim komentet e IAL-së doli në përfundimin si më poshtë:

Komenti 1

GVJ e konsideron të rëndësishëm rritjen e numërit të infermierëve me tituj dhe grada. Është e vërtetë që ka një mungesë në treg dhe kjo u konfirmua dhe në takimin e zhvilluar me autoritetet drejtuese. GVJ e ka pasqyruar këtë edhe në raportin e përgatitur.

Komenti 2

Ju falenderojm për vënien në dispozicion të Rregulloreve përkatëse. GVJ ka bërë ndryshimet e nevojshme në draft raportin.

Komenti 3

GVJ vlerëson pozitivisht marrëveshjet aktuale të Institucionit, gjë që e ka përmendur dhe në raportin e përgatitur. Në raportin vjetor të Njesisë Bazë nuk raportohet asnjë marrëveshje me **IAL brenda apo jashtë vendit**. Evidenca 1.12 raporton mbi marrëveshjet ku studentët mund të zhvillojnë praktikatat e tyre. Këtë ka raportuar GVJ në draft raportin e dërguar.

Komenti 4

GVJ konsideron të rëndësishme hartimin e raporteve më analitike mbi përfitimin e marrëveshjeve nga ato. GVJ konsideron se *Evidenca 1.17* duhet të detajohet mbi përfitimet nga këto marrëveshje duke përfshirë numërin e studentëve që kanë kryer praktikën, rezultatet e të nxënit si dhe problematikat e ndryshme. Kjo do jepte mundësinë për një panoramë më të qartë të përfitimeve nga marrëveshjet.

Komenti 5

GVJ ka raportuar nenin 10 të Rregullores së departamentit mbi koordinatoren e programit të studimit. GVJ konfirmon që AU përcakton koordinatoren e programit të studimit. Ekspertët e jashtëm raportojnë po ashtu që studentët nuk ishin në dijeni sipas takimit të zhvilluar.

Komenti 6

GVJ nuk konsideron se AU nuk e ka dokumentacionin e nevojshëm. Kjo është e qartë në raportin e hartuar. GVJ në takimet e zhvilluara vërejtë se disa nga stafi akademik nuk ishin në dijeni. Në

mendimin tonë, është e rëndësishme që stafi akademik të informohet rregullisht mbi dokumentacionin e Institucionit.

Komenti 7

GVJ konfirmon se në nenin 10 citohet mbi kriteret dhe procedura e pranimit të studentëve. Në II3, Kriteri 3, GVJ ka raportuar se modalitetet specifikohen në Rregulloren e Regjistrimeve dhe Transferimeve. Kjo është e qartë në draft raport. GVJ ka raportuar se neni 13 përmend por jo me detaje procedurën e transferimin, gjë që përmendet në Rregulloren specifike.

Komenti 8

GVJ duke marrë parasysh konfirmimin nga AU që titullarët firmosin ponderitmet e lëndëve dhe jo çdo lëndë, ka bërë ndryshimet e nevojshme.

GVJ vlerëson se një pjesë e syllabuseve kishin literaturë të vjetër dhe sugjerohet që literatura të përditësohet. Kjo është diçka që u diskutua dhe në takimin e zhvilluar me stafin akademik. Po ashtu, pavarësisht se në takimin me stafin akademik dhe studentët u përmend se u jepen studentëve artikuj/punime të ndryshme të pedagogëve, ato sugjerohet të pasqyrohen në syllabus.

Komenti 9

GVJ raporton mbi diskutimet e zhvilluara në Institucion. Paralelisht, propozon se procedura e përditësimit të programit duhet formalizuar dhe të evidentohet. Egzistenca e pyetësorëve është pozitive por mënyra se si përgjigjet e studentëve përdoren në pëditësimin e programit duhet të formalizohet (dmth procedura e mëtejshme).

Komenti 10

GVJ ka konfirmuar në raportin e dërguar që Institucioni mundohet të mbaj kontakte me alumni. GVJ mendon se nuk janë përfshirë në mënyrë aktive alumni në përmirësimin e programit të studimit. Nuk u raportua si u përdor pyetësori i alumni në përmirësimin e programit të studimit.

Komenti 11

GVJ vlerëson se një pjesë e syllabuseve kishin literaturë të vjetër dhe sugjerohet që literatura të përditësohet. Kjo është diçka që u diskutua dhe në takimin e zhvilluar me stafin akademik. Paralelisht, GVJ konsideron se është e nevojshme pasurimin e bibliotekës së AU.

Komenti 12



GVJ raporton mbi diskutimet e zhvilluara në Institucion. Paralelisht, propozon se procedura e përditësimit të programit duhet formalizuar dhe të evidentohet. Egzistenca e pyetësorëve është pozitive por mënyra se si përgjigjet e studentëve dhe alumni përdoren në pëditësimin e programit duhet të formalizohet (dmth procedura e mëtejshme).

Komenti 13

GVJ raporton atë që raportuan studentët në takimin e zhvilluar. “*Studentët raportuan se nuk janë përfshirë në përmirësimin e programit të studimit*”.

Komenti 14

GVJ vlerëson pozitivisht komunikimin e vazhdueshëm me UISH për të dhënat statistikore mbi kalueshmërinë e studentëve. GVJ vlerëson se takimet apo komunikimet me UISH duhet të formalizohen dhe të përfshihen dhe ata në përmirësimin/përditësimin e programit të studimit.

Komenti 15

GVJ vlerëson se një pjesë e syllabuseve kishin literaturë të vjetër dhe sugjerohet që literatura të përditësohet. Kjo është diçka që u diskutua dhe në takimin e zhvilluar me stafin akademik. Paralelisht, GVJ konsideron se është e nevojshme pasurimin e bibliotekës së AU.



SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr., datë janë:

Rekomandimet e Bordit të Akreditimit Rekomandimet në zbatim të vendimit të Bordit të Akreditimit Nr. 58. datë 05.07.2019, "Për akreditimin periodik të programit të studimit të ciklit të dytë, Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale" të Universitetit Privat "Albanian University" janë si vijon:

1. Institucioni të pasurojë e përditësojë literaturën në funksion të realizimit të këtij programi.
2. Institucioni të rrisë angazhimin e stafit akademik në projekte ndërkombëtare apo programe shkëmbimi në funksion të kualifikimit të stafit akademik dhe rritjes së cilësisë në mësimdhënie.

II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

Në bazë të rekomandimeve të lëna nga grupi i ekspertëve, RVB-në e Institucionit, dokumentat/evidencat mbështetëse si dhe takimet e zhvilluara në Institucion, GVJ konkludon si më poshtë:

1. Për rekomandimin 1, GVJ vëren se Institucioni ka bërë përpjekje për përmirësim dhe plotësim të rekomandimit. Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar, biblioteka është pasuruar me literaturë e cila përfshin libra të huaja si dhe botime të Albanian University. Paralelisht, libra të ndryshme i janë shtuar bibliotekës së AU. Në disa raste librat e përfshirë janë të viteve të kaluara. Pavarësisht përpjekjeve që AU ka bërë për të plotësuar këtë rekomandim, GVJ konsideron se biblioteka duhet të pasurohet rregullisht me literaturë bashkëkohore. Nga dokumentat e dorëzuara, kërkesa e fundit për pasurimin e bibliotekës ishte viti 2018. Drejtuesit e Njesisë Kryesore/Bazë e justifikuan këtë për shkak të librave on-line. Stafi dhe studentët e AU kanë akses në biblioteka on-line. GVJ konsideron se ky rekomandim është **Përbushur Kryesisht**.
2. Për pikën 2 Institucioni raporton se ka marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e L'Aquila në Itali (R.2.1) me të cilin ka shkëmbime dhe aktivitete të përbashkëta. Kjo marrëveshje është nënshkruar në vitin 2015 dhe është në fuqi që prej atehere. Institucioni **nuk raporton marrëveshje të tjera** pas vendimit të akreditimit të vitit 2019. AU raporton se në periudhën 2019-2023 ka implementuar disa projekte kërkimore (Evidencë R.2.2) ndërsa është munduar të rrisi numrin e marrëveshjeve Erasmus për mobilitete me partner European. Numri i marrëveshjeve Erasmus është rritur dhe në bazë të dokumentave shtesë të depozituara nga AU, raportohen 3 marrëveshje ndër-institucionale për shkëmbimin e stafit akademik dhe studentëve (Evidencë shtesë Nr. 1). Pavarësisht këtyre përpjekjeve, **stafi akademik dhe studentët nuk kanë përfitime ende**. Institucioni duhet të punoj më shumë për të rritur numërin e marrëveshjeve por edhe implementimin

e tyre me shkëmbime stafi dhe studentësh. GVJ konsideron se ky rekomandim është ***Përbushur Kryesisht.***



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programet e studimit që ofrohen nga Albanian University (AU) nuk bien ndesh me interesat kombëtare. AU vepron në bazë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015 si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore. Një nga misionet e AU (Statuti I AU, neni 2) është të krijojë, të transmetojë të zhvillojë e të mbrojë dijet me anë të mësimdhënies, të ndihmoj zhvillimin ekonomik në nivel kombëtar dhe rajonal dhe të kontribuojë në rritjen e standardeve të demokracisë e të qytetërimit të shoqërisë me qëllim përgatitjen e të rinjve. Evidenca: <ul style="list-style-type: none">- <i>Evidenca 1.1 Statuti i AU.</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” është hartuar dhe ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore. AU ka si mision të ofrojë shërbime në përputhje me misionin e vet si dhe të ofroj programe studimi në të tre ciklet e studimit. Një nga objektivat kryesor të AU është mësimdhënia, kurrikulat dhe mësimnxënia me në qendër formimin e studentëve. Kjo arrihet përmes formimit të specialistëve në fushën e shëndetësisë. Ky program studimi ofrohet në përputhje me misionin, qëllimet dhe strategjinë e Institucionit. Kjo pikë përmendet edhe në Rregulloren e programit të studimit (neni 4, pika 1). Evidenca: <ul style="list-style-type: none">- <i>Evidenca 1.1 Statuti i AU;</i>- <i>Evidenca 1.7 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”;</i>- <i>Evidenca 1.8 Strategji e zhvillimit Institucional 2023-2028.</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet	Strategjia e AU ka disa objektiva specifike të cilat fokusohen tek organizimi institucional, mësimdhënia, kërkimi shkencor, sigurimi



<p>në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.</p>	<p>i brendshëm i cilësisë, veprimtaritë shërbyese si dhe marrdhëniet me jashtë/ndërkombëtarizimi. Programi i studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” ofrohet në përputhje me këtë strategji. Laboratorët simulatorë 1 dhe 2 të Infermierisë përmenden në strategjinë e AU. <i>Nuk ka një raportim specifik mbi këtë program studimi në Strategjinë e AU.</i> Programi i studimit ofrohet në përputhje me Rregulloren e përgjithshme të Institucionit (Neni 2) si dhe Rregulloren e Njesisë Kryesore (Neni 6). Neni 6 i Rregullores së Departamentit përcakton programet e studimit, përfshirë këtu edhe programin e studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”. Sigurimi i cilësisë është një nga pikat kryesore të strategjisë së Institucionit dhe për këtë arsye, programi i studimit është akredituar edhe në të kaluarën.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.4 Rregullore e Përgjithshme “Albanian University”; - Evidenca 1.5 Rreg e Fakultetit të Shkencave Mjekesore (2); - Evidenca 1.6 Rregullore Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë; - Evidenca 1.7 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”; - Evidenca 1.8 Strategji e zhvillimit Institucional 2023-2028.
<p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>Programi i studimit është hartuar në përputhje me strategjinë kombëtare. Programi është në përputhje me vizionin, si edhe në vijim të arritjes të objektivave strategjike të këtij programi studimi. Ky program është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe me zhvillimin ekonomik të vendit dhe ofrohet në përputhje me objektivat kombëtarë dhe ndërkombëtarë dhe nuk bie ndesh me interesat dhe vlerat kulturore kombëtare. Synimi themelor i këtij programi studimi lidhet me kontributin në rritjen e cilësisë profesionale të të diplomuarve në nivelin bachelor dhe që duan të vazhdojnë më tej karrieren profesionale duke u specializuar në fushën e Infermierisë kirurgjikale.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.1 Statuti i AU; - Evidenca 1.7 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”; - Evidenca 1.8 Strategji e zhvillimit Institucional 2023-2028.

Konkluzione	<i>Programet e studimit që ofrohen nga Albanian University (AU) nuk bien ndesh me interesat kombëtare. Programi i studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” është hartuar dhe ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore. AU ka si mision të ofrojë shërbime në përputhie me misionin e vet si dhe të ofroj programe studimi në të tre ciklet e studimit. Programi i studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” ofrohet në përputhje me strategjinë e AU. Synimi themelor i këtij programi studimi lidhet me kontributin në rritjen e cilësisë profesionale të të diplomuarve në nivelin bachelor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	<p>AU është një Institucion i arsimit të lartë që operon që prej vitit 2004. Fillimisht me emërtimin U.F.O dental dhe më pas me emërtimin U.F.O University e tashmë Albanian University. Universiteti është i akredituar më herët. Godina në të cilën ofrohet ky program studimi është e përshtatshme. Programi i studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” ofrohet që prej vitit 2013 bazuar në Vendimin Nr. 479, Prot. datë 10.12.2012. Programi i studimit është akredituar për herë të fundit me VBA Nr. 58, datë 05.07.2019</p> <p>Raporti PAE/PAK për njësinë bazë ku ky program studimi zhvillohet është si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në vitin akademik 2022-2023 Njësia Bazë kishtë në përbërje të saj 51 PAE (2 Prof.Dr., 1 Prof. As., 9 Dr, 31 Msc, 2 MP, 6 SPA) dhe 32 PAK (6 Prof. As., 12 Dr, 6 Msc, 1 MP, 7 SPA). - Në vitin akademik 2021-2022 Njësia Bazë kishtë në përbërje të saj 44 PAE (3 Prof.Dr., 2 Prof. As., 8 Dr, 20 Msc, 3 MP, 8 SPA) dhe 48 PAK (7 Prof. As., 13 Dr, 13 Msc, 1 MP, 14 SPA). - Në vitin akademik 2020-2021 Njësia Bazë kishtë në përbërje të saj 42 PAE (3 Prof.Dr., 3 Prof. As., 7 Dr, 19 Msc,

	<p>2 MP, 8 SPA) dhe 45 PAK (3 Prof.Dr ., 8 Prof. As., 13 Dr, 11 Msc, 1 MP, 9 SPA).</p> <p><i>Numëri i stafit të përfshirë në këtë program studimi është në rritje, dhe kjo është një pikë pozitive. Pavarësisht se numëri i stafit raportohet i lart, GVJ vëren se stafi në pjesën më të madhe nuk është me profil Infermieror. Kjo është një pikë e dobët në të cilën AU duhet të punoj më shumë. Paralelisht, pjesa e personelit me tituj dhe grada janë mjek dhe jo infermier. Kjo është po ashtu një pikë e dobët e AU. Drejtuesia e Njesisë Kryesore raportoi se pavarësisht përpjekjeve, e kanë patur të pamundur të rekrutojnë staf me tituj dhe grada sepse nuk ka në treg dhe nga ana tjetër AU nuk ka master shkencor në fushën e Infermierisë. Laboratorët e Departamentit janë të disponueshëm për realizimin e këtij programi studimi.</i></p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 3.9 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturen e fakultetit; - Evidenca 4.8 Planimetritë e godinës së Rr. së Durrësit; - Tabela aneks-RVB- MP.I.Kirurgjikale; - Evidenca 1.10 Përshkrimi i Laboratorëve të Infermierisë dhe Fizioterapisë; - Evidencë shtesë: Evidenca Nr. 8; - Takim me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe Njesisë Bazë; - Vizita në ambientet e AU.
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njesisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” ofrohet nga Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, në Fakultetin e Shkencave Mjekësore. Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të Njesisë Bazë. Kjo Njësi ofron po ashtu programe studimi në Infermieri, Fizioterapi (Bachelor në Infermieri, Bachelor në Fizioterapi dhe Master Profesional në Terapi Manuale). Programi i studimit është në përputhje dhe me Njesisë Kryesore. Në këtë njësi, ofrohen programe studimi në fushën e Farmacisë dhe Stomatologjisë. Programi i studimit nuk është ende i kodifikuar pasi ky proces nuk është përfunduar nga MAS.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.1 Statuti i AU; - Evidenca 1.5 Rreg e Fakultetit të Shkencave Mjekësore;

	<ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.6 Rregullore Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë.
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” ofrohet nga Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, në Fakultetin e Shkencave Mjekësore. Ky program studimi është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të Njësisë Bazë, duke qenë se është një program i fushës së mjekësisë dhe i përket fakultetit të duhur. Ky nuk është një program ndërdisiplinor.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.1 Statuti i AU; - Evidenca 1.6 Rregullore Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë; - Evidenca 1.7 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”.
<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.</p>	<p>Ky nuk është një Master Profesional i cili ofrohet jashtë profilit të Institucionit.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtjshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Në përfundim të këtij programi studimi, studentët e diplomuar nuk kanë mundësi për studime të mëtjshme pranë AU pasi Institucioni nuk ofron Master Shkencor në fushën e Infermierisë dhe as studime të ciklit të tretë në këtë fushë. Me qëllim trajnimit të mëtjshëm, AU mundohet të organizoj trajnime profesionale, përfshirë këtu workshope, leksione të hapura, seminare apo trajnime. Nuk u raportuan trajnime profesionale specifike me punëdhënësit. GVJ nuk arriti të evidentonte trajnime profesionale për të diplomuarit.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 3.7 Konferencë studentore Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë; - Evidenca shitesë: Evidenca Nr. 7. Listë e aktiviteteve të organizuara nga zyra e Karrierës dhe Alumni.
<p>Konkluzione</p>	<p>AU është një Institucion i arsimit të lartë që operon që prej vitit 2004. Numëri i stafit të përfshirë në këtë program studimi është në rritje, dhe kjo është një pikë pozitive. Pavarësisht se numëri i stafit raportohet i lart, GVJ vëren se stafi në pjesën më të madhe nuk është me profil Infermieror. Kjo është një pikë e dobët në të cilën</p>

	<i>AU duhet të punoj më shumë. Paralelisht, pjesa e personelit me tituj dhe grada janë mjek dhe jo infermier. Kjo është po ashtu një pikë e dobët e AU. Programi i studimit është në përputhje më fushën akademike dhe kërkimore të Njesisë Bazë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	<p>AU ka në Rregulloren dhe Statutin e vet Njesisë akademike dhe administrative specifike të cilat bashkëpunojnë me njëra tjetrën me qëllim mbarvajtjen e programit të studimit. Secila Njësi ka të përcaktuara detyrat dhe rolin e vet. Me qëllim ofrimin ekëtij programi studimi, Njesisë bashkëpunojnë me njëra tjetrën. Kjo u raportua dhe në takimet e zhvilluara në Institucion. Rregullorja e Njesisë Kryesore përcakton rolet e të gjitha njësive në nivel Fakulteti. Në rregulloren e Njesisë Bazë përcaktohen rolet dhe detyrat në nivel departamenti.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.1 Statuti i AU; - Evidenca 1.4 Rregullore e Përgjithshme "Albanian University"; - Evidenca 1.5 Rreg e Fakultetit te Shkencave Mjekesore; - Evidenca 1.6 Rregullore Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë; - Takim me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe Njesisë Bazë.
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit,	<p>Me qëllim formimin e studentëve, AU ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Institucione brenda vendit. Këto marrëveshje janë nënshkruar me Spitale (përfshirë këtu Spitalin e Traumës, Spitalin Universitar Obstetrik Gjinekologjik "Koço Gliozheni"), spitale rajonale si dhe klinika të ndryshme. Në listën e marrëveshjeve mungon Spitalin "Nën Tereza". Në takimet e zhvilluara me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Njesisë Bazë, ata raportuan se nuk kanë ende një marrveshje të tillë, por në rast se studentët dëshirojnë</p>

<p>aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>të kryejnë praktikën pranë QSUT, ata e kanë të mundur, në bazë të marrëveshjeve individuale. Në takimin me studentët, një nga ata raporoj se kishte zhvilluar praktikë pranë QSUT. <i>GVJ mendon se AU duhet të lidhi një marrëveshje bashkëpunimi me QSUT.</i> Paralelisht, në evidencat shtesë të përcjella nga AU, u raportuan 3 marrëveshje bashkëpunimi Erasmus me Institucione jashtë Shqipërisë. <i>Në raportin vjetor të Institucionit, Njësia Bazë nuk raporton asnjë marrëveshje me IAL brenda apo jashtë vendit. GVJ e konsideron këtë një pikë të dobët mbi të cilën AU duhet të punoj më shumë.</i></p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.11 Raport semestral Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë 2021-2022; - Evidenca 1.12 Raport vjetor Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë 2021-2022; - Evidenca 1.13 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit; - Evidenca 1.14 Raport Vjetor Institucional 2021-2022; - Evidenca shtesë: Evidenca Nr. 1.
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>AU, me qëllim implementimin e programit të studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” dhe zhvillimin e praktikave mësimore, ka nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi me institucione brenda vendit. Këto bashkëpunime përfshijnë spitale terciare, spitale rajonale, Autoriteti Shëndetësor Rajonal Tiranë dhe klinika të ndryshme. <i>GVJ, e konsideron të rëndësishme që Institucioni të nënshkruaj marrëveshje bashkëpunimi me QSUT-në, me qëllim realizimin e praktikave mësimore.</i></p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.13 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit; - Evidenca 1.14 Raport Vjetor Institucional 2021-2022; - Evidenca 1.15 Lista e studentëve që dërgohen për praktika në spitale dhe klinika; - Evidenca 1.16 Relacion i tutoreve për praktikat.
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet</p>	<p>Departamenti ka hartuar një raport mbi përfitimet nga marrëveshjet egzistuese. Ajo përmban institucionin që është nënshkruar marrëveshja, qëllimin, përfitimet, data e nënshkrimit si dhe afati i marrëveshjes. Kjo është një praktikë e mirë që Njësia Bazë duhet të vazhdoj ta implementoj. <i>Paralelisht, GVJ konsideron se është e</i></p>

e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	<p><i>detyrueshme që përfitimet nga këto marrëveshje të jenë më të detajuara duke përfshirë numërin e studentëve që kanë kryer praktikën, rezultatet e të nxëniet si dhe problematikat e ndryshme. Kjo do jepte mundësinë për një panoramë më të qartë të përfitimeve nga marrëveshjet.</i></p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.17 Raport analitik i përfitimit nga marrëveshjet e bashkëpunimit. 			
Konkluzione	<p><i>AU ka në Rregulloren dhe Statutin e vet Njësitë akademike dhe administrative specifike të cilat bashkëpunojnë me njëra tjetrën me qëllim mbarvajtjen e programit të studimit. Secila Njësi ka të përcaktuara detyrat dhe rolin e vet. Me qëllim formimin e studentëve, AU ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Institucione brenda vendit. GVJ mendon se AU duhet të lidhi një marrëveshje bashkëpunimi me QSUT. Në raportin vjetor të Institucionit, Njësia Bazë nuk raporton asnjë marrëveshje me IAL brenda apo jashtë vendit. GVJ e konsideron këtë një pikë të dobët mbi të cilën AU duhet të punoj më shumë. Departamenti ka hartuar një raport mbi përfitimet nga marrëveshjet egzistuese.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë	Sipas nenit 36 të Rregullores së AU, programet e ciklit të dytë (Master Profesional) organizohen me 60 ose 120 kredite ECTS dh kohëzgjatja normale e tyre është një ose dy vite akademike. Sipas nenit 41, pika 3 lëndët mund të grupohen në module. Ato mund të jenë semestrale ose vjetore. Kjo përmendet dhe në rregulloren e

<p>përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Njësisë Kryesore, neni 26. Neni 4 i Rregullores së programit të studimit përcakton se ky program studimi është i organizuar në module dhe i vlerësuar në Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Në nenin 5 të Rregullores së programit të studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”, thuhet se ky program ofrohet në module të veçanta dhe është i vlerësuar në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ky është një program studimi me 60 kredite (ECTS). Aktiviteti përfshin në total 1500 orë nga të cilat 645 orë në auditor dhe 855 jashtë auditorit. Sipas nenit 6 të Rregullores së programit të studimit, veprimtaritë formuese grupohen në Lëndë Bazë (6 kredite), Lëndë Karakterizuese (24 kredite), Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose Integruese (14 kredite), Lëndë Plotësuese (6 kredite) dhe Detyrime Përmbyllëse (10 kredite). Plani mësimor (neni 8) përcakton të detajuar kreditet për secilën lëndë.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.4 Rregullore e Përgjithshme “Albanian University”; - Evidenca 1.5 Rreg e Fakultetit të Shkencave Mjekesore; - Evidenca 1.7 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”; - Evidenca 2.1 Kurrikula e programit të studimit MP në “Infermieri Kirurgjikale”.
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparura në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një</p>	<p>Synimi themelor i këtij programi studimi lidhet me kontributin në rritjen e cilësisë profesionale të të diplomuarve në nivelin bachelor dhe që duan të vazhdojnë më tej karrierën profesionale duke u specializuar në fushën e Infermierisë Kirurgjikale. Ky program studimi ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e vazhdueshëm të studentëve, të cilat përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të tij dhe mundëson aplikimin në praktikë të njohurive dhe aftësive të fituara në kurset teorike dhe praktike për arsye të karakterit të mirëfilltë profesional të tij dhe njohurive nga fusha e infermierisë kirurgjikale, duke synuar në përgatitjen ose kualifikimin më të avancuar të studentëve për punësim. Programi i studimit Master profesional në Infermieri kirurgjikale ka për qëllim të përgatisë dhe formojë një figurë specialisti në infermierinë kirurgjikale dhe në sallën operatore, një profesionist të aftë që të sigurojë mbarvajtjen e proceseve dhe ecurinë e asistencës në</p>

<p>fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>fushën e kirurgjisë se përgjithshme dhe speciale për të rritur dhe për fëmijë. Në këtë program kanë mundësi të studiojnë infermierë të cilët kanë kryer arsim tre vjecar (cikli i pare Bachelor) në degën e Infermierise se përgjithshme dhe kërkojnë të thellojnë me tej njohuritë e tyre në një specialitet më të ngushtë të shkencave infermieristike, në rastin konkret në infermieristikën kirurgjikale. Kurrikula e këtij programi studimi ka një kohëzgjatje të rregullt të planifikuar në 2 semestra dhe me një numër në total 60 Kredite. Programi i lëndëve në semestrin e parë të studimit është ideuar që të mundësoje pajisjen e studentëve me njohuri më të thelluara në nivelin teorik dhe praktik në lëndë të shkencave infermieristike si Infermieristika e përgjithshme dhe klinike, Infermieristika në kirurgjinë infantile, Infermieristika në sallën operatore. Krahas këtyre lëndëve, studentët kanë mundësinë të përvetsojnë njohuri specifike që lidhen me specialitetin e kirurgjisë, Infermieristika në kirurgjinë obstetrikë-gjinekologjike, Infermieristika në kirurgjinë abdominal urologjike, Infermieristika në kirurgjinë torakale dhe kardiovaskulare, Infermieristika në kirurgjinë ortopedike etj. Lëndë ndërdisiplinore si sociologji, etikë-deontologji dhe psikologji mjekësore, përfshihen në programin e studimit.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Evidenca 1.7 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale".</i>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Neni 55 i Rregullores së AU përcakton se përfundimi i një programi Master Profesional mbyllet me punim diplome ose me provim. Kjo përcaktohet dhe në nenin 52 të Rregullores së Njësisë Kryesore dhe në nenin 28 të Rregullores së programit të studimit. Përmes provimit përfundimtar të formimit testohen njohuritë e marra gjatë vitit të studimit në programin e studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale". Tematika e provimit dhe temat e diplomës miratohen nga Departamenti, brenda një muaji nga fillimi i vitit akademik. Provimi i diplomës bëhet në dy sesione diplomimi të cilat përcaktohen nga Dekani i Fakultetit. Studenti që nuk paraqitet ose vlerësohet negativisht në sesionin e parë të provimeve, ka të drejte të paraqitet në provim në sesionin e ardhshëm. Në fillim të vitit akademik, Përgjegjësi i Departamentit u bën të njohur studenteve listën e lëndëve. Departamenti përcakton datën e zhvillimit të provimit të diplomes. Detyrimet përmbyllëse kanë në total 10 kredite. Praktika profesionale është e</p>

	<p>parashikuar në Programine studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” dhe ka 6 kredite.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.4 Rregullore e Përgjithshme “Albanian University”; - Evidenca 1.5 Rreg e Fakultetit te Shkencave Mjekesore; - Evidenca 1.7 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”; - Evidenca 2.1 Kurrikula e programit të studimit MP në “Infermieri Kirurgjikale”.
<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p>Jo e aplikueshme pasi ky nuk është një program i ciklit të dytë në fushën e Mësuesisë.</p>
<p>Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p>Jo e aplikueshme pasi ky nuk është një program i ciklit të dytë në fushën e Mësuesisë.</p>
<p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e</p>	<p>Jo e aplikueshme pasi ky nuk është një Institucion i Arsimit të Lartë me status të veçantë.</p>

<p>arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	
<p>Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” ka ngjashmëri me programe të tjera të së njëjtës fushë që ofrohen në IAL të tjera publike e private. Kjo u konfirmua dhe në takimin e zhvilluar me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Njesisë Bazë. Përmbajtja në nivelin 70% nuk është ende përfunduar nga MAS. AU ka bërë kodifikimin sipas udhëzimit të MAS.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë.
<p>Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Kodifikimi i programit të studimit nuk është ende përfunduar nga MAS. AU ka bërë kodifikimin sipas udhëzimit të MAS. Në përfundim të këtij procesi, do të zhvillohet dhe kodifikimi i lëndëve. Në planin mësimor aktual, asnjë nga lëndët nuk ka kod të vet. Në syllabuset e dorëzuara, secila lëndë, ka kodin e vet.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 2.7 Syllabuset e lëndëve të programit të studimit; - Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë.
<p>Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Ky nuk është një program i përbashkët por ofrohet vetëm nga AU.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Ky është një program studimi me 60 kredite (ECTS). Aktiviteti përfshin në total 1500 orë nga të cilat 645 orë në auditor dhe 855 jashtë auditorit. Sipas nenit 6 të Rregullores së programit të studimit, veprimtaritë formuese grupohen në Lëndë Bazë (6 kredite), Lëndë Karakterizuese (24 kredite), Lëndë ndërdisiplinore</i></p>

	<i>dhe/ose Integruese (14 kredite), Lëndë Plotësuese (6 kredite) dhe Detyrime Përmbyllëse (10 kredite). Synimi themelor i këtij programi studimi lidhet me kontributin në rritjen e cilësisë profesionale të të diplomuarve në nivelin bachelor dhe që duan të vazhdojnë më tej karrieren profesionale duke u specializuar në fushën e Infermierisë Kirurgjikale. Detyrimet përmbyllëse kanë në total 10 kredite. Praktika profesionale është e parashikuar në Programine studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” dhe ka 6 kredite.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Të gjitha detyrimet ligjore në fuqi përmbushen për ofrimin e këtij programi studimi. AU është krijuar me Vendimin e Ministrisë së Arsimit Nr. 197 datë 10.04.2004 dhe më pas riorganizuar me vendimin Nr. 603 datë 24.03.2011. AU është i akredituar nga ASCAL sipas detyrimit ligjor. Fakulteti i Shkencave Mjekësore ku ofrohet dhe programi i studimit Master Profesional në “Infermieri”, ka në përbërjen e vet: Departamentin e Stomatologjisë; Deptamenti e Farmacisë; dhe Departamenti e Infermierisë dhe Fiziotherapisë. Programi i studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” ofrohet që prej vitit 2013 bazuar në Vendimin Nr. 479, Prot. datë 10.12.2012.</p> <p>Raporti PAE/PAK për njësinë bazë ku ky program studimi zhvillohet është si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në vitin akademik 2022-2023 Njësia Bazë kishitë në përbërje të saj 51 PAE (2 Prof.Dr., 1 Prof. As., 9 Dr, 31 Msc, 2 MP, 6 SPA) dhe 32 PAK (6 Prof. As., 12 Dr, 6 Msc, 1 MP, 7 SPA). - Në vitin akademik 2021-2022 Njësia Bazë kishitë në përbërje të saj 44 PAE (3 Prof.Dr., 2 Prof. As., 8 Dr, 20 Msc, 3 MP, 8 SPA) dhe 48 PAK (7 Prof. As., 13 Dr, 13 Msc, 1 MP, 14 SPA).

Med. 

	<ul style="list-style-type: none"> - Në vitin akademik 2020-2021 Njësia Bazë kishtë në përbërje të saj 42 PAE (3 Prof.Dr., 3 Prof. As., 7 Dr, 19 Msc, 2 MP, 8 SPA) dhe 45 PAK (3 Prof.Dr., 8 Prof. As., 13 Dr, 11 Msc, 1 MP, 9 SPA). <p><i>Pavarësisht se numëri i stafit raportohet i lart, GVJ vëren se stafi në pjesën më të madhe nuk është me profil Infermieror. Kjo është një pikë e dobët në të cilën AU duhet të punoj më shumë. Paralelisht, pjesa e personelit me tituj dhe grada janë mjek dhe jo infermier. Kjo është po ashtu një pikë e dobët e AU.</i></p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.1 Statuti i AU; - Evidenca 1.2 Vendim i BA per akreditimin. Certificate; - Evidenca 1.4 Rregullore e Përgjithshme "Albanian University"; - Evidenca 1.5 Rreg e Fakultetit te Shkencave Mjekesore; - Evidenca 2.3 Vendimi për licensimin e programit të studimit; - Tabela aneks-RVB- MP.I.Kirurgjikale; - Evidenca shitesë: Evidenca Nr. 8.
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjisllacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Neni 18 i Rregullores së Departamentit përcakton rolin dhe detyrimet e asistentit të departamentit i cili është personel ndihmës akademik me karakter mësimor. Po ashtu, neni 19 i Rregullores përcakton dhe rolin e laborantit. Në tabelën e paraqitur nga AU, raportohet se Njësia Bazë ka 14 staf ndihmës akademik. Në takimin me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë ata raportuan se Departamenti ka në përbërje staf ndihmës akademik. GVJ i kërkoj AU të përcjellë një listë ku të evidentohet stafi ndihmës akademik për programin e studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale" si dhe pozicioni përkatës. Ky informacion u dërgua dhe raportohen 13 staf ndihmës akademik. <i>Stafi ndihmës akademik i raportuar nga Institucioni janë staf të spitaleve për mbikqyrjen e praktikave mësimore. GVJ konsideron se Institucioni duhet të ketë në përbërjen e vet staf ndihmës akademik të brendshëm.</i></p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.7 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale"; - Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë;

	<ul style="list-style-type: none"> - Tabela aneks-RVB- MP.I.Kirurgjikale; - Evidenca shitesë: Evidenca Nr. 10. 			
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Në bazë të nenit 10 të Rregullores së departamentit, Koordinatori i programit të studimit është përgjegjës për ecurinë dhe mbarvajtjen e praktikave profesionale. Paralelisht, ai informon drejtuesin e departamentit për problematikat e ndryshme. Koordinatori propozohet nga drejtuesi i departamentit dhe miratohet nga Dekani. Kjo procedurë u konfirmua dhe në takimin me Drejtuesit e Njësive kryesore/Bazë. <i>Në takimin me studentët, ata raportuan se nuk ishin në dijeni për koordinatrin e programit të studimit. GVJ konsideron se Njësia Bazë duhet të informoj rregullisht studentët për koordinatorin, detyrat e tij si dhe asistencën që mund tu japi atyre.</i></p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.6 Rregullore Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë; - Evidenca 1.7 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”; - Evidenca 2.4 Vendim për caktimin e koordinorit të programit Master “Infermeiri Kirurgjikale”; - Takim me Drejtuesit e Njësive Kryesore dhe Bazë; - Takim me studentët. 			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Të gjitha detyrimet ligjore në fuqi përmbushen për ofrimin e këtij programi studimi. GVJ vëren se stafi në pjesën më të madhe nuk është me profil Infermieror. Kjo është një pikë e dobët në të cilën AU duhet të punoj më shumë. Paralelisht, pjesa e personelit me tituj dhe grada janë mjek dhe jo infermier. Kjo është po ashtu një pikë e dobët e AU. Departamenti ka në përbërje staf ndihmës akademik. Koordinatorin e programit të studimit është përgjegjës për ecurinë dhe mbarvajtjen e praktikave profesionale. GVJ konsideron se Njësia Bazë duhet të informoj rregullisht studentët për koordinatorin, detyrat e tij si dhe asistencën që mund tu japi atyre.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Dokumentacioni i nevojshëm për ofrimin e këtij programi studimi është i disponueshëm nga Njësia Bazë. Statuti dhe Rregullorja e Institucionit përcaktojnë rregullat e përgjithshme ndërsa me më shumë informacione për këtë program studimi (Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”) paraqiten në Rregulloren e Njesisë Kryesore, Njesisë Bazë dhe sidomos në rregulloren e programit të studimit. Në takimin e zhvilluar me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Njesisë Bazë ata raportuan se i gjithë dokumentacioni është i disponueshëm pranë Njesisë Bazë përfshirë rregulloren, planin mësimor, syllabuset si dhe literaturën bazë. <i>GVJ konsideron se stafi akademik duhet të informohet për të gjithë dokumentacionin e disponueshëm pasi në takimin e zhvilluar, disa nga ata nuk ishin në dijeni.</i></p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.1 Statuti i AU; - Evidenca 1.4 Rregullore e Përgjithshme “Albanian University”; - Evidenca 1.6 Rregullore Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë; - Evidenca 1.7 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”; - Evidenca 1.15 Lista e studentëve që dërgohen për praktika në spitale dhe klinika; - Evidenca 1.16 Relacion i tutoreve për praktikat; - Evidenca 2.4 Vendim për caktimin e koordinatorit të programit Master “Infermieri Kirurgjikale”.
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Ky është një program i ciklit të dytë dhe ka në total 60 kredite (ECTS). Plani mësimor përmban informacionin e nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral si dhe ngarkesën mësimore. Ky është një program studimi me 60 kredite (ECTS). Aktiviteti përfshin në total 1500 orë nga të cilat 645 orë në auditor dhe 855 jashtë auditorit. Sipas nenit 6 të Rregullores së programit të studimit, veprimtaritë formuese grupohen në Lëndë Bazë (6 kredite – 10%), Lëndë Karakterizuese (24 kredite – 40%), Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose Integruese (14 kredite – 23%), Lëndë Plotësuese (6 kredite – 10%) dhe Detyrime Përmbyllëse (10 kredite – 17%). Plani mësimor (neni 8) përcakton të detajuar kreditet për secilën lëndë.</p>

Plani mësimor prezanton lëndët nëse janë semestrale apo vjetore, kategorinë (A-F), nr. e provimeve, kreditet, ndarja e orëve në kredite, ndarja e orëve në semestër dhe totalin e orëve në auditor. Në çdo semestër, numëri total i mundshëm i krediteve është 60 ECTS.

MP në “Infermieri Kirurgjikale”	Viti I	Në total
Në auditor	645	645
Leksione	180	180
Seminare	45	45
Laboratore	270	270
Praktika profesionale dhe lëndore	150	150
Detyra/Projekte	4	4
Punë e pavarur e studentit	855	855
Gjithsej	1500	1500

Konvertimi i orëve mësimore në kredite paraqitet në nenin 9 të Rregullores së programit të studimit. *GVJ konsideron se orët e laboratorëve mund të ulen pak duke rritur orët e praktikës profesionale.*

Evidenca:

- Evidenca 1.7 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”;
- Evidenca 2.1 Kurrikula e programit të studimit MP në “Infermieri Kirurgjikale”.

Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe

Neni 49 i Rregullores së Institucionit raporton se në programet e studimit pranohen student shqiptar dhe të huaj ndërsa detajet për pranimin e tyre përfshihen në rregulloren e programit të studimit. Neni 50 i kësaj rregullore përcakton mundësinë e transferimit të studimeve ndërsa në Rregulloren e Njësisë Kryesore, në nenet 34

<p>specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>dhe 35 raportohet mbi çregjistrimin si dhe transferimet e mundshme. Neni 25 i Departamentit përmend mundësinë e transferimit të studimeve. Në rregulloren e programit të studimit neni 10 përcakton kriteret e regjistrimit. <i>Procedura e transferimit (neni 13) përmendet por nuk është e detajuar/specifikuar.</i> Neni 35 i Rregullores së Njesisë Kryesore përcakton se modalitetet specifikohen në Rregulloren e Regjistrimeve dhe Transferimeve. Kjo rregullore përcakton kriteret e përgjithshme të pranimit, modalitetet për transferimet, çregjistrimet dhe njohjen e krediteve. Kriteret e pranimit dhe kuotat për program studimi miratohen nga Senati Akademik.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.4 Rregullore e Përgjithshme “Albanian University”; - Evidenca 1.5 Rreg e Fakultetit të Shkencave Mjekesore; - Evidenca 1.6 Rregullore Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë; - Evidenca 1.7 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”; - Evidenca 2.6 Rregullore e “Regjistrimeve dhe transferimeve”; - Evidenca 5.1 Vendim Senati për miratimin e kuotave të pranimit; - Evidenca 5.2 Vendim për miratimin e kriterëve të pranimit për programin e studimit.
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Sipas nenit 15 të Rregullores së Departamentit, stafi akademik është i detyruar të hartoj programin mësimor të lëndës, plotësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të tij dhe ta dorëzojë atë në Departament. Syllabuset përmbajnë, titullin e mësuesit, lektorin, ngarkesën, kohën e realizimit, llojin e lëndës, një përmbledhje dhe rezultatet e të nxënies, konceptet themelore dhe temat e lëndës. Metodologjia e mësimdhënies, forma e kontrollit të dijeve, literatura dhe kodi i etikës paraqitet në syllabuset e dorëzuara. <i>Një pjesë e madhe e syllabuseve kishin literaturë të vjetër dhe GVJ sugjeron që literatura të përditësohet. Po ashtu, pavarësisht se në takimin me stafin akademik dhe studentët u përmend se u jepën studentëve artikuj/punime të ndryshme të pedagogëve, ato nuk pasqyrohen në syllabus. Elementët kryesor që çdo syllabus duhet të ketë është e nevojshme të përfshihen në rregulloren e Departamentit.</i> Në takimin me stafin akademik ata raportuan se çdo fillim viti</p>

	<p>dorëzojnë syllabuset me ndryshimet/përmirësimet përkatëse. Një kopje e syllabusit i vete dhe Zyrës së Zhvillimit të Kurrikulave.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Evidenca 1.6 Rregullore Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë;</i> - <i>Evidenca 2.7 Syllabuset e lëndëve të programit të studimit;</i> - <i>Evidenca 2.8 Shkresë nga Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave për rishikimin e syllabuseve;</i> - <i>Takim me stafin akademik.</i>
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” ofrohet që prej vitit 2013 bazuar në Vendimin Nr. 479, Prot. datë 10.12.2012. Programi i studimit është riorganizuar me Vendimin Nr. 6313/2 Prot. datë 18.07.2018 me qëllim përshtatjen e vet me detyrimet ligjore. Programi i studimit është në proces përmirësimi të vazhdueshëm. Kjo u përmend në takimin me Drejtuesit e Njësisë Kryesore/Bazë. Ata raportuan se në fillim të çdo viti akademik bëhen rregullime nëse është e nevojshme, pasi miratohen në Departament. <i>Studentët raportuan se nuk kishin marrë pjesë në procedurë për përmirësimin e programit të studimit. Edhe stafi akademik, në takimin e zhvilluar raportuan se nuk kanë marrë pjesë në procedurë për përditësimin e programit të studimit.</i> Në takimin e zhvilluar me përfaqësuesit e Komisionit për Kurrikulat dhe Mësimin, ata raportuan se bëjnë shkresë për të identifikuar ndryshimet në syllabus. <i>GVJ konsideron se programi i studimit duhet të përditësohet rregullisht në bazë të ndryshimeve shkencore. Formalizimi i kësaj procedure si dhe diskutimi i përditësimeve të mundshme në Departament (me përfshirjen e studentëve) është e nevojshme.</i> Në takimin me stafin akademik ata raportuan se çdo fillim viti dorëzojnë syllabuset me ndryshimet/përmirësimet përkatëse. Një kopje e syllabusit i vete dhe Zyrës së Zhvillimit të Kurrikulave.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Evidenca 2.7 Syllabuset e lëndëve të programit të studimit;</i> - <i>Evidenca 2.8 Shkresë nga Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave për rishikimin e syllabuseve;</i> - <i>Takim me Drejtuesit e Njësisë Kryesore dhe Bazë;</i> - <i>Takim me stafin akademik;</i> - <i>Takim me studentët;</i>




	- Takim me përfaqësuesit e Komisionit për Kurrikulat dhe Mësimin.			
Konkluzione	<p><i>Dokumentacioni i nevojshëm për ofrimin e këtij programi studimi është i disponueshëm nga Njësia Bazë. GVJ konsideron se stafi akademik duhet të informohet për të gjithë dokumentacionin e disponueshëm pasi në takimin e zhvilluar, disa nga ata nuk ishin në dijeni. Ky është një program i ciklit të dytë dhe ka në total 60 kredite (ECTS). Plani mësimor prezanton lëndët nëse janë semestrale apo vjetore, kategorinë (A-F), nr. e provimeve, kreditet, ndarja e orëve në kredite, ndarja e orëve në semestër dhe totalin e orëve në auditor. GVJ konsideron se orët e laboratorëve mund të ulen pak duke rritur orët e praktikës profesionale. Jo të gjitha syllabuset e dorëzuara ishin të miratuar nga Drejtuesi i Departamentit. Paralelisht, një pjesë e madhe e tyre kishin literaturë të vjetër dhe GVJ sugjeron që literaturë të përditësohet.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	<p>Synimi themelor i këtij programi studimi lidhet me kontributin në rritjen e cilësisë profesionale të të diplomuarve në nivelin bachelor dhe që duan të vazhdojnë më tej karrieren profesionale duke u specializuar në fushën e Infermierisë Kirurgjikale. Ky program studimi ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e vazhdueshëm të studentëve, të cilat përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në perfundim të tij dhe mundëson aplikimin në praktikë të njohurive dhe aftësive të fituara në kurset teorike dhe praktike për arsye të karakterit të mirëfilltë profesional të tij dhe njohurive nga fusha e infermierisë kirurgjikale, duke synuar në përgatitjen ose kualifikimin mëtejshëm të studentëve për punësim. Programi i studimit Master profesional në Infermieri kirurgjikale ka për qëllim të përgatisë dhe formojë një figurë specialisti në infermierinë kirurgjikale dhe në sallën operatore, një profesionist të aftë që të sigurojë mbarvajtjen e proceseve dhe ecurinë e asistencës në fushën e kirurgjisë se</p>

	<p>përgjithshme dhe speciale për të rritur dhe për fëmijë. Në këtë program kanë mundësi të studiojnë infermierë të cilët kanë kryer arsim tre vjecar (cikli i pare Bachelor) në degën e Infermierise se përgjithshme dhe kërkojnë të thellojnë me tej njohuritë e tyre në një specialitet më të ngushtë të shkencave infermieristike, në rastin konkret në infermieristikën kirurgjikale. Pjesa më e madhe e studentëve që ndiqnin këtë program studimi kishin përfunduar programin Bachelor në “Infermieri” pranë AU. Në takimin me sekretarinë mësimore, u raportua se çdo vit rreth 80 të diplomuar nga programi Bachelor, regjistrohen në këtë program studimi. Në takimin e zhvilluar me studentët, ata pohuan se njohuritë e marra u japin mundësinë atyre si për punësim. <i>Të dhënat e punësimit të studentëve janë të pakta dhe GVJ sugjeron që zyra e Aluminit të mbaj kontakte më të rregullta me të diplomuarit në këtë program studimi.</i></p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Evidenca 1.7 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”;</i> - <i>Evidenca 1.9 Studimi i tregut të punës;</i> - <i>Takim me Drejtuesit e Njësisë Kryesore dhe Bazë;</i> - <i>Takim me studentët;</i> - <i>Takim me sekretarinë mësimore.</i>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Kurrikula e këtij programi studimi ka një kohëzgjatje të rregullt të planifikuar në 2 semestra dhe me një numër në total 60 Kredite. Programi i lëndëve në semestrin e parë të studimit është ideuar që të mundësojë pajisjen e studentëve me njohuri më të thelluara në nivelin teorik dhe praktik në lëndë të shkencave infermieristike si Infermieristika e përgjithshme dhe klinike, Infermieristika në kirurgjinë infantile, Infermieristika në sallën operatore. Krahas këtyre lëndëve, studentët kanë mundësinë të përvetsojnë njohuri specifike që lidhen me specialitetin e kirurgjisë, Infermieristika në kirurgjinë obstetrikë-gjinekologjike, Infermieristika në kirurgjinë abdominal urologjike, Infermieristika në kirurgjinë torakale dhe kardiovaskulare, Infermieristika në kirurgjinë ortopedike etj. Lëndë ndërdisiplinore si sociologji, etikë-deontologji dhe psikologji mjekësore, përfshihen në programin e studimit. Ky program studimi ka në total 17 module ku janë parashikuar 14 provime, përfshirë këtu provimi i diplomës. Lëndët e modulet e këtij programi studimi janë të ndara në një vit (2 semestra). Secila lëndë ka një numër të caktuar kreditesh. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohen</p>





	<p>objektivat e përgjithshme ndërsa në syllabuset e lëndëve janë të përcaktuara qartë objektivat formuese si dhe rezultatet e të nxënit. Në takimet e zhvilluara në Institucion, u raportua se përmes lëndëve/moduleve, është e mundur arritja e objektivave të këtij programi studimi. GVJ mendon se objektivat e programit të studimit arrihen përmes lëndëve/moduleve.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.7 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”; - Evidenca 2.7 Syllabuset e lëndëve të programit të studimit; - Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë; - Takim me stafin akademik; - Takim me studentët.
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Programi i studimit përfshin orë brenda dhe jashtë auditorit. Në total ky program ofrohet në një vit akademike dhe kërkon angazhimin për 1500 orë (645 brenda në auditor dhe 855 jashtë). Programi përfshin teori dhe praktikë. Programi i studimit është i ngjashëm me programe të tjera brenda dhe jashtë Shqipërisë raportuan Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë në takimin e zhvilluar. Në syllabuset e lëndëve përcaktohen qartë orët e teorisë dhe praktikës. Në total studentët gjatë studimeve të tyre zhvillojnë 180 orë leksione, 45 orë seminare, 270 orë laboratore, 4 orë detyra/projekte dhe 150 orë praktikë profesionale dhe lëndore. GVJ konsideron se orët laboratorike mund të ulen dhe të rriten orët e praktikës.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.7 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”; - Evidenca 2.7 Syllabuset e lëndëve të programit të studimit; - Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë.
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Disiplinat mësimore të programit të studimit Bachelor në Infermieri, janë të organizuara në pesë kategori, nga A tek E. Sipas nenit 6 të Rregullores së programit të studimit, veprimtaritë formuese grupohen në Lëndë Bazë (6 kredite – 10%), Lëndë Karakterizuese (24 kredite – 40%), Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose Integruese (14 kredite – 23%), Lëndë Plotësuese (6 kredite – 10%) dhe Detyrime Përmbyllëse (10 kredite – 17%). Plani mësimor (neni 8) përcakton të detajuar kreditet për secilën lëndë.</p>

Mehdi

gh

	<p>Neni 50 i Rregullores së Institucionit përcakton mundësinë e transferimit të studimeve ndërsa në Rregulloren e Njesisë Kryesore, mundësia e transferimeve raportohet në nenin 35. Neni 25 i Departamentit përmend mundësinë e transferimit të studimeve. Mobiliteti është i mundur në kuadër të këtij programi studimi dhe u raportua nga Drejtuesit e Njesisë Kryesore/Bazë si dhe nga studentët. <i>Nuk u raportuan mobilitete nga Institucioni për këtë program studimi. Në dokumentat shtesë të dorëzuara nga AU, nuk raportohen mobilitete të stafit/studentëve por vetëm tre marrëveshje bashkëpunimi Erasmus+. GVJ e konsideron këtë si pikë të dobët mbi të cilën AU duhet të punoj më shumë.</i> Në përfundim të studimeve, punësimi është i mundur. <i>GVJ vëren se vetëm një pjesë e vogël e të diplomuarve punojnë në profilin e tyre. AU duhet të zhvilloj një studim për të gjetur arsytet se pse kjo ndodh (Aneks Evidenca 1.9).</i></p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.4 Rregullore e Përgjithshme “Albanian University”; - Evidenca 1.5 Rreg e Fakultetit të Shkencave Mjekesore; - Evidenca 1.6 Rregullore Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë; - Evidenca 1.7 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”; - Evidenca 1.9 Studimi i tregut të punës; - Evidenca 2.1 Kurrikula e programit të studimit MP në “Infermieri Kirurgjikale”; - Evidenca 2.6 Rregullore e “Regjistrimeve dhe transferimeve”; - Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë; - Takim me studentët; - Evidenca shtesë: Evidenca Nr. 1.
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Pedagogu i lëndës harton programin mësimor në bazë të objektivave të programit të studimit si dhe në bazë të ecurisë së shkencës së infermierisë. Syllabusi dorëzohet dhe miratohet në Departament nga Drejtuesi i Njesisë Bazë. Sipas nenit 15 të Rregullores së Departamentit, stafi akademik është i detyruar të hartoj programin mësimor të lëndës, plotësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të tij dhe ta dorëzoj atë në Departament. Literatura bazë dhe e rekomanduar përfshihet në të gjithë syllabuset e dorëzuar. <i>Një pjesë e madhe e syllabuseve kishin literaturë të vjetër dhe GVJ sugjeron që literatura të përditësohet. Po ashtu, pavarësisht se në takimin</i></p>

	<p><i>me stafin akademik dhe studentët u përmend se u jepen studentëve artikuj/punime të ndryshme të pedagogëve, ato nuk pasqyrohen në syllabus. Në takimin me stafin akademik ata raportuan se çdo fillim viti dorëzojnë syllabuset me ndryshimet/përmirësimet përkatëse. Në takimin me përfaqësues të Komisionit për Kurrikulat dhe Mësimin, ata raportuan se zakonisht bëjnë një shkresë me qëllim informimin e tyre mbi ndryshimet e mundshme në syllabus, por jo individualisht çdo pedagogu. Përditesimi i rregullt i syllabuseve është i nevojshëm si dhe dokumentimi i ndryshimeve të bëra. Paralelisht, është e nevojshme formalizimi i procedurës së përfshirjes së sektorëve të ndryshëm në përditësimin e syllabusave. Paralelisht, GVJ konsideron se biblioteka duhet të pasurohet rregullisht me literaturë bashkëkohore. Nga dokumentat e dorëzuara, kërkesa e fundit për pasurimin e bibliotekës ishte viti 2018. Drejtuesit e Njesisë Kryesore/Bazë e justifikuan këtë për shkak të librave on-line. Në takimin me studentët, ata raportuan se frekuentojnë bibliotekën qendrore të Institucionit, dhe jo atë të Fakultetit. Në bazë të diskutimeve, GVJ vlerëson se studentët ishin më të informuar mbi bibliotekën e Institucionit në krahasim me stafin akademik.</i></p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Evidenca 1.6 Rregullore Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë;</i> - <i>Evidenca 2.7 Syllabuset e lëndëve të programit të studimit;</i> - <i>Evidenca 2.9 Procedurë e pasurimit të bibliotekës;</i> - <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i> - <i>Takim me stafin akademik;</i> - <i>Takim me përfaqësues të Komisionit për Kurrikulat dhe Mësimin.</i>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” u mundëson studentëve përftimin e njohirive, aftësive dhe kompetencave të synuara. Objektivat e programit të studimit janë të prezantuara në Rregulloren e programit (neni 4) si dhe në syllabuset respektive. Kjo gjë u raportua dhe në takimin e zhvilluar me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë. Përfshirja e teorisë dhe praktikës rrit kompetencat e studentëve për përdorimin e tyre gjatë punësimit.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Evidenca 1.7 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”;</i>

	<ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 2.7 Syllabuset e lëndëve të programit të studimit; - Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë. 			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	<p><i>Ky është një Master Profesional dhe studentët nuk kanë mundësinë të vazhdojnë studime doktorale në përfundim të këtij programi. Studentët të cilët përfundojnë këtë cikël studimesh kanë mundësinë të punësohen. GVJ vëren se vetëm një pjesë e vogël e të diplomuarve punojnë në profilin e tyre. AU duhet të zhvilloj një studim për të gjetur arsyet se pse kjo ndodh (Aneks Evidenca 1.9). Mbajtja e kontakteve me alumni si dhe me urdhërin e infermierit sugjerohet nga GVJ.</i></p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.7 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”; - Evidenca 1.9 Studimi i tregut të punës; - Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë; - Takim me studentët. 			
Konkluzione	<p><i>Ky program studimi ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e vazhdueshëm të studentëve, të cilat përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale. Ky program ka në total 17 module ku janë parashikuar 14 provime, përfshirë këtu provimi i diplomës. Në total studentët gjatë studimeve të tyre zhvillojnë 180 orë leksione, 45 orë seminare, 270 orë laboratore, 4 orë detyra/projekte dhe 150 orë praktikë profesionale dhe lëndore. GVJ konsideron se orët laboratorike mund të ulen dhe të rriten orët e praktikës. Nuk u raportuan mobilitete nga Institucioni për këtë program studimi. GVJ vëren se vetëm një pjesë e vogël e të diplomuarve punojnë në profilin e tyre. AU duhet të zhvilloj një studim për të gjetur arsyet se pse kjo ndodh. Jo të gjitha syllabuset e dorëzuara ishin të miratuar nga Drejtuesi i Departamentit. Paralelisht, një pjesë e madhe e tyre kishin literaturë të vjetër.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.

AU mundohet të ofroj programe studimi të përshtatura me tregun e punës. Drejtuesia e Njesisë Kryesore raportoi se janë munduar të përshtasin programet e studimit sipas nevojave. Ky program studimi është riorganizuar nga 90 kredite në 60 kredite me Vendimin Nr. 6313/2 Prot. datë 18.07.2018. Institucioni raporton se mundohet Brenda 20% të përshtasi programin e studimit. *Nuk u dhanë evidenca nga institucioni për përfshirjen e alumni apo partnerëve në përmirësimin e programit të studimit.* Stafi akademik raportoi se rol kryesor në përmirësimin e programit të studimit ka koordinatori i programit. *Në takimin e organizuar me përfaqësues të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave ata raportuan se nuk janë përfshirë institucione partnere ose alumni dhe aktorë të tjerë për përmirësimin e programit të studimit. Ata raportuan se hera e fundit që e kanë bërë përditësimin, është në vitin 2018. GVJ e konsideron si një pikë të dobët mbi të cilën Institucioni duhet të punoj më shumë. Përfshirja e këtyre grupeve do të japi mundësinë AU të përmirësoj programin e studimit akoma më tepër.*

Evidenca:

- Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë;
- Takim me stafin akademik;
- Takim me përfaqësues të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave

Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.

Sipas parashikimeve ligjore, Senati Akademik i AU, ka në përbërjen e vet dhe student. Paralelisht, Institucioni ka ngritur dhe Këshillin studentor. Studentët janë dhe anëtarë të komisioneve të ndryshme që Institucioni ngre (përfshirë këtu edhe procesin e akreditimit). Këto u konfirmuan edhe në takimin e zhvilluar me studentët. *Studentët raportuan se nuk janë përfshirë në përmirësimin e programit të studimit. Po ashtu raportuan se nuk kanë marrë pjesë në mbledhje departamenti.* Nga ana tjetër, raportuan se kanë gjithnjë një derë të hapur nga Drejtuesia e Njesisë Kryesore në rast se kanë problematika të ndryshme. Studentët raportuan se janë thirrur nga Drejtuesia e Departamentit dhe kanë dhënë mendimin e tyre për organizimin e konferencës. Vlerësimi i stafit akademik nga studentët është diçka pozitive. *GVJ nuk arriti të evidentonte përfshirjen e studentëve në përmirësimin/përditësimin e programit të studimit dhe e konsideron të rëndësishme që studentët të përfshihen në këtë proces.*

	Evidenca: <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 2.10 Shkresë për emërimin e Kryetarit të Këshillit Studentor në Senatit Akademik; - Evidenca 2.11 Anëtarët e Komisioneve të ndryshme të Institucionit; - Evidenca 3.7 Konferencë studentore Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë; - Takim me studentët. 			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	AU nuk raportoi bashkëpunime të ndryshme me Urdhërin e Infermierit me qëllim përmirësimin dhe përditësimin e programit të studimit. Drejtuesit raportuan se mundohen të përditësojnë programin e studimit në bazë të ndryshimeve të fundit. Edhe stafi akademik e raportoi këtë gjatë takimit të zhvilluar. Institucioni ka raportuar komunikimin zyrtar me UISH me qëllim identifikimin e kalueshmërisë në provimin e liçensës. GVJ konsideron të rëndësishme ndërtimin e marrëdhënieve me UISH për përmirësimin dhe përditësimin e programit të studimit. Evidenca: <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 2.14 Studimi i tregut të punës; - Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë; - Takim me stafin akademik. 			
Konkluzione	Ky program studimi është riorganizuar nga 90 kredite në 60 kredite me Vendimin Nr. 6313/2 Prot. datë 18.07.2018. Institucioni raporton se mundohet Brenda 20% të përshtasi programin e studimit. Nuk janë përfshirë institucione partnere ose alumni dhe aktorë të tjerë për përmirësimin e programit të studimit. Studentët raportuan se nuk janë përfshirë në përmirësimin e programit të studimit. AU nuk raportoi bashkëpunime të ndryshme me Urdhërin e Infermierit me qëllim përmirësimin dhe përditësimin e programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.6	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë	Objektivat e programit të studimit janë të përcaktuara qartë në Nenin 4 të Rregullores së programit të studimit. Objektivat e

prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.

përcaktuara janë në përputhje me objektivat e institucionit siç ato janë të përcaktuara në Statut, Rregullore të Institucionit dhe Strategjinë e Zhvillimit. Ky program studimi ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e vazhdueshëm të studentëve, të cilat përfshijnë dijet, aftësite dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në perfundim të tij dhe mundëson aplikimin në praktikë të njohurive dhe aftësive të fituara në kurset teorike dhe praktike për arsye të karakterit të mirëfilltë profesional të tij dhe njohurive nga fusha e infermierisë kirurgjikale, duke synuar në përgatitjen ose kualifikimin metejshëm të studentëve për punësim. Programi i studimit Master profesional në Infermieri kirurgjikale ka për qëllim të përgatisë dhe formojë një figurë specialisti në infermierinë kirurgjikale dhe në sallën operatore, një profesionist të aftë që të sigurojë mbarvajtjen e proceseve dhe ecurinë e asistencës në fushën e kirurgjisë së përgjithshme dhe speciale për të rritur dhe për fëmijë. ***Kërkimi shkencor nuk përmendet tek objektivat e programit të studimit, dhe ndoshta do ishte mirë të përfshihej.*** Në takimin e zhvilluar me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe Bazë, ata raportuan se kërkimi shkencor është një pikë prioritare për AU dhe për këtë arsye, Institucioni ka përcaktuar një fond (50,000.00 euro) për punime shkencore. Numër i stafit ka përfutur nga ky grant paraqitet në evidencën Nr. 3 të dokumentave shtesë të kërkuara nga Institucioni.

Evidenca:

- Evidenca 1.1 Statuti i "Albanian University";
- Evidenca 1.4 Rregullore e Përgjithshme "Albanian University";
- Evidenca 1.7 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale";
- Evidenca 1.8 Strategji e zhvillimit Institucional 2023-2028;
- Evidenca shtesë: Evidenca Nr. 3.;
- Takim me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe Bazë;
- Takim me përfaqësues të Zyrës së Koordinimit të Kërkimit shkencor dhe Botimeve akademike.

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke

Stafi akademik gëzon liri akademike në kërkim shkencor dhe mësimdhënie. Ata hartojnë syllabusin si dhe zhvillojnë kërkim shkencor në bazë të preferencave të tyre. Sipas nenit 25 të Rregullores së AU, Departamenti është njësi bazë mësimore-shkencore në Fakultet, sipas përcaktimeve të bëra në Statutin e AU (neni 16). Departamenti ka për detyrë të organizojë dhe të

<p>respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>administrojë veprimtaritë e mësimdhënies dhe Kërkimit Shkencor duke respektuar liritë akademike të personelit dhe të drejtën e tij për të shfrytëzuar burimet materiale dhe financiare në dispozicion të tij. Departamenti nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar liritë akademike të personelit akademik dhe të drejtën e tij për të shfrytëzuar burimet materiale dhe financiare në disoozicion të departamentit. Misioni i Departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë si dhe Objektiva e veprimtarisë përcaktohen në nenet 3-5 të Rregullores së Departamentit.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.1 Statuti i “Albanian University”; - Evidenca 1.4 Rregullore e Përgjithshme “Albanian University”; - Evidenca 1.7 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”; - Takim me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe Bazë; - Takim me stafin akademik.
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Studentët kanë mundësinë të përdorin revistën Optima për publikimin e punimeve të tyre. Stafi akademik raportoi se përfshin studentët në aktivitete kërkimore. <i>Asnjë nga studentët që morrën pjesë në takim nuk kishte zhvilluar ndonjë publikim me anëtarët e stafit akademik.</i> Institucioni ka organizuar dhe një konferencë shkencore studentore ku studentët kishin mundësinë të merrnin pjesë dhe të prezantonin punimet e tyre.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.7 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”; - Evidenca 2.1 Kurrikula e programit të studimit MP në “Infermieri Kirurgjikale”; - Evidenca 2.14 Të dhënat mbi revistën periodike OPTIME.; - Evidenca 3.7 Konferencë studentore Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë; - Takim me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe Bazë; - Takim me stafin akademik; - Takim me studentët.
<p>Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore,</p>	<p>Njësia Bazë nuk administron të ardhura por ato menaxhohen në nivel Institucioni. Gjatë takimit me Drejtuesin e Njesisë Kryesore/Bazë ata raportuan se nuk administrojnë të ardhura. Stafi</p>

<p>njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>akademik raportoi se është mbështetur financiarisht për publikimin e artikujve dhe punimeve shkencore. <i>Kjo është një praktikë e mirë të cilën Institucioni duhet ta vazhdoj. Stafit akademik raportoi se nuk është pyetur kur hartohet buxheti i AU.</i></p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca shitesë: Evidenca Nr. 3.; - Takim me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe Bazë; - Takim me stafin akademik. 			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Objektivat e programit të studimit janë të përcaktuara qartë në Nenin 4 të Rregullores së programit të studimit. Stafit akademik gëzon liri akademike në kërkim shkencor dhe mësimdhënie. Asnjë nga studentët që morrën pjesë në takim nuk kishte zhvilluar ndonjë publikim me anëtarët e stafit akademik. Stafit akademik raportoi se është mbështetur financiarisht për publikimin e artikujve dhe punimeve shkencore. Kjo është një praktikë e mirë të cilën Institucioni duhet ta vazhdoj.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi II.7</p>	
<p>Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p><i>Ngritja e grupeve mësimore dhe kërkimore nuk u raportua nga Institucioni. Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë raportuan se mundohen të aplikojn në projekte kërkimore shkencore. Përfaqësuesit e Zyrës së Koordinimit të Kërkimit shkencor dhe Botimeve akademike raportuan se bashkëpunojnë me Komisionin me qëllim Kërkimin shkencor. Anëtarët e GVB raportuan se kërkimi shkencor është një pikë e dobët për të cilën duhet të punohet më shumë. <i>Nuk u raportuan projekte kërkimore shkencore. GVJ konsideron të rëndësishme dhe sugjeron që numëri i aplikimeve në projekte kërkimore shkencore të rritet.</i></i></p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Takim me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe Bazë; - Takim me stafin akademik; - Takim me GVB;

	<ul style="list-style-type: none"> - <i>Takim me Përfaqësuesit e Zyrës së Koordinimit të Kërkimit shkencor dhe Botimeve.</i>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>Në kuadër të kërkimit shkencor stafi akademik dhe studentët kanë mundësinë të përdorin ambientet e AU. <i>Në raportin vjetor të Njesisë Bazë nuk prezantohen publikimet e stafit akademik, ndërsa në mënyrë të përmbledhur paraqiten në raportin vjetor të Institucionit.</i></p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Evidenca 1.12 Raport vjetor Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë 2021-2022;</i> - <i>Evidenca 1.14 Raport Vjetor Institucional 2021-2022;</i> - <i>Takim me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i> - <i>Takim me stafin akademik.</i>
<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>Institucion raporton se organizon rregullisht aktivitete të ndryshme si konferenca, leksione të hapura, ëorkshope etj. të cilat u vinë në ndihmë stafit akademik dhe studentëve. Paralelisht, ka organizuar konferencë studentore. Aktivitetet e organizuara raportohen si në raportin e Njesisë Bazë edhe në raportin vjetor të Institucionit.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Evidenca 1.12 Raport vjetor Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë 2021-2022;</i> - <i>Evidenca 1.14 Raport Vjetor Institucional 2021-2022;</i> - <i>Evidenca 3.7 Konferencë studentore Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë;</i> - <i>Evidencë shtesë: Evidencë Nr. 2;</i> - <i>Evidencë shtesë: Evidencë Nr. 5;</i> - <i>Takim me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe Bazë.</i>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>Programi i studimit formon profesionistë për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar. <i>Përqindja e lartë e suksesit në provimin e licensës është një evidencë e fortë për këtë.</i> Paralelisht, studentët raportuan se disa do të punonin në Shqipëri ndërsa disa të tjerë do të largoheshin. Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë raportuan se shumë student të tyre largohen dhe punësohen jashtë, gjë që tregon se ky program studimi formon profesionistë konkurrues.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Evidenca 1.9 Studimi i tregut të punës;</i> - <i>Takim me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i> - <i>Takim me studentët.</i>

<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.</p>	<p>Njësia Bazë duhet të ndërtoj marrëdhënie bashkëpunimi me Urdhërin e Infermierit si dhe shoqatat infermiore në Shqipëri. Kjo do ti japi mundësinë të formoj profesionistë Akoma më të përgatitur për tregun e punës.</p>			
<p>Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” është në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në vend si dhe rekomandimet ndërkombëtare dhe direktivat e Bashkimit Europian. Kjo vërtetohet nga momenti i hapjes së programit të studimit si dhe akreditimet e mëparshme.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.1 Statuti i “Albanian University”; - Evidenca 1.2 Vendim i BA për akreditimin. <i>Certifikate</i>; - Evidenca 2.3 Vendimi për licensimin e programit të studimit. 			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Nuk u raportuan projekte kërkimore shkencore. GVJ konsideron të rëndësishme dhe sugjeron që numëri i aplikimeve në projekte kërkimore shkencore të rritet. Në kuadër të kërkimit shkencor stafi akademik dhe studentët kanë mundësinë të përdorin ambientet e AU. Institucion raporton se organizon rregullisht aktivitete të ndryshme si konferenca, leksione të hapura, ëorkshope etj. të cilat u vinë në ndihmë stafit akademik dhe studentëve. Programi i studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” është në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në vend si dhe rekomandimet ndërkombëtare.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT


Standardi III.1																													
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.																													
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																												
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	<p>Neni 41 i Rregullores së Institucionit, neni 38 i Rregullores së Njësisë Kryesore dhe neni 7 i Rregullores së programit të studimit, përcaktojnë format e mësimdhënies. Ato janë leksionet, seminarët, praktikat profesionale, detyrat e kursit, esetë, laboratorët etj. Paralelisht, në këtë program tuimi parashikohen 17 module dhe 14 provime d. Lëndët ndahen në ato të detyrueshme dhe ato me zgjedhje. Plani mësimor përcakton orët e ndryshme për të gjitha format e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Në syllabuset e lëndëve përcaktohen orët e secilës forëm që përdoret. Këto forma mësimdhënie u konfirmuan dhe në takimet e zhvilluara me stafin akademik, studentët dhe përfaqësues të sektorit të standardeve të cilësisë dhe kurrikulave.</p> <table border="1" data-bbox="746 1048 1289 1736"> <thead> <tr> <th>MP në “Infermieri Kirurgjikale”</th> <th>Viti I</th> <th>Në total</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Në auditor</td> <td>645</td> <td>645</td> </tr> <tr> <td>Leksione</td> <td>180</td> <td>180</td> </tr> <tr> <td>Seminare</td> <td>45</td> <td>45</td> </tr> <tr> <td>Laboratore</td> <td>270</td> <td>270</td> </tr> <tr> <td>Praktika profesionale dhe lëndore</td> <td>150</td> <td>150</td> </tr> <tr> <td>Detyra/Projekte</td> <td>4</td> <td>4</td> </tr> <tr> <td>Punë e pavarur e studentit</td> <td>855</td> <td>855</td> </tr> <tr> <td>Gjithsej</td> <td>1500</td> <td>1500</td> </tr> </tbody> </table> <p>Konvertimi i orëve mësimore në kredite paraqitet në nenin 9 të Rregullores së programit të studimit. <i>GVJ konsideron se orët e</i></p>		MP në “Infermieri Kirurgjikale”	Viti I	Në total	Në auditor	645	645	Leksione	180	180	Seminare	45	45	Laboratore	270	270	Praktika profesionale dhe lëndore	150	150	Detyra/Projekte	4	4	Punë e pavarur e studentit	855	855	Gjithsej	1500	1500
MP në “Infermieri Kirurgjikale”	Viti I	Në total																											
Në auditor	645	645																											
Leksione	180	180																											
Seminare	45	45																											
Laboratore	270	270																											
Praktika profesionale dhe lëndore	150	150																											
Detyra/Projekte	4	4																											
Punë e pavarur e studentit	855	855																											
Gjithsej	1500	1500																											



	<p><i>laboratorëve mund të ulen pak duke rritur orët e praktikës profesionale.</i></p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.4 Rregullore e Përgjithshme “Albanian University”; - Evidenca 1.5 Rreg e Fakultetit të Shkencave Mjekesore; - Evidenca 1.7 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”; - Evidenca 2.1 Kurrikula e programit të studimit MP në “Infermieri Kirurgjikale”; - Tabela aneks-RVB- MP.I.Kirurgjikale; - Takim me stafin akademik; - Takim me studentët; - Takim me përfaqësues të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave.
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Personeli akademik përdor mënyra alternative të mësimdhënies me qëllim zhvillimin bërjane të tij sa më të përshtatshëm për studentët. Stafi akademik raportoi se përdor mënyra të ndryshme gjatë mësimdhënies si PowerPoint, figura, video, bashkëbisedim, raste klinike etj. me qëllim mësimi të jetë interesant dhe interaktiv. Paralelisht, një nga pedagogët që morri pjesë në takim, raportoi eksperiencën e saj personale për metodat e përdorura gjatë mësimdhënies. Këto metoda u konfirmuan dhe nga studentët. Paralelisht, ata raportuan se marrin leksionet përmes email-it dhe në sekretari. Në periudhën e pandemisë, AU, ka përdorur dhe mësimdhënien on-line por jo më.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 3.2 Shembull pyetësori i plotësuar në Microsoft Teams; - Evidenca 3.2.a Klasë në Microsoft Teams; - Evidenca 3.3 Manual për realizimin e mësimi online 2020 – 2021; - Takim me stafin akademik; - Takim me studentët.
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe</p>	<p>Me qëllim përmirësimin e mësimdhënies, AU, organizon trajnime të rregullta për stafin akademik. Në takimin me stafin akademik ata raportuan se Zyra e Kërkimit Shkencor ka marrë ekspert nga jashtë me qëllim zhvillimin e trajnimeve. Paralelisht, u dërgojnë thirrje për aplikime të ndryshme dhe website. Ata raportuan se</p>

<p>në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>organizohen 1-2 trajnime në javë me trajnimin e fundit të ketë që në fushën e menaxhimit të projekteve, në nivel institucioni. Institucioni, me kërkesë të GVJ, ka përcjellë listën e trajnimeve vitet e fundit. Pavarësisht evidencave të depozituara, GVJ vëren se trajnimet e stafit akademik janë të përgjithshme dhe jo të specifikuara në nevojat e stafit akademik të Departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë dhe jo në fushën e Infermierisë. Përfaqsesit e Sektorit të Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave raportuan se organizojnë aktivitete trajnuese, por jo në fushën e didaktikës ndërsa përfaqsesit e Komisionit për Kurrikulat dhe Mësimin raportuan se përmirësimi i mësimdhënies zhvillohet përmes aktiviteteve trajnuese. GVJ konsideron të rëndësishme rritjen e trajnimeve të mësimdhënies, specifikisht për anëtarët e këtij programi studimi si dhe të rriten mobilitetet e stafit akademik për mësimdhënie jashtë Shqipërisë përmes programit Erasmus+.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 3.1 Axhenda e trajnimeve të stafit akademik - v.a. 2022 – 2023; - Evidenca shtesë: Evidenca Nr. 5 (1-3); - Takim me stafin akademik; - Takim me përfaqsesit e Sektorit të Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave; - Takim me përfaqsesit e Komisionit për Kurrikulat dhe Mësimin.
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Personeli akademik i cili është i angazhuar në mësimdhënie ka njohuritë dhe aftësitë e duhura. Stafi akademik ka aftësitë e duhura didaktike me qëllim shpjegimin në mënyrën më të mirë të mundshme studentëve. Studentët raportuan se janë të kënaqur nga mësimdhënia që zhvillon stafi akademik. Stafi akademik raportoi se përdor mënyra të ndryshme gjatë mësimdhënies si PowerPoint, figura, video, bashkëbisedim, raste klinike etj. me qëllim mësimi të jetë interesant dhe interaktiv. Kjo u confirmua nga studentët. Gjatë takimit me autoritete drejtuese, ata raportuan se mundohen të rekrutojnë staf me eksperiencë në mësimdhënie. Kjo u raportua dhe në takimin me Burimet Njerëzore. CV-t e pedagogëve tregojnë se ata kanë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme në mësimdhënie. AU organizon rregullisht aktivitete trajnuese për përmirësimin e aftësive mësimdhënëse të stafit akademik.</p>

	<p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 4.2 CV të stafit akademik; - Evidenca shitesë: Evidenca Nr.2; - Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë; - Takim me stafin akademik; - Takim me studentët; - Takim me përfaqësues të Burimeve Njëerëzore.
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Institucioni ka hartuar një pyetësor për vlerësimin e stafit akademik nga studentët. Kjo është një procedurë standarde që AU përdor për të përfshirë studentët në përmirësimin e mësimdhënies. Stafi akademik raportoi se ata vlerësohen nga studentët. Ata raportuan se në vija të përgjithsme informohen me email ose në mënyrë individuale për rezultatet. Studentët konfirmuan që vlerësojnë stafin akademik. Ata marrin pyetësorin me email dhe e plotësojnë. Kjo është procedura që raportuan dhe përfaqësuesit e Sektorit të Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave. Stafi akademik vlerësohet dhe nga Drejtuesi i Departamentit. Kjo u konfirmua dhe në takimin me stafin akademik. <i>GVJ e konsideron këtë si një praktik të mirë që AU duhet të vazhdoj ta bëj. Paralelisht, GVJ konsideron se është e rëndësishme, në bazë të rezultateve, të përpilohen plane masah konkrete nga Njësia Bazë, si dhe të monitorohet implementimi i tyre. Mungesa e një raporti të tillë u raportua dhe nga përfaqësuesit e Sektorit të Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave. Ata sugjeruan se një raport i tillë është diçka positive.</i></p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 3.2 Shembull pyetësori i plotësuar në Microsoft Teams; - Evidenca 4.6 Pyetesor personeli akademik v.a 2021-2022; - Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë; - Takim me stafin akademik; - Takim me studentët; - Takim me përfaqësuesit e Sektorit të Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave.
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të</p>	<p>Institucioni ka në përbërjen e vet Sektorin e Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave. Ata organizojnë aktivitete të ndryshme duke përfshirë dhe ekspert të jashtëm. Në takimin me përfaqësues të sektorit, ata raportuan se aktivitetet që organizojnë nuk janë konkrete didaktike. Evidenca 5 e dokumentacionit shitesë të</p>



<p>mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>kërkuara nga institucioni si dhe evidenca 3.3 raportojnë trajnimet e stafit akademik. <i>GJV mendon se është e nevojshme të rriten aktivitetet me qëllim përmirësimin e aftësive mësimdhënëse të stafit akademik.</i></p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.3 Organigrama e AU; - Evidenca 2.13 Të dhëna mbi aktivitetet 2019-2023; - Takim me përfaqësuesit e Sektorit të Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulav. 			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Format e mësimdhënies janë leksionet, seminarët, praktikat profesionale, detyrat e kursit, esetë, laboratorët etj. Personeli akademik përdor mënyra alternative të mësimdhënies me qëllim zhvillimin bërjen e tij sa më të përshtatshëm për studentët. Stafi akademik raportoi se përdor mënyra të ndryshme gjatë mësimdhënies si PowerPoint, figura, video, bashkëbisedim, raste klinike etj. me qëllim mësimi të jetë interesant dhe interaktiv. GJV vëren se trajnimet e stafit akademik janë të përgjithshme dhe jo të specifikuara në nevojat e stafit akademik të Departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë dhe jo në fushën e Infermierisë. Institucioni ka hartuar një pyetësor për vlerësimin e stafit akademik nga studentët. Kjo është një procedurë standarde që AU përdor për të përfshirë studentët në përmirësimin e mësimdhënies.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi III.2 Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore</p>	<p>Neni 51 i Rregullores së institucionit, neni 49 i Rregullores së Njësisë Kryesore dhe neni 25 i Rregullores së Programit të studimit raportojnë kriteret dhe mënyrat e testimit dhe vlerësimit të dijeve. Në rregulloren e Programit të studimit raportohet se</p>

përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.

vlerësimi i përgatitjes së studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm, ku nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të elementëve të mëposhtëm:

1. Provimi përfundimtar 60%
2. Provimi të ndërmjetëm 20%
3. Pjesëmarrja aktive në seminar/Laboratore Praktike 10%
4. Detyra/projekte 10%

Vlerësimi i tezës së provimit është pjesë e vlerësimit përfundimtar. Vlerësimi përfundimtar bëhet pas përfundimit të procesit të korigjimit të provimit si dhe pas mbledhjes së rezultateve të grumbulluara nga studenti përgjatë semestrit (seminare, laboratore, provimit të ndërmjetëm etj), nën përgjegjësinë e titullarit të lëndës. Në sezonet e vjeshtës ose të riprovimeve vlerësimi bëhet me tezë 100 pikëshe dhe vlerësimet e studentit të akumuluar gjatë vitit zerohen. Vlerësimi përfundimtar mund të ndryshohet vetëm me rifutjen në provim për përmirësim. Shkalla e vlerësimit për përvetësimin e dijes nga studentët bëhet sipas sistemit me notë (notat 1 deri 10), me pikë ose me përgjindje (100 pikë ose 100%) dhe me shkronja (sistemi ECTS me shkronjat nga A deri F). Kjo procedurë u konfirmua nga stafi akademik dhe nga studentët gjatë takimeve të zhvilluara. Vlerësimi detajohet në syllabuset e lëndëve.

Evidenca:

- Evidenca 1.4 Rregullore e Përgjithshme "Albanian University";
- Evidenca 1.5 Rreg e Fakultetit të Shkencave Mjekesore;
- Evidenca 1.7 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale";
- Evidenca 2.7 Syllabuset e lëndëve të programit të studimit;
- Takim me stafin akademik;
- Takim me studentët.

Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e

Studentët orën e parë të lëndës informohen nga pedagogu respektiv mbi metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive. Ky informacion është po ashtu edhe në syllabuset e lëndëve. Informimi i studentëve orën e parë të modulit u konfirmua dhe gjatë takimeve si nga stafi akademik po ashtu dhe nga studentët.

Evidenca:

<p>lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - <i>Evidenca 2.7 Syllabuset e lëndëve të programit të studimit;</i> - <i>Takim me stafin akademik;</i> - <i>Takim me studentët.</i>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Sipas nenit 49 të Rregullores së Njesisë Kryesore kontrolli i dijes së një lënde bëhet me cikle (module dhe provime). Kontrolli i dijes, si rregull, bëhet me dorëzim projektesh, detyrash, me provim me shkrim, me gojë, me praktikë ose i kombinuar me shkrim dhe me gojë. Në detyrimet e studentit përfshihen si lëndë e detyrueshme dhe ato fakultative: zgjedhja e lëndëve fakultative është në pëlqimin e studentit Njohuritë e përfituara nga studenti, mund të kontrollohen dhe të vlerësohen përmes nje kombinimi të frekuencimit dhe aktivizimit të studentit gjatë orëve të mësimit në auditor, provimeve me shkrim, detyrave të kursit, punëve laboratorike dhe provimit me gojë. Vlerësimi në përfundim të secilës lëndë bëhet me pikë (nga 0-100 pikë) dhe rezultati përfundimtar konvertohet me sistemin kombëtar të vlerësimit me notë, i cili është nga 4- 10 ku 4 është notë jo kaluese dhe 10 është vlerësimi maksimal për njohuritë e përfituara si dhe shprehet me gërma nga A deri në F sipas sistemit të vlerësimit ECTS me notë. Në syllabusin e çdo lende përcaktohen dhe disiplinoohen format e ndryshme të kontrollit të njohurive të cilat zhvillohen sipas afateve të caktuara në kalendarin akademik, të bëra publike nga Departamenti përkatës dhe që janë të detyrueshme për zbatim, si nga pedagogët ashtu dhe nga studentët. Në sesionin e parë provimi përfundimtar i lëndës ka në total 60 (gjashtëdhjetë) pikë; në sesionet e tjera provimi ka në total 100 (njëqind) pikë. Provimet janë të sekretuara u raportua nga stafi akademik dhe studentët. Procedura e vlerësimit u konfirmua në takimin me studentët. Asnjë nga studentët e pranishëm nuk kishte dhënë provim me gojë.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Evidenca 1.5 Rreg e Fakultetit te Shkencave Mjekesore;</i> - <i>Evidenca 1.7 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale";</i> - <i>Evidenca 2.7 Syllabuset e lëndëve të programit të studimit;</i> - <i>Takim me stafin akademik;</i> - <i>Takim me studentët.</i>

Konkluzione	Në rregulloren e Programit të studimit raportohet se vlerësimi i përgatitjes së studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm, ku nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të provimi përfundimtar (60%), provimi të ndërmjetëm (20%), pjesëmarrja aktive në seminar/Laboratore Praktikë (10%) dhe detyra/projekte (10%). Studentët orën e parë të lëndës informohen nga pedagogu respektiv mbi metodologjinë e testimit dhe vlerësimin të njohurive. Kontrolli i dijes, si rregull, bëhet me dorëzim projektësh, detyrash, me provim me shkrim, me gojë, me praktikë ose i kombinuar me shkrim dhe me gojë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	<p>Në rregulloren e Programit të studimit raportohet se vlerësimi i përgatitjes së studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm, ku nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të provimi përfundimtar, provimi të ndërmjetëm, pjesëmarrja aktive në seminar/laboratore praktikë dhe detyra/projekte. Kontrolli i dijes, si rregull, bëhet me dorëzim projektësh, detyrash, me provim me shkrim, me gojë, me praktikë ose i kombinuar me shkrim dhe me gojë. Vlerësimi në përfundim të secilës lëndë bëhet me pikë (nga 0-100 pike) dhe rezultati përfundimtar konvertohet me sistemin kombëtar të vlerësimin me notë, i cili është nga 4- 10 ku 4 është notë jo kaluese dhe 10 është vlerësimi maksimal për njohuritë e përfituara si dhe shprehet me gërma nga A deri në F sipas sistemit të vlerësimin ECTS me notë. Në syllabusin e çdo lende përcaktohen dhe disiplinohen format e ndryshme të kontrollit të njohurive të cilat zhvillohen sipas afateve të caktuara në kalendarin akademik, të bëra publike nga Departamenti përkatës dhe që janë të detyrueshme për zbatim, si nga pedagogët ashtu dhe nga studentët.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.5 Rreg e Fakultetit të Shkencave Mjekesore; - Evidenca 1.7 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale";

	<ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 2.7 Syllabuset e lëndëve të programit të studimit; - Takim me stafin akademik; - Takim me studentët.
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p><i>AU nuk ka venë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit. Me qëllim vlerësimi të jetë i drejtë dhe i pa anshëm, përdoret sekretimi i provimeve. Sekretimi u konfirmua nga studentët dhe pedagogët dhe kjo është një pikë e fortë e Institucionit. Përdorimi i metodave të vlerësimit të automatizuar, sugjerohet nga GVJ.</i></p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Takim me stafin akademik; - Takim me studentët.
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Vlerësimi zhvillohet në bazë të nenit 51 të Rregullores së institucionit, nenit 49 të Rregullores së Njësisë Kryesore dhe nenit 25 të Rregullores së Programit të studimit. Në këto nene raportohen kriteret dhe mënyrat e tesimit dhe vlerësimit të dijeve. Syllabuset përcaktojnë mënyrën e vlerësimit për secilën lëndë/modul. Procedura e vlerësimit siç parashikohet në kuadrin ligjor, u raportua dhe nga stafi akademik e studentët.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.4 Rregullore e Përgjithshme “Albanian University”; - Evidenca 1.5 Rreg e Fakultetit të Shkencave Mjekesore; - Evidenca 1.7 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”; - Evidenca 2.7 Syllabuset e lëndëve të programit të studimit; - Takim me stafin akademik; - Takim me studentët.
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar</p>	<p>Në përfundimin e provimeve, studentët informohen për rezultatet e provimit në systemin Pitagora ose në klasë. Studentët raportuan se në raste që kanë paqartësi mund të pyesin pedagogët për gabimet e tyre. Kjo është një procedurë që u konfirmua dhe nga stafi akademik.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Takim me stafin akademik;

<p>studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - <i>Takim me studentët.</i>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Nnei 23 i Rregullores së Programit të studimit raporton veprimet e ndaluara gjatë provimit. Përdorimi i matërialeve të ndaluara, kopjimi etj. nuk lejohen. Në syllabuset e lëndëve është i përcaktuara dhe kodi i etikës ku detajohen veprimet që nuk lejohen nga studentët, përfshirë këtu kopjimin, plagjiaturën etj. <i>Stafi akademik raportoi se di që institucioni ka një sistem antiplagjature por asnjë nga ata nuk e kishte përdorur. Studentët nuk ishin në dijeni për përdorimin e një sistemi të tillë. Funksionimi i një sistemi antiplagjature nga autoritetet drejtuese të Departamentit sugjerohet nga GVJ.</i></p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Evidenca 1.7 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”;</i> - <i>Evidenca 2.7 Syllabuset e lëndëve të programit të studimit;</i> - <i>Takim me stafin akademik;</i> - <i>Takim me studentët.</i>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Studentët informohen mbi rezultatet e provimit sipas afateve ligjore që parashikohen në Rregulloren e programit të studimit. Korigjimi i provimeve bëhet nën përgjegjësinë e një pedagogu titullar dhe brenda 7 ditësh nga dita e përfundimit të provimit. Pas korigjimit, provimet depozitohen pranë departamentit dhe vlerësimi i tyre i bëhet i njohur studentëve nëpërmjet sekretarisë mësimore të degës përkatëse. Fleta e provimit duhet të përmbajë përveç vlerësimit dhe firmën e pedagogut apo pedagogëve që e kanë korigjuar. <i>Në Rregullore nuk përmendet që studentët informohen për rezultatet e provimit nga sistemi Pitagora. Kjo është diçka që që GVJ sugjeron të shtohet në Rregullore.</i> Studentët raportuan se njoftohen për pikët e provimit nga sistemi Pitagora ose nga sekretaria mësimore. Këtë procedurë e konfirmoi dhe stafi akademik.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Evidenca 1.7 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”;</i> - <i>Takim me stafin akademik;</i> - <i>Takim me studentët.</i>

<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Studentët kanë të drejtë të njihen me rezultatin e vlerësimit, të informohen për gabimet e tyre në provim si dhe mundësinë për të kontestuar në rast se nuk janë dakord me vlerësimin. Sipas nenit 24 të Rregullores së Programit të Studimit, studenti ka të drejtë të njihet me fletën e provimit pas korrigjimit ku bëhet edhe ç'sekretimi i tyre. Ai ka të drejtë të njihet me pikët totale të vlerësimit në tezë si dhe me pikët në çdo rubrikë. Nëse studenti konstaton se ka rubrika të pakorrigjuara apo pikë të pallogaritura ne vlerësimin total, ai ka të drejtë të reklamojë provimin në një kërkesë me shkrim, e cila depozitohet pranë sekretarisë mësimore të degës përkatëse, brenda 48 orëve nga shpallja e rezultateve. Pas reklamimit të provimit nga ana e studentit për arsyet e përmendura, Dekani i Fakultetit përkatës ngre një komision ad-hoc në përbërjen e të cilit bëjnë pjese edhe pedagogët të cilët kanë korrigjuar provimet. Vendimi lidhur me rivlerësimin e provimit merret brenda një jave nga dita e depozitimit te ankesës dhe i bëhet i njohur studentit nëpërmjet sekretarisë mësimore. Vendimi i bashkëlidhet proces verbalit të provimit. Stafu akademik raporoj se ka procedurë për ankimimin e një note por asnjë nga ata nuk kishte patur një çështje të tillë pasi deri tani, çdo problematik ishte mbyllur në nivel Departamenti. <i>Studentët raportuan se janë në dijeni për procedurën e kontestimit të një note, në rast se ata nuk janë dakord.</i> Një prej studentëve raportoi se ka ankimuar notën dhe se u morr në pyetje nga pedagogu i lëndës. Pavarësisht se mundësia e kontestimit përmendet në Rregulloren e Programit të Studimit, <i>GVJ konsideron se kjo procedurë duhet të jepet më e detajuar.</i></p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Evidenca 1.7 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale";</i> - <i>Takim me stafin akademik;</i> - <i>Takim me studentët.</i>
<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Sipas nenit 24 të Rregullores së Programit të studimit, çdo ankimim për vlerësim shqyrtohet dhe Dekani i Fakultetit ngre një komision ad-hoc në përbërjen e të cilit bëjnë pjese edhe pedagogët të cilët kanë korrigjuar provimet. Vendimi lidhur me rivlerësimin e provimit merret brenda një jave nga dita e depozitimit te ankesës dhe i bëhet i njohur studentit nëpërmjet sekretarisë mësimore. Ka një paqartësi pasi në RVB përmendet që ankesa i drejtohet departamentit dhe ai është përgjegjës për ngritjen e një komisioni</p>

	<p>rivlerësimi. Kjo procedurë nuk raportohet kështu në nenin 24 të Rregullores së Programit të studimit. GVJ konsideron se procedura e ankimimit nuk është shumë e qartë dhe Njësia Bazë duhet ta sqaroj këtë duke bërë amendimet e nevojshme në Rregulloren e programit të studimit.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.7 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”. - RVB 			
Konkluzione	<p><i>Nota përfundimtare është rezultat i kombinimit provimi përfundimtar (60%), provimi të ndërmjetëm (20%), pjesëmarrja aktive në seminar/Laboratore Praktikë (10%) dhe detyra/projekte (10%). AU nuk ka venë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit. Syllabuset përcaktojnë mënyrën e vlerësimit për secilën lëndë/modul. Procedura e vlerësimit siç parashikohet në kuadrin ligjor, u raportua dhe nga stafi akademik e studentët. Në përfundimin e provimeve, studentët informohen për rezultatet e provimit në sistemin Pitagora ose në klasë. Funksionimi i një sistemi antiplagjature nga autoritetet drejtuese të Departamentit sugjerohet nga GVJ. Studentët kanë të drejtë të njihen me rezultatin e vlerësimit, të informohen për gabimet e tyre në provim si dhe mundësinë për të kontestuar në rast se nuk janë dakord me vlerësimin. GVJ konsideron se procedura e ankimimit nuk është shumë e qartë dhe Njësia Bazë duhet ta sqaroj këtë duke bërë amendimet e nevojshme në Rregulloren e programit të studimit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.4	
Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Programi i studimit Master profesional në “Infermieri kirurgjikale” ka për qëllim të përgatisë dhe formojë një figurë specialisti në infermierinë kirurgjikale dhe në sallën operatore, një profesionist të aftë që të sigurojë mbarvajtjen e proceseve dhe ecurinë e asistencës në fushën e kirurgjisë së përgjithshme dhe speciale për të rritur dhe për fëmijë. Kurrikula e këtij programi studimi ka një kohëzgjatje të rregullt të planifikuar në 2 semestra dhe me një numër në total 60 Kredite. Programi i lëndëve në semestrin e parë

	<p>të studimit është ideuar që të mundësoje pajisjen e studentëve me njohuri më të thelluara në nivelin teorik dhe praktik në lëndë të shkencave infermieristike si Infermieristika e përgjithshme dhe klinike, Infermieristika në kirurgjinë infantile, Infermieristika në sallën operatore. Krahas këtyre lëndëve, studentët kanë mundësinë të përvetsojnë njohuri specifike që lidhen me specialitetin e kirurgjisë, Infermieristika në kirurgjinë obstetrikë-gjinekologjike, Infermieristika në kirurgjinë abdominal urologjike, Infermieristika në kirurgjinë torakale dhe kardiovaskulare, Infermieristika në kirurgjinë ortopedike etj. Lëndë ndërdisiplinore si sociologji, etikë-deontologji dhe psikologji mjekësore, përfshihen në programin e studimit.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.7 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”. - Evidenca 2.1 Kurrikula e programit të studimit MP në “Infermieri Kirurgjikale”. - Evidenca 2.7 Syllabuset e lëndëve të programit të studimit;
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Ky program studimi fokusohet në përgatitjen e infermierëve për tregun e punës. Sipas planit mësimor, lëndët e sociologjisë, psikologjisë mjekësore dhe etikë-deontologjisë përfshihen si lëndë me zgjedhje, duke shtuar dhe përgatitur studentët me aftësi sociale dhe ndërvepruese.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.7 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”. - Evidenca 2.1 Kurrikula e programit të studimit MP në “Infermieri Kirurgjikale”.
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre,</p>	<p>Në fund të lëndës, pedagogët informojnë dhe orjentojnë studentët për çështjet më të rëndësishme. Stafi akademik raportoi se zhvillon konsultime me studentët në orën e fundit të lëndës. Institucioni ka hartuar një raport semestral të pedagogut, që plotëson stafi akademik në fund të semestrit dhe ku specifikohen objektivat e arritura, literatura e përdorur, frekuentimi, realizimi i programit etj. Kjo është një procedurë shumë e rëndësishme dhe <i>GVJ e konsideron se pikë të fortë. Nuk u raportua kush është procedura e mëtejshme e këtij formati (kush i analizon, si korrigjohen problematikat etj.), dhe për këtë, AU duhet të hartoj një</i></p>

<p>si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Rregullore specifike. Studentët raportuan se zhvillojnë konsultime me pedagogët.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 3.5 Raport semestral i personelit akademik; - Takim me stafin akademik; - Takim me studentët.
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Gjatë programit të studimit, studentët përfitojnë njohuri dhe kompetenca. Ata zhvillojnë orë seminare, orë laboratorike dhe praktika. Studentët zhvillojnë në total 180 orë leksione, 45 orë seminare, 270 orë laboratore, 4 orë detyra/projekte dhe 150 orë praktikë profesionale dhe lëndore. Stafi akademik dhe studentët raportuan se diskutimi zhvillohet gjatë orëve të mësimin me qëllim rritjen e aftësive dhe kompetencave të studentëve. Studentët raportuan se pedagogët mundohen të krijojnë një klimë positive duke dhënë dhe shëmbuj/raste konkrete nga puna e tyre klinike. Punimet kërkimore të studentëve janë të mundura të publikohen në revistën e Instiucionit Optime, pa pagesë. Studentët po ashtu kanë patur mundësinë të prezantojnë punimet e tyre dhe në konferencën studentore të organizuar nga Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë. <i>Pavarësisht se AU ka pak marrëveshje bashkëpunimi me IAL të huaja, nuk janë zhvilluar mobilitete të studentëve.</i></p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.7 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale". - Evidenca 2.1 Kurrikula e programit të studimit MP në "Infermieri Kirurgjikale"; - Evidenca 2.14 Të dhënat mbi revistën periodike OPTIME; - Evidenca 3.7 Konferencë studentore Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë; - Takim me stafin akademik; - Takim me studentët.
<p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Stafi akademik i Departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë mundohet të zhvillojë orë të hapura dhe seminare mbi të reja të shkencës së Infermierisë. Këtë e raportoi stafi akademik në takimin e zhvilluar. Departamenti ka organizuar orë të hapura gjatë peridhës së kaluar dhe kjo është një praktikë e mirë që duhet të vazhdoj ta bëj. Paralelisht, stafi akademik brenda dhe jashtë strukturës së programit zhvillon studime kërkimore shkencore.</p>

	<p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 3.6 Lajmërim për një leksion të hapur; - Evidenca 2.14 Të dhënat mbi revistën periodike OPTIME; - Evidenca 3.7 Konferencë studentore Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë; - Takim me stafin akademik. 			
<p>Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>AU mbështet idetë inovative. AU ka organizuar konferencë studentore ku studentët kishin mundësi të prezantonin idetë e tyre si dhe punimet e tyre shkencore. Paralelisht, ambientet e Institucionit mund të përdoren nga studentët për punë kërkimore shkencore. Përveç këtyre më lart, nuk u raportuan aktivitetet tjerë për mbështetjen e studentëve për idetë e tyre inovative.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 3.7 Konferencë studentore Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë; - Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë; - Takim me studentët. 			
<p>Konkluzione</p>	<p>Programi i studimit Master profesional në Infermieri kirurgjikale ka për qëllim të përgatisë dhe formojë një figurë specialisti në infermierinë kirurgjikale dhe në sallën operatore, një profesionist të aftë që të sigurojë mbarvajtjen e proceseve dhe ecurinë e asistencës në fushën e kirurgjisë së përgjithshme dhe speciale për të rritur dhe për fëmijë. Sipas planit mësimor, lëndët e sociologjisë, psikologjisë mjekësore dhe etikë-deontologjisë përfshihen si lëndë me zgjedhje. Institucioni ka hartuar një raport semestral të pedagogut, që plotëson stafi akademik në fund të semestrit dhe ku specifikohen objektivat e arritura, literatura e përdorur, frekuentimi, realizimi i programit etj. Kjo është një procedurë shumë e rëndësishme dhe GVJ e konsideron se pikë të fortë. Studentët zhvillojnë në total 180 orë leksione, 45 orë seminare, 270 orë laboratore, 4 orë detyra/projekte dhe 150 orë praktikë profesionale dhe lëndore.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.</p>	<p>Në përfundim të kursit të plotë të studimeve (me shlyerjen e plotë të detyrimeve), studenti fiton diplomë “Master Profesional” në “Infermieri Kirurgjikale”. Procesi i diplomimit realizohet me anë të provimit përfundimtar të formimit ose punimit të diplomes. Përmes provimit përfundimtar të formimit testohen njohuritë e marra përgjate vitit akademik në programin e studimit në Infermieri Kirurgjikale. Tematika e provimit dhe temat e diplomes miratohen nga Departamenti, brenda një muaji nga fillimi i vitit akademik. Në fillim të vitit akademik, Përgjegjesi i Departamentit u ben të njohur studentëve të diplomohen në Master Profesional ne Infermieri Kirurgjikale listën e lëndëve. Provimi i diplomës bëhet ne dy sesione diplomimi të cilat përcaktohen nga Dekani i Fakultetit. Studenti që nuk paraqitet ose vlerësohet negativisht në sesionin e parq të provimeve, ka të drejtëtë paraqitet në provim në sezonin e ardhshëm.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.7 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”. - Evidenca 3.17 Manuali i punimit të diplomes; - Takim me Drejtuesit e Njësisë Kryesore dhe Bazë.
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Provimi i diplomës bëhet në dy sesione diplomimi të cilat përcaktohen nga Dekani i Fakultetit. Studenti që nuk paraqitet ose vlerësohet negativisht në sesionin e parë të provimeve, ka të drejtq të paraqitet në provim në sesionin e ardhshëm. Në fillim të vitit akademik, Përgjegjësi i Departamentit u bën të njohur studentëve të cilët diplomohen në Master Profesional ne Infermieri Kirurgjikale, listën e lëndëve. Departamenti përcakton datën e zhvillimit të provimit të diplomës. Provimi përfundimtar përfshinë tematika nga i gjithë viti i studimit. Staf i akademik i këtij programi propozon pyetjet e mundshme dhe ato i përcillen Drejtuesit të Njësisë Bzë për miratim. Kjo bankë pyetjesh u jepet studentëve. Në takimin e zhvilluar, ata raportuan se ju është vënë në dispozicion banka e pyetjeve. Ata raportuan po ashtu se pedagogu i informon mbi pikat kryesore ku ata duhet të fokusohen.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.7 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”;
	<p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.7 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”;

	<ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 3.17 Manuali i punimit te diplomes; - Takim me studentët.
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Provimi përfundimtar përfshinë tematika nga i gjithë viti i studimit. Stafi akademik i këtij programi propozon pyetjet e mundshme dhe ato i përcillen Drejtuesit të Njesisë Bazë për miratim. Kjo bankë pyetjesh u jepet studentëve. Ata raportuan po ashtu se pedagogu i informon mbi pikat kryesore ku ata duhet të fokusohen. Provimet e formimit organizohen në bazë të dhënash me pyetje formimi mbi grup lëndet e formimit karakterizues. Teza e provimit të formimit përmban kërkesa, raste studimi dhe pyetje analitike, mënyra e shtrimit të të cilave i jep mundësi studentit që nëpërmjet njohurive të fituara gjatë periudhës së shkollimit, të tregojë aftësitë profesionale të fituara. Provimet e formimit përpilohen dhe korrigjohen nga komisioni i Diplomimit ngritur me propozim të Departamentit dhe me Miratim të Dekanit.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.6 Rregullore Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë; - Evidenca 1.7 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”; - Evidenca 3.8 Model teze provimi përfundimtar; - Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë; - Takim me stafin akademik; - Takim me studentët.
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Sipas nenit 24 të Rregullores së Departamentit, tutorimit organizohet nga udhëheqësit shkencorë (raporti është 1 pedagog për 10 studentë në programet Bachelor dhe 1 pedagog për 5 studentë në programet Master) dhe personeli ndihmës i departamentit. GVJ konsideron se raporti është shumë i lartë dhe duhet të ulet. Tutorimi i 5 studentëve Master në mendimin e GVJ, ul cilësinë e punimeve. Sistemi i komunikimit është fleksibël dhe realizohet nëpërmjet seancave javore këshillimore dhe tutorimit online. Para dorëzimit në departament udhëheqësi shkencor plotëson për secilin nga studentët që ka pasur në kujdes një formular vlerësimi, i cili i përcillet komisionit të vlerësimit. Studenti duhet të dorëzojë në departament temën e diplomës 10 (dhjetë) ditë para datës së mbrojtjes, të printuar në ëord. Manuali i punimit të diplomës është në dispozicion të studentëve. Asnjë nga studentët e Masterit që marrën pjesë në takim, nuk ishin diplomuar me temë diplome. Në RVB raportohet që studentët e</p>

	<p>Masterit Profesional në Infermieri Kirurgjikale diplomohen me provim formimi ndërsa në Rregulloren e programit të studimit përmëndët edhe provimi përfundimtar edhe punimi i diplomës. Është e nevojshme që Rregullorja e programit të studimit të specifikoj qartë mënyrën. Në mendimin e GVJ, studentët do ishte mirë të diplomohen vetëm me provim përfundimtar.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.6 Rregullore Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë; - Evidenca 1.7 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale"; - Takim me studentët.
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Studentët kanë mundësi të përdorin kapacitetet dhe infrastrukturën e AU, për arsye kërkimore. Kjo u konfirmua në takimet në institucion me Drejtuesit e Njesisë Kryesore/Bazë si dhe me studentët.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë; - Takim me studentët.
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Në përfundim të provimit të përgjithshëm ose të punimit të diplomës, studentët vlerësohen me notë. Kjo procedurë është e njohur nga studentët që në orën e parë.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.6 Rregullore Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë; - Evidenca 1.7 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale".
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të studimeve, studentët pajisen me diplomën dhe suplementin e diplomës (neni 52, pika 7 e Rregullores së Njesisë Kryesore dhe neni 31 i Rregullores së programit të studimit). Stafi administrativ merr të gjithë masat për të realizuar këtë proces.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.5 Rreg e Fakultetit të Shkencave Mjekësore.; - Evidenca 1.7 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale"; - Evidenca 3.10 Model diplome Master Profesional "Infermieri Kirurgjikale";

	<ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 3.11 Model suplement Master Profesional "Infermri Kirurgjikale"; - Evidenca 3.12 Model listë notash Master Profesional "Infermri Kirurgjikale". 			
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Kopje e dokumentacionit të studentit ruhet sipas legjislacionit në fuqi. Informacioni mbi studentët (regjistri themeltar, regjistri i arritjeve akademike) ju vu GVJ në dispozicion nga sekretaria mësimore. Nenet 28 dhe 29 e Rregullores së Institucionit, specifikojnë detyrimet e sekretarisë mësimore dhe Kryesekretarit.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.4 Rregullore e Përgjithshme "Albanian University"; - Evidenca 3.13 Rregullore e sekretarisë mësimore; - Takim me sekretarinë mësimore. 			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Procesi i diplomimit realizohet me anë të provimit përfundimtar të formimit ose punimit të diplomës. GVJ konsideron se raporti është shumë i lartë dhe duhet të ulet. Tutorimi i 5 studentëve Master në mendimin e GVJ, ul cilësinë e punimeve. Në fillim të vitit akademik, Përgjegjesi i Departamentit u ben të njohur studentëve të diplomohen në Master Profesional ne Infermieri Kirurgjikale listën e lëndëve. Provimi i diplomës bëhet në dy sesione diplomimi të cilat përcaktohen nga Dekani i Fakultetit. Provimi përfundimtar përfshinë tematika nga i gjithë viti i studimit. Studentët kanë mundësi të përdorin kapacitetet dhe infrastrukturën e AU, për arsye kërkimore. Në përfundim të provimit të përgjithshëm ose të punimit të diplomës, studentët vlerësohen me notë.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushe t pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në "Master Profesional" institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive,

Me qëllim formimin e studentëve, AU ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Institucione brenda vendit. Këto marrëveshje janë nënshkruar me Spitale (përfshirë këtu Spitalin e Traumës,

<p>garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.</p>	<p>Spitalin Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Koço Gliozheni”), spitale rajonale si dhe klinika të ndryshme. <i>Në listën e marrëveshjeve mungon Spitali “Nën Tereza”.</i> Në takimet e zhvilluara me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Njesisë Bazë, ata raportuan se nuk kanë ende një marrëveshje të tillë, por në rast se studentët dëshirojnë të kryejnë praktikën pranë QSUT, ata e kanë të mundur, në bazë të marrëveshjeve individuale. Në takimin me studentët, një nga ata raporoj se kishte zhvilluar praktikë pranë QSUT. <i>GVJ mendon se AU duhet të lidhi një marrëveshje bashkëpunimi me QSUT. Në ambientet e institucionit kishte laboratorë në të cilët studentët zhvillonin pjesë të kurrikulës.</i></p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.11 Raport semestral Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë 2021-2022; - Evidenca 1.12 Raport vjetor Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë 2021-2022; - Evidenca 1.13 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit; - Evidenca 1.14 Raport Vjetor Institucional 2021-2022; - Vizita në ambientet e Institucionit.
<p>Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.</p>	<p>AU për implementimin e programit të studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” bashkëpunon me Spitale (përfshirë këtu Spitalin e Traumës, Spitalin Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Koço Gliozheni”), spitale rajonale si dhe klinika të ndryshme. Pranë këtyre strukturave, studentët kanë mundësinë të zhvillojnë praktikën mësimore me qëllim rritjen e njohurive dhe aftësive të tyre. Studentët kanë mundësinë në këto spitale të përdorin teknologjinë egzistuese me qëllim rritjen e njohurive dhe kompetencave profesionale.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.13 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit; - Takim me stafin akademik; - Takim me studentët.
<p>Kriteri 3. Praktikat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e</p>	<p>Praktika profesionale është e parashikuar në Programin e studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” dhe ka 6 kredite. Tutorët vendosin notën respektive duke e shoqëruar atë me një relacion. Në takimet në institucion, kjo procedurë u konfirmua.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.16 Relacion i tutoreve për praktikat;

trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	<ul style="list-style-type: none"> - Takim me Drejtuesit e Njësisë Kryesore dhe Bazë; - Takim me stafin akademik; - Takim me studentët. 			
Konkluzione	<p>Me qëllim formimin e studentëve, AU ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Institucione brenda vendit. Këto marrëveshje janë nënshkruar me Spitale (përfshirë këtu Spitalin e Traumës, Spitalin Universitar Obstetrik Gjinekologjik "Koço Gliozheni"), spitale rajonale si dhe klinika të ndryshme. GVJ mendon se AU duhet të lidhi një marrëveshje bashkëpunimi me QSUT. Praktika profesionale është e parashikuar në Programine studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale" dhe ka 6 kredite.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka	<p>Raporti Raporti i stafit akademik përgjegjës për këtë program studimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vitin 2022 – 2023 është 16 PAE (2 Prof. As., 6 Dr, 4 Msc, 4 SPA) dhe 11 PAK (3 Prof. As., 5 Dr, 3 SPA). - Vitin 2021 – 2022 është 16 PAE (2 Prof. As., 7 Dr, 5 Msc, 2 SPA) dhe 10 PAK (2 Prof. As., 2 Dr, 2 Msc, 4 SPA). - Vitin 2020 – 2021 është 11 PAE (2 Prof. As., 5 Dr, 2 Msc, 2 SPA) dhe 10 PAK (1 Prof. As., 6 Dr, 1 Msc, 2 SPA). <p><i>Sipas nenit 59, pika 6 e ligjit 80/2015, "Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës". Kjo gjë nuk është respektuar nga AU dhe kjo është një pikë e dobët. GVJ rekomandon që personeli që jëp</i></p>

<p>fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p><i>mësim në master me Msc apo studime afatgjata duhet të zëvendësohet me personel "Lektor".</i> <i>Paralelisht, pjesa e personelit me tituj dhe grada janë mjek dhe jo infermier. Kjo është po ashtu një pikë e dobët e AU.</i></p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Tabela aneks-RVB- MP.I.Kirurgjikale; - Evidencë shtesë: Evidenca Nr. 8; - Takim me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe Njesisë Bazë;
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p><i>Programi nuk mbulohet me 70% nga stafi akademik me kohë të plotë sipas VKM 41\2018. Kjo është një pikë e dobët e AU dhe GVJ rekomandon që të plotësohet ky kriter duke shtuar numrin e stafit akademik me kohë të plotë.</i></p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Tabela aneks-RVB- MP.I.Kirurgjikale; - Evidencë shtesë: Evidenca Nr. 8;
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, si dhe nga takimet e zhvilluara gjatë vizitës në institucion, numëri i stafit të përfshirë në këtë program studimi është në rritje. <i>Pavarësisht se numëri i stafit raportohet i lart, GVJ vëren se stafi në pjesën më të madhe nuk është me profil Infermieror. Kjo është një pikë e dobët në të cilën AU duhet të punoj më shumë.</i></p> <p><i>Gjithashtu, nga dokumentacioni i personelit akademik rezulton se ka staf akademik me kohë të plotë njëkohësisht në dy universitete gjë që bie në kundërshtim me nenin 64, pika 2 e ligjit 80/2015.</i></p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Tabela aneks-RVB- MP.I.Kirurgjikale; - Evidencë shtesë: Evidenca Nr. 8; - Takim me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe Njesisë Bazë;
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e</p>	<p>Institucioni ndjek procedurë rekrutimi të mirëpërcaktuar në rregulloren e burimeve njerëzore, ku përcaktohet qartë procedura e punësimit, që nga kërkesa për personel akademik efektiv, nga njësia bazë drejt njesisë kryesore, andej drejt Rektorit. Kërkesat për punësim miratohen nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit, pastaj lajmërimi bëhet publik. Rektori ngre</p>

<p>personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>komisionin ad-hoc për përzgjedhjen e personelit akademik. Në kërkesat për punësim, përcaktohen edhe kriteret e përgjithshme dhe specifike në lidhje me kualifikimin profesional dhe akademik.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Evidenca 4.7 Rregullore e Zyres se Burimeve Njerezore;</i> - <i>Tabela aneks-RVB- MP. I. Kirurgjikale;</i> - <i>Evidencë shtesë: Evidenca Nr. 8;</i> - <i>Takim me Drejtuesin e Njesisë Kryesore</i> - <i>Takim me përfaqësues të Burimeve Njëerëzore.</i>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në Institucion dhe në dokumentacion, u evidentua angazhimi i personelit ndihmës akademik, ata asistojnë dhe realizojnë orët laboratorike dhe gjithashtu realizojnë mirembajtjen e laboratoreve. Në tre vite akademike në rang departamenti, personeli ndihmës akademik është si më poshtë vijon:</p> <p>2020 – 2021 1 personel ndihmës akademik; 2021– 2022 1 personel ndihmës akademik; 2022 – 2023 1 personel ndihmës akademik;</p> <p><i>Personeli ndihmës akademik për realizimin e orëve laboratorike është vetëm një dhe ka kompetencën dhe angazhimin e duhur për realizimin e detyrave të tij, por nuk është i mjaftueshëm. GVJ konsideron shtimin e numrit të stafit ndihmës akademik në funksione të orëve laboratorike.</i></p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Tabela aneks-RVB- MP.I. Kirurgjikale;</i>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Zyra e Burimeve Njerezore mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Në tabelat përmbledhëse, si dhe në dosjet e vëzhguara fizikisht në institucion, të dhënat përfshijnë anëtarët e personelit akademik të angazhuar në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrative.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Takim me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe Bazë</i> - <i>Takim me përfaqësues të Burimeve Njëerëzore.</i>

Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.

GVJ gjatë vizitës në institucion konstatoi dhe ju vunë në dispozicion marrëveshje të bashkëpunimit me institucione të tjera. AU ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Institucione brenda vendit. Këto marrëveshje janë nënshkruar me Spitale (përfshirë këtu Spitalin e Traumës, Spitalin Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Koço Gliozheni”), spitale rajonale si dhe klinika të ndryshme. *Në listën e marrëveshjeve mungon Spitalin “Nën Tereza”.* Në takimet e zhvilluara me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Njesisë Bazë, ata raportuan se nuk kanë ende një marrëveshje të tillë, por në rast se studentët dëshirojnë të kryejnë praktikën pranë QSUT, ata e kanë të mundur, në bazë të marrëveshjeve individuale. Në takimin me studentët, një nga ata raporoj se kishte zhvilluar praktikë pranë QSUT. *GVJ mendon se AU duhet të lidhi një marrëveshje bashkëpunimi me QSUT.*

Evidenca:

- Evidenca 1.11 Raport semestral Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë 2021-2022;
- Evidenca 1.12 Raport vjetor Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë 2021-2022;
- Evidenca 1.13 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit;
- Evidenca 1.14 Raport Vjetor Institucional 2021-2022;
- Evidenca shpeshë: Evidenca Nr. 1.

Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.

Referuar RVB-së, në fillim të ciklit të praktikës referentë e shërbimeve spitalore pasi janë njoftuar paraprakisht dhe zyrtarisht për kalendarin e praktikës klinike, pajisen me listën e studentëve dhe objektivat specifike specifike për çdo shërbim. Në përfundim të praktikës kthehet në institucion lista me kontrollin e frekuentimit dhe një relacion në që përmban frekuentimin, paraqitjen, angazhimin dhe seriozitetin e studenteve në praktikat klinike profesionale.

Evidenca:

- Evidenca 1.10 Rregullore e Departamentit. Neni 26’
- Evidenca 2.1 Rregullore e programit të studimit BSc. Infermieri neni 25;
- Evidenca 2.5 Dosja e praktikës për programin e studimit Bsc ne Infermieri;
- Takimi me udhëheqësit e praktikave
- Takim me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe Bazë
- RVB infermieri kirurgjikale.

Konkluzione	<p>Sipas nenit 59, pika 6 e ligjit 80/2015, "Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës". Kjo gjë nuk është respektuar nga AU dhe kjo është një pikë e dobët. GVJ rekomandon që personeli që jep mësim në master me Msc apo studime afatgjata duhet të zëvendësohet me personel "Lektor". Paralelisht, pjesa e personelit me tituj dhe grada janë mjek dhe jo infermier. Kjo është po ashtu një pikë e dobët e AU. Programi nuk mbulohet me 70% nga stafi akademik me kohë të plotë. Kjo është një pikë e dobët e AU dhe GVJ rekomandon që të plotësohet ky kriter duke shtuar numrin e stafit akademik me kohë të plotë. Gjithashtu, nga dokumentacioni i personelit akademik rezulton se kemi staf akademik me kohë të plotë njëkohësisht në dy universitete (pedagogu me inicialet ML). Gjë që bie në kundërshtim me nenin 64, pika 2 e ligjit 80/2015. Personeli ndihmës akademik për realizimin e orëve laboratorike është vetëm një dhe ka kompetencën dhe angazhimin e duhur për realizimin e detyrave të tij, por nuk është i mjaftueshëm. GVJ konsideron shtim e numrit të stafit ndihmës akademik në funksione të orëve laboratorike. Në listën e marrëveshjeve mungon Spitalin "Nën Tereza". GVJ mendon se AU duhet të lidhi një marrëveshje bashkëpunimi me QSUT.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

<p>Standardi IV.2 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>GVJ gjatë guidës në institucion vuri re se ky Institucion ka hapsirat e nevojshme për zhvillimin e programit mësimor si: Sallat e leksioneve, të seminareve, laboratorët, biblioteka, etj. Hapësirat mësimore janë pajisur me infrastrukturën e nevojshme didaktike për zhvillimin e leksioneve, seminareve, laboratoreve dhe orëve praktike. Sallat e leksioneve janë pajisur me PC dhe projektor për prezantimin e e leksioneve në Power Point.</p> <p>Evidenca: - Vizita në institucion;</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e</p>	<p>Mjediset mësimore janë të pajisura me mjetet elektronike dhe teknologjisë së informacionit, që ndihmojnë në realizimin e</p>

<p>mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>procesit mësimor teorik dhe praktik. Sallat e leksionit janë të pajisura me projektorë që mundësojnë demostrimin me video të leksioneve të ndryshme. Personeli akademik ka kompjuter personal me lidhje internet, që bën të mundur edhe zbatimin e metodave të mësimdhënies në distancë.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Vizita në institucion;</i>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Salla për praktikë lëndore/profesionale dhe laboratorë për lëndën përbëjnë një bazë të konsiderueshme në funksion të programit të studimit dhe projekteve kërkimore të studentëve.</p> <p>Në këto laboratore studentët mund të realizojnë procedura si manipulimet e ndryshme per procedurat invazive, vendosje kateteresh, sonde nazogastrike etj. Kjo u jep mundësinë atyre të zhvillojnë lëndë të ndryshme si anatomi, fiziologji, lëndë infermierore etj.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Evidenca 4.9 Lista e Laboratoreve te Departamentit;</i> - <i>Tabela Aneks RVB BSc. Infermieri;</i> - <i>Vizita në institucion.</i>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Institucioni ka të instaluar një laborator informatike të pajisur me kompjutera dhe programe profesionale në përputhje me programin e studimit, ku zhvillohet lënda e Informatikës dhe Statistikës gjatë së cilës studentët marrin njohuri efektive mbi përdorimin e programeve bazë kompjuterike.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Tabela aneks-RVB- MP.I.Kirurgjikale.</i> - <i>Vizita në institucion</i>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin</p>	<p>AU ka nënshkruar marrëveshje me shumë institucione për realizimin e praktikave profesionale. Megjithatë GVJ konstaton se AU nuk ka marrëveshje me QSTU dhe kjo është një pikë e dobët për institucionin. <i>GVJ rekoamndon qe AU të nënshkruaj marrëveshje me QSUT.</i></p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Takimi me udhëheqësit e praktikave</i> - <i>Takim me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe Bazë</i> - <i>Evidenca 1.13 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit;</i>

e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorore me kapacitetet e nevojshme.									
Konkluzione	<i>GVJ gjatë guidës në institucion vuri re se ky Institucion ka hapsirat e nevojshme për zhvillimin e programit mësimor si: Sallat e leksioneve, të seminareve, laboratorët, biblioteka, etj. Mjediset mësimore janë të pajisura me mjetet elektronike dhe teknologjisë së informacionit, që ndihmojnë në realizimin e procesit mësimor teorik dhe praktik. Institucioni ka të instaluar një laborator informatike të pajisur me kompjutera dhe programe profesionale në përputhje me programin e studimit, ku zhvillohet lënda e Informatikës dhe Statistikës. AU ka nënshkruar marrëveshje me shumë institucione për realizimin e praktikave profesionale. Megjithatë GVJ konstaton se AU nuk ka marrëveshje me QSTU dhe kjo është një pikë e dobët për institucionin. GVJ rekoamndon që AU të nënshkruaj marrëveshje me QSUT.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi IV.3	
Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	GVJ bazuar në dokumentat e vëna në dispozicion, vizitën në institucion, në bibliotekë, takimin me stafin dhe studentët u informua se, studentët dhe stafi kanë në dispozicion tekste fizike dhe on-line. Institucioni siguron tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse në gjuhën shqipe dhe të huaj, leksione të shkruara/të printuara për programet e studimit. <i>Megjithatë literatura e përdorur (në bazë të syllabuseve) është shumë e vjetër, gjë që është një pikë e dobët për këtë program studimi. Përditësimin i fundit i bibliotekës është realizuar me libra të viteve 2015 e më herët. GVJ e konsideron si një pikë të dobët mbi të cilën Institucioni duhet të punoj më shumë.</i>

	<p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vizita në institucion - Vizita në bibliotekë - Takimi me stafin dhe student - Evidenca 2.9 Procedurë e pasurimit të bibliotekës; - Evidenca 4.9 Lista e librave në bibliotekë; - Evidenca 2.7 Syllabuset e lëndëve të programit të studimit; - Evidenca R 1.1 Pasurimi i bibliotekës me tekste në gjuhën shqipe; - Evidenca R 1.2 Pasurimi i bibliotekës me tekste të përkthyer nga autorë ndërkombëtarë
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet e literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>GVJ u informua se stafi akademik çdo fund viti akademik përditëson syllabusin, temat përkatëse, literaturën bazë dhe atë të rekomanduar, ciklin e leksioneve dhe bazuar në këtë përditësim bën dhe kërkesën për literaturë fizike apo on-line. GVJ konstaton se syllabuset kanë literaturë të pa përditësuar dhe se në vite kjo literaturë nuk ka ndryshime, gjithashtu përditësimi i bibliotekës ka literaturë më të vonë sesa viti 2015. Kjo është një pikë e dobët dhe GVJ rekomandon që të punohet më shumë në këtë drejtim.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 2.7 Syllabuset e lëndëve të programit të studimit; - Evidenca 4.9 Lista e librave në bibliotekë; - Evidenca 2.9 Procedurë e pasurimit të bibliotekës; - Evidenca R 1.1 Pasurimi i bibliotekës me tekste në gjuhën shqipe; - Evidenca R 1.2 Pasurimi i bibliotekës me tekste të përkthyer nga autorë ndërkombëtarë
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se AU vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën mësimore. Biblioteka është në dispozicion të stafit dhe studentëve në mënyrë të barabartë në të gjitha programet dhe ciklet e studimit. Biblioteka nuk ka një rregullore të brendshme përket mënyrës së tërheqjes, shfrytëzimit dhe trajtimit të librave, megjithatë nuk ka asnjë kushtim të shfrytëzimit të librave në bibliotekë që lidhet me programin apo fushën e studimit. Studentët mund të shfrytëzojnë gjithë fondin e bibliotekës, pavarësisht nga fusha që studiojnë. GVJ konstaton se përditësimi i bibliotekës rezulton me literaturë të vjetër dhe rekomandon që të bëhet pasurimi i bibliotekës.</p>
	<p>Evidenca:</p>

	<ul style="list-style-type: none"> - <i>Vizita në bibliotekë</i> - <i>Evidenca 2.9 Procedurë e pasurimit të bibliotekës.</i> - <i>Evidenca 4.9 Lista e librave në bibliotekë;</i> - <i>Evidenca 2.7 Syllabuset e lëndëve të programit të studimit;</i> - <i>Evidenca R 1.1 Pasurimi i bibliotekës me tekste në gjuhën shqipe;</i> - <i>Evidenca R 1.2 Pasurimi i bibliotekës me tekste të përkthyer nga autorë ndërkombëtarë</i>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion dhe takimin me stafin e bibliotekës u informua se ka një numër të konsiderueshëm të literaturës. Studentët dhe stafi akademik kanë të drejtë pa pagesë shfrytëzimin jo vetëm të literaturës fizike, por edhe on-line, për realizimin sa më të mirë të procesit mësimor dhe moduleve të programive të studimeve. <i>GVJ konstatoi se literatura është nuk është e përditësuar. GVJ rekomandon pasurimin dhe përditësimin e literaturës.</i></p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Vizita në bibliotekë</i> - <i>Evidenca 2.9 Procedurë e pasurimit të bibliotekës;</i> - <i>Evidenca 2.7 Syllabuset e lëndëve të programit të studimit;</i> - <i>Evidenca R 1.1 Pasurimi i bibliotekës me tekste në gjuhën shqipe;</i> - <i>Evidenca R 1.2 Pasurimi i bibliotekës me tekste të përkthyer nga autorë ndërkombëtarë</i>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se AU disponon librari online si EBSCO, ERIC, etj. Kjo gjë i jep mundësi studentëve dhe stafit akademik të shfrytëzojë pa pagesë literaturat në funksion të programit të studimit.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Evidenca 4.10 Librarite elektronike.</i>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>GVJ konstatoi se fondi i bibliotekës mbulonte kryesisht fushat e shkencave mjekësore, stomatologjike, farmaceutike dhe të shkencave teknike mjekësore, në gjuhë shqipe dhe të huaj. Bibliotekë ofronte mundësi kërkimi të informacionit në sallën e leximit dhe pranë kompjuterave të sallës.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Vizita në bibliotekë</i>

<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Në bibliotekën e AU kishte një sallë studimi me pajisje kompjuterike që krijonte mundësinë për të punuar në mënyrë individuale apo edhe në grup. Oraret e shfrytëzimit të bibliotekës ishin përshtatur për studentët në përputhje me orarin e tyre të mësimit. Kjo gjë u krijonte mundësinë studentëve për shfrytëzimin maksimal të saj.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vizita në bibliotekë
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Biblioteka funksiononte gjatë gjithë orëve të mësimit. Orientimi i studentëve për përzgjedhjen e literaturës në përgjithësi bëhej nga stafi akademik. <i>GVJ konstatoi se nuk kishte një literaturë bashkëkohore ku stafi kishte mundësi të përditësonte leksionet. Pasurimi i bibliotekës ishte bërë në vitin 2018 për herë të fundit. Gjithashtu literatura ishte me e vonë se e vitit 2015.</i></p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vizita në bibliotekë - Evidenca 2.9 Procedurë e pasurimit të bibliotekës; - Evidenca 2.7 Syllabuset e lëndëve të programit të studimit; - Evidenca R 1.1 Pasurimi i bibliotekës me tekste në gjuhën shqipe; - Evidenca R 1.2 Pasurimi i bibliotekës me tekste të përkthyer nga autorë ndërkombëtarë
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni siguron tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse në gjuhën shqipe dhe të huaj, leksione të shkruara/të printuara për programet e studimit. Megjithatë literatura e përdorur (në bazë të syllabuseve) është shumë e vjetër, gjë që është një pikë e dobët për këtë program studimi. Përditësimin i fundit i bibliotekës është realizuar në vitin 2018 me libra të viteve 2015 e më herët. GVJ e konsideron si një pikë të dobët mbi të cilën Institucioni duhet të punoj më shumë. GVJ konstatoi se AU disponon librari online si EBSCO, ERIC, etj. Kjo gjë i jep mundësi studentëve dhe stafit akademik të shfrytëzojë pa pagesë literaturat në funksion të programit të studimit. GVJ konstatoi se fondi i bibliotekës</i></p>

	<i>mbulonte kryesisht fushat e shkencave mjekësore, stomatologjike, farmaceutike dhe të shkencave teknike mjekësore, në gjuhë shqipe dhe të huaj. Bibliotekë ofronte mundësi kërkimi të informacionit në sallën e leximit dhe pranë kompjuterave të sallës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	AU ka sistem menaxhimi të brendshëm për administrimin e informacionit që lidhet studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. UAL dispononte softin PITAGORA, ku mbahet gjithë informacioni për studentin, si dhe regjistri themeltar sipas formatit të miratuar nga MAS. Evidenca: - <i>Vizitë te sekretaria</i> - <i>Evidenca 3.13 Rregullore e sekretarisë mësimore.</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Zyra e Burimeve Njerëzore në AU administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. GVJ nga takimi me përfaqësuesit e zyrës së burimeve njerëzore konstatoi se dosjet e personelit akademik ishin të plotësuar. Evidenca: - <i>Takimi me Zyrën e burimeve njerëzore</i>
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	AU përdorin sistemin Pitagora për menaxhimin e të dhënave mësimore dhe për personelin dhe studentët. Evidenca: - <i>Evidenca 3.4 Manual i pedagogut për përdorimin e platformes PITAGORA</i>

<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>AU dispononte infastrukturën për një edukim në distancë, por që këtë infrastrukturë e përdorte dhe për informimin e studentëve në lidhje me veprimtari, takime, mbjedhje, diskutime, kërkim shkencor, mobilitete, etj. Një shëmbull është dhe mësimi online gjatë pandemisë me anë të microsoft teams. Tani kjo metodë nuk përdoret më.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 3.3 Manual për realizimin e mësimit online 2020 - 2021. - Evidenca 3.2.a Klasë në Microsoft Teams 			
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>AU me anë të sistemit Pitagora jep informacion në kohë reale të materialeve në modulet e programit që studenti frekuentonte. Falë Zyrës së IT bëhej e mundur mirëmbajtja e sistemit duke bërë të mundur përdorimin në çdo kohë.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 3.4 Manual i pedagogut për përdorimin e platformes PITAGORA 			
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>AU zotëron një faqe web aktive në dy gjuhë; shqip dhe anglisht, që mund të aksesohet nga çdo njeri. Kjo faqe është dinamike dhe jep infomacioneve të ndryshme.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 3.14 Faqja WEB e universitetit. 			
<p>Konkluzione</p>	<p>AU ka sistem menaxhimi të brendshëm për administrimin e informacionit që lidhet studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. UAL dispononte softin PITAGORA, ku mbahet gjithë informacioni për studentin, si dhe regjistri themeltar sipas formatit të miratuar nga MAS. AU zotëron një faqe web aktive në dy gjuhë; shqip dhe anglisht, që mund të aksesohet nga çdo njeri. Kjo faqe është dinamike dhe jep infomacioneve të ndryshme.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi IV.5



Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Në AU, përgatitja e buxhetit, mënyra e shpërndarjes së fondeve dhe përdorimit të tyre, është kompetencë e institucionit dhe menaxhohet nga Bordi i Administrimit. AU gjeneronte të ardhura nga studentët, shërbimet përkundrejtë palëve të treta, projekteve, etj. Shpërndarja financiare realizohet sipas nevojave që kanë njësitë përberëse të institucionit. Propozimet vinin nga baza dhe miratimi i tyre bëhej nga Rektori. Evidenca: - <i>Evidenca 1.14 Raport Vjetor Institucional 2021-2022.</i>
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Proçesi i hartimit të planit financiar nis me diskutimet dhe marrjen e propozimeve nga njësitë bazë (departamentet) dhe strukturat administrative të fakultetit. Pas shqyrtimit dhe miratimit të propozimeve, fakulteti përcjell planin në nivel fakulteti në Rektorat. Në planin e financimit përfshiheshin zëra për: burimet njerëzore dhe infrastrukturore, materialet e konsumit, pajisjet, zhvillimin e praktikave spitalore, pasurimin e bibliotekës, kostot e auditeve të brendshëm dhe të jashtëm si dhe mundësitë e mbështetjes financiare, ku AU ishte partner i vetëm dhe vetfinancohte të gjitha shpenzimet. Evidenca: - <i>Evidenca 1.14 Raport Vjetor Institucional 2021-2022</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Bazuar në shkresat e depozituara nga Institucioni, konstatohet se AU harton pasqyrat financiare të cilat tregojnë gjendjen e biznesit dhe masën e realizimit të Projekt-Buxhetit të përcaktuar në çdo fundvit akademik. Zyra e auditit të brendshëm zhvillon auditime ndërsa Bordi i Administrimit është organi kompetent për këto

	<p>kontrolle. Auditime zhvillohen dhe nga organe të tjera jashtë institucionit.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.1 Statuti i AU; - Evidenca 1.3 Organigrama e AU; - Evidenca 1.11 Raport Vjetor Institucional 2021-2022; <p>Evidenca Nr. 6 e dokumentave shtesë.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Zyra e auditimit harton raportet vjetore dhe Bordi i administrimit planifikon ndërhyrjet e posaçme për të garantuar ecurinë normale. Këto raportime nuk zbresin deri në nivelin e departamentit dhe programeve të studimit, por janë më përgjithësuese.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.11 Raport Vjetor Institucional 2021-2022; - Evidenca Nr. 6 e dokumentave shtesë.
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>GVJ bazuar në RVB, referencat përkatëse si dhe takimin me drejtuesit e institucionit konstaton se institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve.</p> <p>Të ardhurat siguroheshin kryesisht nga tarifat e shkollimit dhe të ardhurat nga shërbimet që kryhen.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.14 Raport Vjetor Institucional 2021-2022.
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në AU, përgatitja e buxhetit, mënyra e shpërndarjes së fondeve dhe përdorimit të tyre, është kompetencë e institucionit dhe menaxhohet nga Bordi i Administrimit. AU gjeneron të ardhura nga studentët, shërbimet përkundrejtë palëve të treta, projekteve, etj. Shpërndarja financiare realizohet sipas nevojave që kanë njësitë përberëse të institucionit. Propozimet vinin nga baza dhe miratimi i tyre bëhet nga Rektorati. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>GVJ gjatë bashkëbisedimit me drejtues të institucionit, studentët, koordinatorin e programit, sekretarinë mësimore, RVB, konstatoi se ky institucion harton politika dhe procedura të sakta gjatë vitit akademik të studentëve (në hyrje dhe në përfundim të studimeve), në përputhshmëri me legjislacionin në fuqi.</p> <p>Institucioni disponon akte rregullatore për strukturat dhe njësitë kryesore në përputhje me statutin e universitetit. Institucioni, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të miratuara nga Senati Akademik, zbaton procedura, të cilat garantojnë të drejta të njëjta, për të gjithë studentët. Mundësohet ndjekja korrekte e kandidatit që nga momenti i aplikimit deri në përmbylljen e detyrimeve akademike dhe diplomimin e tij. Çdo student që paraqet kërkesë për transferim për largim apo kalim në UAL ka të drejtë ta realizojë këtë në bazë të rregullores dhe legjislacionit në fuqi.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Takim me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe Njesisë Bazë; - Evidenca 1.5 Rreg e Fakultetit të Shkencave Mjekesore.; - Evidenca 2.6 Rregullore e "Regjistrimeve dhe transferimeve"
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, në sekretarinë mësimore GVJ vuri re se ky institucion bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë Shqiptar, nr. 80/2015, statutin e AU siguron barazinë bazuar mbi kriteret dhe</p>

<p>drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>procedurat për të gjithë kandidatët për tu rregjistruar në Programin e Studimit të Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”</p> <p>Studentët kanë mundësi të njëjta informimi, studimi, kandidimi për forume drejtuese, pjesëmarrje në aktivitete promovuese, konkurimi për bursa apo mobilitete në kuadër të projekteve të ndryshme.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.1 Statuti i “Albanian University” - Evidenca 3.13 Rregullore e sekretarisë mësimore; - Evidenca 3.6 Lajmërim për një leksion të hapur; - Evidenca 3.12 Leksionet e hapura 2019-20223 - Evidenca 5.12 Aktivitete ekstrakurrikulare.
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>GVJ në takimin me stafin pedagogjik dhe studenët si dhe dokumentat e vëna në dispozicion, u informua dhe konstatoi se para çdo viti akademik, në afatet e përcaktuara nga MASR organizohen “ditët e informimit të maurantëve” në gjimnazet kryesore të qarkut Tiranë dhe qarqet fqinje të cilat përbëjnë burimin kryesor të studentëve që ndjekin studimet në Fakultet.</p> <p>AU harton dhe publikon përpara çdo viti kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, duke u bazuar në vendimet e Senatit Akademik në mbështetje të kriterëve kombëtare, të propozuara nga njësitë bazë. Programi i studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” ofrohet vetëm në gjuhën shqipe.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Takim me stafin akademik; - Evidenca 5.1 Vendim Senati për miratimin e kuotave të pranimit. - Evidenca 5.2 Vendim për miratimin e kriterëve të pranimit për programin e studimit.pdf
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>GVJ konstatoi se AU ka një rregullore të veçantë për transferimin e studentëve nga programe të ngjashme dhe ndjekjen e programve të dyta studimi. Kështu që studentët kanë mundësi të informohen në lidhje me transferimin apo ndjekjen e fakulteteve të dyta.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 2.6 Rregullore e “Regjistrimeve dhe transferimeve”

<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se AU merret seriozisht me informimin e publikut duke marrë pjesë në Panairt work & Study të organizuara nga MAS dhe organizon orët e hapura në AU për maturantët. Gjithashtu ofron informacion me anë fletëpalosjeve, faqes zyrtare web, rrjeteve sociale, etj.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 5.3 Panairi "Work&Study". - Evidenca 5.4 Udhëzues orientues për maturantët - Evidenca 5.7 Axhenda e javes orientuese
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>GVJ konstatoi se infrastruktura e re e AU, e vënë në dispozicion, është përshtatshme për t'u aksesuar si me këmbë ashtu edhe me mjete ndihmëse si rampa, ashensorë etj. për studentët me aftësi ndryshe. Në këtë mënyrë sigurohet barazia për të gjithë kandidatët me aftësi të veçanta. Gjithashtu politikat e UA nuk përbëjnë diskriminim për njëri përkatësi të ndryshme.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 4.8 Planimetria e Godines FSHM; - Evidenca shtese 4 Listë e studentëve që kanë përfituar bursë nga Institucioni.
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>AU i ofron mundësi studentëve që vijnë nga trojet apo shtetas të huaj për të ndjekur studimet. Nëpërmjet faqes Web të AU, fletë palosjeve, reklamave televizive, Zyrës së karrierës dhe këshillimit, ofron informacion për mënyrën e ndjekjes së procedurave për regjistrim. Megjithatë nuk u konstatua pjesëmarrja e këtij kontigjenti në këtë universitet.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 5.3 Panairi "Work&Study". - Evidenca 5.4 Udhëzues orientues për maturantët
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimin në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>GVJ konstatoi se AU ka politika mbështetëse për shtetas në nevojë duke i mbështetur ata nga ana ekonomike, duke ulur tarifatat për vitin akademik sipas rasteve. Nga dokumentacioni i sjellë nga AU, rezultojnë shumë studentë që kanë përfituar mbështetje ekonomike.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 5.5 Lista e bursave dhe tarifave lehtësuese; - Evidenca shtese 4 Listë e studentëve që kanë përfituar bursë nga Institucioni.

Konkluzione	<i>Institucioni disponon akte rregullatore për strukturat dhe njësitë kryesore në përputhje me statutin e universitetit. Institucioni, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të miratuara nga Senati Akademik, zbaton procedura, të cilat garantojnë të drejta të njëjta, për të gjithë studentët. GVJ konstatoi se AU ka një rregullore të veçantë për transferimin e studentëve nga programe të ngjashme dhe ndjekjen e programve të dyta studimi. Kështu që studentët kanë mundësi të informohen në lidhje me transferimin apo ndjekjen e fakulteteve të dyta. GVJ konstatoi se AU ka politika mbështetëse për shtetas në nevojë duke i mbështetur ata nga ana ekonomike, duke ulur tarifën për vitin akademik sipas rasteve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	GVJ, referuar dokumentacionit të dorëzuar, rregullores së programit të studimit, faqes zyrtare të web si dhe takimit me përfaqësues të tij, konkludon se i gjithë informacioni i plotë dhe i hollësishëm gjendet në rregulloren mësimore të programit të studimit dhe aktet e tjera rregullatore. Gjithashtu u konstatua se studentët informoheshin nga zyra e karrierës, përgjegjësi i programit të studimit dhe tutori i vitit përkatës në lidhje me rregulloret e shkollës, rregulloren e programit, kushtet e frekuentimit, format e kontrollit, pikëzimet, etj. Evidenca: <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.7 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale"; - Evidenca 2.4 Vendim për caktimin e koordinatorit të programit Master "Infermeiri Kirurgjikale". - Evidenca 3.14 Faqja WEB e universitetit. - Evidenca 5.11 Rregullore Zyra e Karrierës dhe Alumnit.
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e	GVJ konstatoi se AU nga një rregullore në lidhje me transferimet dhe programet e dyta të studimit ku studentët marrin informacion në lidhje me procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme

<p>njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>ose studimeve të pjesshme. Në këtë rregullore citohet se AU ofron mundësi për transferime studentësh hyrëse dhe dalëse në vite të ndërmjetme, ndërmjet programeve të të njëjtit cikël, brenda vetë institucionit apo institucione të tjera.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Evidenca 2.6 Rregullore e "Regjistrimeve dhe transferimeve"</i>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi nga vizita me studentet se studentët informohen mbi kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive në programin e studimit nëpërmjet rregullores së fakultetit, departamentit dhe programit të studimit, syllabuseve të lëndëve të publikuara dhe prezantimit të pedagogut përkatës në orën e parë të mësimin, si dhe nga sekretaria mësimore e departamentit. Studentët informuan GVJ se në cdo javë të parë të semestrit informohen dhe diskutojnë me pedagogët e lëndëve mbi procedurën e vlerësimit të tyre për cdo lëndë duke u njohur me syllabusin e lëndës.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Evidenca 1.5 Rreg e Fakultetit të Shkencave Mjekesore.;</i> - <i>Evidenca 1.6 Rregullore Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë;</i> - <i>Evidenca 1.7 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale";</i> - <i>Evidenca 2.7 Syllabuset e lëndëve të programit të studimit;</i> - <i>Evidenca 3.13 Rregullore e sekretarisë mësimore.</i> - <i>Takim me studentët</i>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se programi i studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale" përmbillet me zhvillimin e provimit përfundimtar që zhvillohet me teze ose mbrojtje diplome me temë. Kjo bazuar në rregulloern e programit të studimit Neni 28. Pra studentët diplomohen sipas rastit dhe kriterëve të vendosura në rregullore. Nga raporti vjetor i departamentit, tregohet se studentët me mesatare më të lartë kanë përgatitur temë diplome.</p> <p>Tematika e provimit dhe temat e diplomës miratohen nga Departamenti, brenda një muaji nga fillimi i vitit akademik. Provimi i diplomës bëhet në dy sesione diplomimi të cilat përcaktohen nga Dekani i Fakultetit. Studenti që nuk paraqitet ose vlerësohet negativisht në sesionin e parë të provimeve, ka të drejtë të paraqitet në provim në sesionin e ardhshëm. Në fillim të vitit</p>

	<p>akademik, Përgjegjësi i Departamentit u bën të njohur studenteve listën e lëndëve. Departamenti përcakton datën e zhvillimit të provimit të diplomes. Detyrimet përmbyllëse kanë në total 10 kredite. Praktika profesionale është e parashikuar në Programine studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” dhe ka 6 kredite.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.4 Rregullore e Përgjithshme “Albanian University”; - Evidenca 1.5 Rreg e Fakultetit të Shkencave Mjekesore; - Evidenca 1.7 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”; - Evidenca 2.1 Kurrikula e programit të studimit MP në “Infermieri Kirurgjikale”; - Evidenca 2.12 Raport vjetor të Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë v.a 2021-2022.
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se AU përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike duke marrë pjesë në Panairët work & Study të organizuara nga MAS dhe organizon orët e hapura në AU për maturantët. Gjithashtu ofron informacion me anë fletëpalosjeve, faqes zyrtare web, rrjeteve sociale, etj.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 5.3 Panairi “Work&Study”. - Evidenca 5.4 Udhëzues orientues për maturantët - Evidenca 5.7 Axhenda e javës orientuese
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstatoi se AU nga një rregullore në lidhje me transferimet dhe programet e dyta të studimit ku studentët marrin informacion në lidhje me procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. GVJ konstatoi nga vizita me studentet se studentët informohen mbi kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive në programin e studimit nëpërmjet rregullores së fakultetit, departamentit dhe programit të studimit, syllabuseve të lëndëve të publikuara dhe prezantimit të pedagogut përkatës në orën e parë të mësimin, si dhe nga sekretaria mësimore e departamentit. GVJ konstatoi se programi i studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” përmbillet me zhvillimin e provimit përfundimtar që zhvillohet me teze ose mbrojtje diplome me temë. Kjo bazuar në rregulloern e programit të</p>



	<i>studimit Neni 28. GVJ konstatoi se AU përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike duke marrë pjesë në Panairot work & Study të organizuara nga MAS dhe organizon orët e hapura në AU për maturantët.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	<p>GVJ në bazë të dokumentave referuese, planet mësimore, rregullore, statutit, takimit me drejtues te institucionit, sekretarine mësimore, studentët konstaton se, AU vendos në dispozicion të studentëve informacionin e nevojshëm rreth strukturës, organizimit të programit mësimor dhe kohëzgjatjes së programit të studimit. Informacionin studentët e marrin nëpërmjet takimeve me stafin akademik që i pret në institucion në momentin që interesohen për programet e studimit, nëpërmjet kontakteve me Zyrën e Karrieres, Kordinatorin dhe stafin pedagogjik, si dhe vënies në dispozicion të studentëve të rregullores së brendshme dhe rregullores së programit të studimit.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.5 Rreg e Fakultetit te Shkencave Mjekesore.; - Evidenca 1.6 Rregullore Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë; - Evidenca 1.7 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”; - Takimi me studentët; stafin akademik; sekretarinë mësimore
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	<p>GVJ bazuar në takimin me drejtues të institucionit, takimi me stafin akademik, sekretarinë mësimore si dhe takimi me studentët mendon se: AU informon studentët në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe ve në dispozicion të tyre, informacion të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”.</p>

	<p>Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për kohëzgjatjen e programit të studimeve edhe nëpërmjet web-it. Po ashtu në orën e parë studentët marrin informacion të detajuar nga pedagogët e lëndëve për syllabusin përkatës ku shprehen qartë: kreditet, kodi lëndor, raporti leksion/ seminar/ laborator/ praktik, temat, literaturë bazë dhe literaturën e rekomanduar, format e kontrollit dhe vlerësimit, detyrimet për lëndën (projekte, detyra kursi), niveli i detyrueshëm i frekuentimit të lëndës etj.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.6 Rregullore Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë; - Evidenca 1.7 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale"; - Evidenca 2.7 Syllabuset e lëndëve të programit të studimit; - Takimi me studentët; stafin akademik; sekretarinë mësimore
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>AU vë në dispozicion Zyrën e këshillimit të karrierës për studentët që kanë paqartësi në lidhje me orientimin apo mundësitë e punësimit. Në takimin me studentët, ata u shprehen se zyra e Këshillimit ishte një derë e hapur për ta dhe se sa herë kishin patur nevojë, kishin marrë mbështetjen e nevojshme.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca shtese 7. Listë e aktiviteteve të organizuara nga zyra e Karrierës dhe Alumni; - Evidenca 5.8 Rregullore e Zyres se Karrieres dhe Alumnit; - Evidenca 5.7 Rregullore e Zyres se Koordinimit dhe Mbeshtetjes se Studenteve; - Takimi me studentet.
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>GVJ gjatë vlerësimit të dokumentacionit dhe takimit me studentët evidentoi që studentët informohen hollësisht dhe gjëresisht për infrastrukturën dhe organizimin e programit të studimit, duke filluar nga organizimi i syllabuseve, orari i mësimit, aktivitete jashtë kurrikulare, logjistikën, laboratorët, modalitetet e organizimit të praktikave profesionale dhe strukturat ndihmëse.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 5.13 Aktivitete ekstrakurrikulare - Evidenca 2.1 Kurrikula e programit të studimit MP në "Infermieri Kirurgjikale";

	<ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 2.7 Syllabuset e lëndëve të programit të studimit; - Takimi me studentët; stafin akademik; 			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	<p>GVJ konstatoi se AU informon studentët nëpërmjet faqes zyrtare web të AU dhe sistemit Pitagora. Këtu studenti merr informacion në lidhje me provimet, lëndët, kurrikulën, notat, etj.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 3.14 Faqja WEB e universitetit. - Evidenca 3.4 Manual i pedagogut për përdorimin e platformes PITAGORA 			
Konkluzione	<p>GVJ në bazë të dokumentave referuese, planet mësimore, rregullore, statutit, takimit me drejtues të institucionit, sekretarinë mësimore, studentët konstaton se, AU vendos në dispozicion të studentëve informacionin e nevojshëm rreth strukturës, organizimit të programit mësimor dhe kohëzgjatjes së programit të studimit. AU informon studentët në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe ve në dispozicion të tyre, informacion të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale".</p> <p>AU vë në dispozicion Zyrën e këshillimit të karrierës për studentët që kanë paqartësi në lidhje me orientimin apo mundësitë e punësimit. GVJ konstatoi se AU informon studentët nëpërmjet faqes zyrtare web të AU dhe sistemit Pitagora.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Bazuar në informacionin në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se AU mban dhe disponon statistika vjetore mbi numrin e studentëve të regjistruar dhe diplomuar sipas programeve dhe cikleve të studimit. Sekretaria mësimore mbante informacion në lidhje me studentët e regjistruar duke ju referuar udhëzimeve të MAS dhe QSHA, në formë fizike dhe elektronike.


	<p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Takimi me sekretarinë mësimore;</i> 																
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Gjatë vizitës në AU, GVJ konstatoi se regjistrat e sekretarisë mësimore (themeltar, i arritjeve akademike dhe ai i dhënies së diplomave) janë të formatuar dhe të përditësuar sipas standardeve ligjore në fuqi. Pranë sekretarisë depozitohen edhe dokumentacioni i përgatitur nga personeli akademik lidhur me frekuentimin e studentëve dhe procesverbalet e vlerësimeve sipas lëndëve. Të dhënat për regjistrimin e studentëve në këtë program studimi për 3 vitet e fundit akademike paraqiten si vijon:</p> <table border="1" data-bbox="587 683 1417 891"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Të regjistruar</th> <th>Transferime</th> <th>Totali</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2019-2020</td> <td>98 studentë</td> <td>0</td> <td>98 studentë</td> </tr> <tr> <td>2020-2021</td> <td>68 studentë</td> <td>0</td> <td>68 studentë</td> </tr> <tr> <td>2021-2022</td> <td>93 studentë</td> <td>0</td> <td>93 studentë</td> </tr> </tbody> </table> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Tabela aneks-RVB- MP.I.Kirurgjikale, tab 21.</i> 	Viti akademik	Të regjistruar	Transferime	Totali	2019-2020	98 studentë	0	98 studentë	2020-2021	68 studentë	0	68 studentë	2021-2022	93 studentë	0	93 studentë
Viti akademik	Të regjistruar	Transferime	Totali														
2019-2020	98 studentë	0	98 studentë														
2020-2021	68 studentë	0	68 studentë														
2021-2022	93 studentë	0	93 studentë														
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Bazuar në informacionin e RVB dhe në vizitën në institucion, GVJ konstatoi se ruajtja dhe menaxhimi i të dhënave statistikore të studentëve realizohet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe kërkesat e statutit dhe rregulloreve të AU. Në sekretarinë mësimore ndodhej i gjithë dokumentacioni i duhur për arritjet e studentëve në bazë të moduleve dhe cikleve akademike. I gjithë informacioni ruhej në formë fizike dhe elektronike. Në rregulloren e sekretarisë mësimore tregohen dhe procedurat e marrjes së dokumentacioneve. Në mendimin e GVJ, informacioni është i sigurt dhe lehtësisht i verifikueshëm nga personat e autorizuar.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Takimi me sekretarinë mësimore;</i> - <i>Evidenca 4.5 Rregullore e sekretarisë mësimore;</i> - <i>Evidenca 3.7 Manual për përdorimin e platformes PITAGORA.</i> 																
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore,</p>	<p>Sekretarisa Mësimore e AU është strukturë ndihmës akademike me karakter administrativ, në nivel institucioni e cila zhvillon veprimtarinë në përputhje me kërkesat e kuadrin rregullator në fuqi. Nga vizita që patëm në zyrat e sekretarisë, GVJ konstatoi se i gjithë dokumentacioni ishte në rregull. Bazuar dhe në rregulloren e</p>																

<p>sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>sekretarisë mësimore tregohen dhe procedurat e marrjes së dokumentacioneve. Në bazë të rregulores së përgjithshme të AU, neni 14, pika 5, NJSBC realizon monitorimin e strukturave akademike dhe ndihmës akademike dhe i raporton ato në mënyrë periodike (neni 4), kjo e bazuar në Statutin të AU, neni 67.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.1 Statuti i AU; - Evidenca 1.5 Rregullore e përgjithshme e AU; - Evidenca 4.5 Rregullore e sekretarisë mesimore; - Takimi me sekretarinë mësimore. 			
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Referuar RVB-së, Institucioni përpilon një raport vjetor gjithëpërfshirës të të gjitha njësive dhe programeve që ofrojnë, ku mes të tjerash analizohet cilësia e studentëve në hyrje dhe në dalje dhe sygjerohen masa për përmirësim.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.11 Raport semestral Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë 2021-2022. - Evidenca 1.12 Raport vjetor Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë 2021-2022. - Evidenca 1.14 Raport Vjetor Institucional 2021-2022. - Evidenca 1.17 Raport analitik i përfitimit nga marrëveshjet e bashkëpunimit. 			
<p>Konkluzione</p>	<p>AU mban dhe disponon statistika vjetore mbi numrin e studentëve të regjistruar dhe diplomuar sipas programeve dhe cikleve të studimit. Sekretaria mësimore mbante informacion në lidhje me studentët e regjistruar duke ju referuar udhëzimeve të MAS dhe QSHA, në formë fizike dhe elektronike. Ruajtja dhe menaxhimi i të dhënave statistikore të studentëve realizohet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe kërkesat e statutit dhe rregulloreve të AU. Në sekretarinë mësimore ndodhej i gjithë dokumentacioni i duhur për arritjet e studentëve në bazë të moduleve dhe cikleve akademike. I gjithë informacioni ruhej në formë fizike dhe elektronike. Institucioni përpilon një raport vjetor gjithëpërfshirës të të gjitha njësive dhe programeve që ofrojnë, ku mes të tjerash analizohet cilësia e studentëve në hyrje dhe në dalje dhe sygjerohen masa për përmirësim.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, rezulton se AU bazuar në Rregulloren e AU si dhe Statutin e AU u mundëson studentëve përfaqësimin në organet vendimmarrëse si në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Senatin Akademik; (kryetari i KS është anëtar i SA) - Grupet e RBV; - Këshillin studentor; - NJSBC <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Evidenca H1 Ngritja e GVB</i> - <i>Evidenca H2 Miratimi i GVB nga Dekani</i> - <i>Evidenca 6.9 Rregullore Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</i> - <i>Evidenca 1.4 Rregullore e Përgjithshme "Albanian University";</i> - <i>Evidenca 1.1 Statuti i "Albanian University"</i>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>GVJ konstaton se aktualisht AU përdor sistemin e pyetësorëve me studentët për vlerësimin e stafit akademik dhe lëndëve sipas programeve dhe cikleve të studimit që ata ndjekin. Përpunimi i të dhënave bëhet nga NJSBC dhe përfundon me hartimin e Raportit të Analizës dhe Vlerësimit të Pyetësorëve, i cili u komunikohet organeve drejtuese, individualisht secilit prej pedagogëve, dhe më pas përgjegjësit të njësisë bazë për të analizuar rezultatet dhe marrjen e masave përkatëse. Gjithashtu departamenti përgjegjës për këtë program studimi mirëpret sugjerimet, vërejtjet dhe rekomandimet e studentëve në çdo kohë, nëpërmjet anëtarëve të këshillave studentorë dhe kordinatorit të programit të studimit.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Evidenca 6.9 Rregullore Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</i> - <i>Evidenca 3.5 Raport semestral i personelit akademik.</i>



	<ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 6.8 Pyetësorët e studentëve v.a 2022-2023 - Evidenca 5.9 Pyetesori i studenteve "Alumni".
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>GVJ konstatoi përfshirjen e studentëve në procese akademike me pjesëmarrje në NJSBC, GVB, Senat akademik, gjë e cila garanton dëgjimin e zërit të studentëve në vendimmarrje. Njësia kryesore dhe ajo bazë, përgjegjës për këtë program studimi marrin në konsideratë mendimin dhe opinionin e studentëve (vërejtjet, sugjerimet, komentet) nëpërmjet anëtarëve të këshillave studentorë, si dhe nëpërmjet kordinatorit të programit, në lidhje me procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Ndërkohë zyra e NJSBC-së përpunon të dhënat e pyestorëve, të cilët janë të ndarë vec për stafin akademik dhe vec për lëndët që zhvillohen në këtë program. Ky feedback i jep mundësi reflektimi pedagogut të lëndës për problematika që mund të hasen, por edhe më gjerë duke marrë vendime përkatëse në hartim, rishikim dhe përmirësim programi.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 6.9 Rregullore Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. - Evidenca 3.5 Raport semestral i personelit akademik. - Evidenca 6.8 Pyetësorët e studentëve v.a 2022-2023. - Evidenca 5.9 Pyetesori i studenteve "Alumni".
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Në rregulloren e departamentit dhe rregulloren e programit të studimit sanksionohet dhe përcaktohet procedura e vlerësimit të ankesës së studentit për rezultatin e provimit. Procedura dokumentohet qartë në RVB. Në takim me GVJ, studentët shprehën të kënaqur me mënyrën e organizimit të provimeve dhe me mundësitë që ata kanë për ankimim rezultati dhe rishikim të tezës së provimit. Nga takimi me stafin akademik dhe studentët u vërejt se fryma në institucion është tepër pozitive. Është në filozofinë e institucionit që studentët të vlerësohen drejt dhe të përvehtësojnë sa më shumë dije.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.6 Rregullore Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë; - Evidenca 1.7 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale"; - RVB Infermieri Kirurgjikale. - Takimi me studentë dhe stafin akademik

Konkluzione	<p><i>AU bazuar në Rregulloren e AU si dhe Statutin e AU u mundëson studentëve përfaqësimin në organet vendimmarrëse si në: Senatin Akademik; (kryetari i KS është anëtar i SA); Grupet e RBV; Këshillin studentor; NJSBC.</i></p> <p><i>Njësia kryesore dhe ajo bazë, përgjegjës për këtë program studimi marrin në konsideratë mendimin dhe opinionin e studentëve (vërejtjet, sugjerimet, komentet) nëpërmjet anëtarëve të këshillave studentorë, si dhe nëpërmjet kordinatorit të programit, në lidhje me procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Në rregulloren e departamentit dhe rregulloren e programit të studimit sanksionohet dhe përcaktohet procedura e vlerësimit të ankesës së studentit për rezultatin e provimit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>AU ka në organigramë dhe Zyrën e Informimit dhe Zhvillimit të Karrierës. GVJ konstatoi se kjo zyrë funksionon në bazë të rregullore së miratuar së miratuar nga Senati akademik. Kjo zyrë realizon informimin e studentëve që nga momenti i regjistrimit e deri në diplomim. Studentët gjithashtu informohen edhe nga faqja e webit e cila përditësohet vazhdimisht.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 5.11 Rregullore Zyra e Karrierës dhe Alumnit. - Evidenca 5.12 Udhëzuesi i Karrierës - Evidenca 3.14 Faqja WEB e universitetit. - Evidenca 5.10 Rregullore Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët.
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të</p>	<p>Nga kontakti i GVJ me studentët, konstatoi se ata ishin të kënaqur për aksesin në informacion, për disponibilitetin e sekretarisë për asistimin në aspekte të procesit mësimor, për pjesmarrjen në aktivitete shkencore, promovuese dhe trajnuese bashkë me pedagogët. Koordinator i programit të studimit, luan një rol të rëndësishëm në informimin dhe përditësimin e studentëve lidhur</p>

<p>bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>me zhvillimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të këtij programi studimi.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 5.11 Rregullore Zyra e Karrierës dhe Alumnit. - Evidenca 5.12 Udhëzuesi i Karrierës - Evidenca 5.10 Rregullore Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët. - Evidenca 2.4 Vendim për caktimin e koordinatorit të programit Master "Infermeiri Kirurgjikale". - Evidenca 2.13 Të dhëna mbi aktivitetet 2019-2023. - Evidenca 5.13 Aktivitete ekstrakurrikulare. - shtese 7. Listë e aktiviteteve të organizuara nga zyra e Karrierës dhe Alumni
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Nga takimi i GVJ me studentët u konstatua se Zyra e informimit dhe këshillimit të karrierës funksiononte në mënyrë të vazhdueshme duke mbajtur leksione të hapura, trajnime dhe duke përfshirë studentët në panairët e punës. Studentët referuan se ishin të kënaqur nga zyra e këshillimit të karrierës. Kjo zyrë i ndihmon ata për:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Identifikimin e burimeve për pozicione të vecanta pune; - Udhëheqje akademike; - Identifikimin e shprehive dhe aftësive; <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 2.13 Të dhëna mbi aktivitetet 2019-2023; - Evidenca 5.3 Panairi "Work&Study"; - Evidenca 5.10 Rregullore Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët; - Evidenca 5.11 Rregullore Zyra e Karrierës dhe Alumnit; - Evidenca 5.12 Udhëzuesi i Karrierës.
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e</p>	<p>GVJ konstatoi nga dokumentet dhe nga takimi me zyrën e karrierës se realizohen aktivitete si: Këshillim individual i karrierës, Organizimi i tryezave të rumbullakta, seminare, konferenca, panairët e punës, etj. Në këtë formë AU ndjek studentët pas diplomimit dhe monitoron shkallën e punësimit. Nga të dhënat e statisitkave të punësimit, rezulton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 2019-2020, 60 % e të diplomuarve janë punësuar në përputhje me diplomën. - 2020-2021, 41 % e të diplomuarve janë punësuar në përputhje me diplomën.

autoriteteve drejtuese përkatëse.	<ul style="list-style-type: none"> - 2021-2022, 36 % e të diplomuarve janë punësuar në përputhje me diplomën. <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 5.7 Rregullore Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët; - Evidenca 5.8 Rregullore Zyra e Karrierës dhe Alumnit; - Evidenca 5.12 Udhëzuesi i Karrierës; - Evidenca 5.13 Statistika të punësimit të studenteve; - Tabela Aneks RVB BSc. Infermieri. 			
Konkluzione	<p>AU ka në organigramë dhe Zyrën e Informimit dhe Zhvillimit të Karrierës. Koordinatori i programit të studimit, luan një rol të rëndësishëm në informimin dhe përditësimin e studentëve lidhur me zhvillimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të këtij programi studimi. Zyra e karrierës se realizohen aktivitete si: Këshillim individual i karrierës, Organizimi i tryezave të rrumbullakta, seminare, konferenca, panairt e punës, etj. Në këtë formë AU ndjek studentët pas diplomimit dhe monitoron shkallën e punësimit.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të	GVJ në takimin me drejtuesit e institucionit, stafin, studentët, NJSBC, referencat e vëna në dispozicion, mendon se, AU, e ka të ngritur dhe funksional, Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe nëpërmjet NJSBC-së, siguron zbatimin e një strategjie institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. AU organizon trajnime për personelin akademik në lidhje me

<p>fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>mësimdhënien në mënyrë që të realizohen metoda të ndryshme dhe inovative për mësimdhënien.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Shtese 2 Aktivitetet e organizuara për përmirësimin e aftësive mësimdhënëse dhe kërkimore shkencore të stafit.</i> - <i>Shtese 5 Axhenda e trajnimeve te stafit akademik v.a 2018-2019</i> - <i>Shtese 5 Axhenda e trajnimeve te stafit akademik v.a 2019-2020</i> - <i>Shtese 5. Axhenda e trajnimeve te stafit akademik v.a 2021-2022</i>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se NJSBC pranë AU mbështetur në rregulloren për këtë njësi synon përmirësimin e rezultateve dhe rritjen e pritshmërive në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, për të përmbushur standartet e cilësisë të përcaktuar nga AU, në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të lartë. Përmirësimi i cilësisë realizohet nëpërmjet: kontrollit të brendshëm dhe vlerësimit të jashtëm. Mekanizmat kryesorë që përdoren janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pyetori i studentëve; - Formular i performancës akademike; - Monitorimi i vazhdueshëm i procesit mësimor nga përgjegjësi i departamentit; <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Evidenca 6.9 Rregullore Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë;</i> - <i>Evidenca 1.1 Statuti i "Albanian University";</i> - <i>Evidenca 6.8 Pyetësorët e studentëve v.a 2022-2023;</i> - <i>Evidenca 4.6 Pyetësor personeli akademik v.a 2021-2022.</i> - <i>Takimi me drejtuesin e njësisë bazë</i>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>AU ka përfshirë studentët në NJSBC, GVB dhe Senat akademik ku ata kanë mundësi të japin mendimin e tyre në lidhje me vlerësimin periodik të formave të mësimdhënies, vlerësimit të dijeve dhe trajtimin e ankimeve. Studentët kontribuojnë në cilësinë e programit të studimit, edhe nëpërmjet angazhimit në Këshillat studentorë, të cilët mbajnë lidhje të ngushtë me Institucionin, Njësinë kryesore dhe vecanërisht me Njësinë bazë. AU organizon pyetësorë për studentët në lidhje me ecurinë e programit mësimor.</p>




	<p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Evidenca 6.9 Rregullore Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë;</i> - <i>Evidenca 6.8 Pyetësorët e studentëve v.a 2022-2023;</i> - <i>Evidenca H1 Ngritja e GVB.</i>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Siç u theksua më lart pranë AU funksionon NJSBC, e cila në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore zhvillon pyetsorin e studentëve. Një herë në vit kjo strukturë shpërndan pyetsorin studentor për cilësinë e mësimdhënies. Institucioni harton raportin në fund të cdo viti akademik i cili publikohet në faqen zyrtare të Universitetit, me qëllim rritjen e transparencës ndaj të gjithë aktorëve të përfshirë nga institucioni.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Evidenca 6.9 Rregullore Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë;</i> - <i>Evidenca 6.8 Pyetësorët e studentëve v.a 2022-2023;</i>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Referuar vizitës në Institucion, në takimin me stafin akademik të këtij program studimi GVJ konstatoi gadishmërinë e Institucionit për mbështetje për stafin akademik, si në funksion të realizimit të një procesi mësimor cilësor (kryesisht në infrastrukturë), ashtu edhe në funksion të kualifikimit shkencor (nxitja për pjesmarrje në konferenca shkencore brenda dhe jashtë vendit, nxitja dhe mbështetja financiare për të botuar artikuj në revista me faktor të lartë impakti- Scopus, monografi dhe botime të ngjashme shkencore). Institucioni mbështet personelin akademik duke paguar fee-në e botimit apo konferencës dhe kjo u raportua nga disa pedagogë gjatë takimit me to. Po ashtu, Institucioni ka vendosur një fond specifik për të mbështetur pedagogët në publikimin e punimeve shkencore të tyre ose për pjesmarrje në konferenca dhe aktivitete shkencore. Shpërndarja bëhet në bazë të kërkesave, mundësisë financiare si dhe në bazë të revistës ose konferencës që organizohet. Disa nga stafi akademik që morrën pjesë në takim konfirmuan se ishin mbështetur financiarisht nga AU. <i>GVJ e konsideron këtë një praktik të mirë.</i></p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Takimi me stafin akademik;</i> - <i>Takimi me drejtuesin e njësisë bazë dhe kryesore;</i> - <i>Evidenca 3.11 Informim per leksionet e hapura;</i> - <i>Evidenca 3.12 Leksionet e hapura 2019-20223;</i>



	<ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 3.13 Te dhena per kerkimin shkencor te stafit akademik; - Evidenca shtese 3 Listë e pedagogëve të cilët kanë përfituar nga fondi për publikim artikujsh si dhe vendimin për këtë politik; - Evidenca 3.14 Konferencat shkencore te departamentit 2019-2023. 								
Konkluzione	<i>AU ka të ngritur dhe funksional, Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe nëpërmjet NJSBC-së, siguron zbatimin e një strategjie institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. AU ka përfshirë studentët në NJSBC, GVB dhe Senat akademik ku ata kanë mundësi të japin mendimin e tyre në lidhje me vlerësimin periodik të formave të mësimdhënies, vlerësimin të dijeve dhe trajtimin e ankimeve. Pranë AU funksionon NJSBC, e cila në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore zhvillon pyetsorin e studentëve. Institucioni ka gadishmërinë për mbështetje për stafin akademik, si në funksion të realizimit të një procesi mësimor cilësor, ashtu edhe në funksion të kualifikimit shkencor.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	<p>Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë 80/2015 dhe Kodi i Cilësisë në Arsimin e Lartë (VKM 531/11.09.2018), institucioni ka ndërtuar politika dhe procedura si dhe ka ngritur struktura për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Politikat dhe procedurat për sigurimin e cilësisë janë sanksionuar në statutin e AU dhe në rregulloren e institucionit. Gjatë guidës në institucion GVJ u informua se në mënyrë të vazhdueshme, realizohet një pyetësor anonim me studentët, me disa rubrika për mësimdhënien, programin, korrektësinë e stafit, ky vlerësim menaxhohet nga, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</p> <p>Evidenca:</p>

	<ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 6.9 Rregullore Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë; - Evidenca 1.1 Statuti i "Albanian University"; - Evidenca 1.4 Rregullore e Përgjithshme "Albanian University"; - Evidenca 6.8 Pyetësorët e studentëve v.a 2022-2023; - Evidenca 4.6 Pyetësor personeli akademik v.a 2021-2022.
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>AU ka në organigramë Njësisë së Brendshme të Sigurimit të cilësisë e cila siguron zhvillimin e cilësisë së arsimit. Kjo strukturë përbëhet nga 5 anëtarë ku njëri është student. GVJ konsideron që NJSBC të ketë në përbërje të tij dhe një aktor të jashtëm. AU bashkëpunon dhe ASCAL dhe gjithashtu ka një monitorim të përvitshëm nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve për plotësimin e standardeve, gjë që siguron funksionimin e kontrollit të cilësisë.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 6.9 Rregullore Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë;
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin dhe në vizitën në institucion GVJ konstatoi se Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në AU realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit në bashkëpunim me ASCAL. Konkretisht, AU ka plotësuar standartet institucionale dhe është akredituar me VBA Nr. 32 datë 19.05.2017. Programi i studimi Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale", është duke kaluar procesin e akreditimit periodik.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.2 Vendim i BA per akreditimin. Certificate
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për</p>	<p>GVJ konstatoi se AU ka një komunikim të mirë nga poshtë lart dhe anasjelltas. Gjithashtu me anë të kontrollit të cilësisë dhe raportimit të tyre, AU arrin të promovojë arritjet më të mira. NJSBC përpunon të dhënat duke llogaritur tregues sasior dhe cilësor në lidhje me cilësinë e procesit mësimor në këtë institucion. Raportet e përgatitur iu dërgohen të gjithë strukturave sipas përcaktimeve në rregulloren e kësaj njësie. Strukturat drejtuese dhe në vecanti Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë përgjegjës për këtë program studimi, marrin vendimet përkatëse në funksion të përmirësimit të cilësisë dhe mbarëvajtjes së programit studimor.</p>

arritjet më të mira në programin e studimit.	<p><i>Nga raportet vërehet se ka një vëmendje më të rritur ndaj infrastrukturës informatike dhe pasurimit të bibliotekës së AU-së.</i></p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 2.11 Raport semestral Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë 2021-2022; - Evidenca 2.12 Raport vjetor Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë 2021-2022. 							
Konkluzione	<p><i>Institucioni ka ndërtuar politika dhe procedura si dhe ka ngritur struktura për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Politikat dhe procedurat për sigurimin e cilësisë janë sanksionuar në statutin e AU dhe në rregulloren e institucionit. AU ka në organigramë Njësisë së Brendshme të Sigurimit të cilësisë e cila siguron zhvillimin e cilësisë së arsimit. Kjo strukturë përbëhet nga 5 anëtarë ku njëri është student. GVJ konsideron që NJSBC të ketë në përbërje të tij dhe një aktor të jashtëm. Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë përgjegjës për këtë program studimi, marrin vendimet përkatëse në funksion të përmirësimit të cilësisë dhe mbarëvajtjes së programit studimor. AU ka një komunikim të mirë nga poshtë lart dhe anasjelltas.</i></p>							
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	<table border="1"> <tr> <td>Përmbushet pjesërisht</td> </tr> </table>	Përmbushet pjesërisht	<table border="1"> <tr> <td>Përmbushet kryesisht</td> </tr> </table>	Përmbushet kryesisht	<table border="1"> <tr> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> </table>	Përmbushet plotësisht
Nuk përmbushet								
Përmbushet pjesërisht								
Përmbushet kryesisht								
Përmbushet plotësisht								
				X				

<p>Standardi VI.3 Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe</p>	<p>Të gjitha gjetjet e vlerësimit semestral apo vjetor janë pjesë e raportit të njësisë bazë. GVJ konstatoi se AU kryen një vlerësim të brendshëm vjetor që përfshin gjithë programet, njësitë kryesore/bazë dhe ndihmëse që e paraqet në një raport vjetor të Universitetit i cili gjithashtu dërgohet në MAS. Kontrolli i përvitshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve garanton plotësimin e standarteve.</p> <p>GVJ konstatoi se nga informacion i marrë nga UISH, kalueshmëria e studentëve të diplomuar infermierë ishte e lartë. Provimi i UISH është një indikator i fuqishëm për të matur performancën e objektivave të arritura nga programi i studimit.</p>

<p>arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Evidenca 1.11 Raport semestral Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë 2021-2022;</i> - <i>Evidenca 1.12 Raport vjetor Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë 2021-2022;</i> - <i>Tabela aneks-RVB- MP.I.Kirurgjikale</i>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, dokumentacionit shoqërues dhe informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion, rezultoni se në mbledhjet e departamentit në fund të çdo semestri dhe çdo viti mësimor analizohet ecuria dhe mbarëvajtja e gjithë procesit mësimor, si dhe problematikat e evidentuara nga pyetësorët e studentëve dhe pyetësorët për stafin akademik. Ky informacion përfshihet në raportin e analizës vjetore të veprimtarisë së departamentit që u komunikohet strukturave të AU sipas parashikimeve të kuadrit rregullator përkatës. Në fund bëhet një analizë mbi gjetjet dhe shprehen mundësitë e përmirësimit dhe rekomandohen plan masat. Raportet tregojnë se procesi në përgjithësi është i mirë dhe nuk kanë ndonjë problematikë gjatë ecurisë së tyre.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Evidenca 2.11 Raport semestral Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë 2021-2022;</i> - <i>Evidenca 2.12 Raport vjetor Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë 2021-2022;</i> - <i>Tabela aneks-RVB- MP.I.Kirurgjikale.</i>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në</p>	<p>GVJ konstatoi se AU përdor metoda të drejtpërdrejta për vlerësimin e cilësisë dhe mbarëvajtjen e programit. Diskutimet e hapura të stafit akademik me studentët në lidhje me procesin mësimor, cilësinë e mësimdhënies, të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësimeve të provimeve apo detyrave të kurseve, etj. janë metoda e drejtpërdrejta që AU përdor të siguruar vlerësimin e cilësisë. Gjithashtu dhe informacioni i marrë nga UISH. AU përdor pyetësorët për të monitoruar cilësinë e mësimdhënies.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Evidenca 3.9 Raport semestral i pedagogut;</i>

<p>auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testimet lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testimet ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 2.11 Raport semestral Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë 2021-2022; - Evidenca 2.12 Raport vjetor Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë 2021-2022; - Evidenca 3.9 Raport semestral i pedagogut; - Evidenca 3.5 Pyetësor personeli akademik v.a 2021-2022; - Evidenca 6.7.b Pyetësorët e studentëve v.a 2020-2021; - Evidenca 6.7.b Pyetësorët e studentëve v.a 2021-2022; - Evidenca 6.7.b Pyetësorët e studentëve v.a 2022-2023; - Tabela Aneks RVB BSc. Infermieri; - Tabela aneks-RVB- MP.I.Kirurgjikale.
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program.</p>	<p>AU në kuadër të vlerësimit të cilësisë për programet e studimit përdor mekanizmat e mëposhtëm kryesorë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Sondazhe nëpërmjet pyetësorëve të studentëve; - Sistemi i Tutorëve/Kujdestarëve të Grupeve të studentëve; - Raportet e stafit akademik gjatë vitit shkollor dhe Informacioni nga UISH në lidhje me rezultatet në provimin e licencës; <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 3.5 Raport semestral i personelit akademik; - Evidenca 6.8 Pyetësorët e studentëve v.a 2022-2023; - Evidenca 1.11 Raport semestral Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë 2021-2022; - Evidenca 1.12 Raport vjetor Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë 2021-2022; - Evidenca 5.9 Pyetësori i studenteve "Alumni".
<p>Konkluzione</p>	<p>AU kryen një vlerësim të brendshëm vjetor që përfshin gjithë programet, njësitë kryesore/bazë dhe ndihmëse që e paraqet në një raport vjetor të Universitetit i cili gjithashtu dërgohet në MAS. Diskutimet e hapura të stafit akademik me studentët në lidhje me procesin mësimor, cilësinë e mësimdhënies, të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësimeve të provimeve apo detyrave të kurseve, etj, janë metoda e drejtpërdrejtë që AU përdor të sigurar vlerësimin e cilësisë. Gjithashtu përdor edhe mekanizma të tërthorta sic janë pyetësorët e studentëve apo stafit akademik.</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Sipas rregullores së NJSBC në përbërje të tij ka 5 anëtarë ku një është përfaqësues të studentëve. <i>GVJ konsideron që në mënyrë që të garantohet se politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshijnë aktorë të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit duhet që njëri nga antarët e NJSBC të jetë i jashtëm.</i> Struktura më e aktive në këtë proces është NJSBC, e cila bashkëpunon ngushtë me të gjithë strukturat e tjera dhe vecanërisht me njësinë bazë, për përmirësimin e rezultateve dhe rritjen e pritshmërive në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, në përputhje me standardet e cilësisë së AU, si dhe në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë. Studentët janë të përfaqësuar në Senatin e UAL, në NJSBC, si dhe në hartimin e RVB për vlerësim të jashtëm pranë ASCAL.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 6.9 Rregullore Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë;
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palët tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Në takimin e realizuar me stafin dhe studentët, GVJ u informua se studentët përfshihen në vlerësimin periodik institucional përmes anketimit. Në rregulloret e institucionit dhe në rregulloren e programit të studimit janë përcaktuar qartë detyrat konkrete për pozicionet individuale dhe njësitë në raport me sigurimin e cilësisë. Sigurimi i brendshëm i cilësisë së programit të studimit, është konceptuar si përgjegjësi dhe angazhim lidhur me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Harmonizimin e veprimtarisë të të gjithë strukturave drejtuese për të garantuar cilësinë e programit të studimit; - Sigurimin e burimeve njerëzore dhe infrastrukturës për të garantuar dhe përmirësuar cilësinë e programit të studimit;

	<ul style="list-style-type: none"> - Përcaktimin e parimeve, standardeve dhe procedurave të përshtatshme për monitorimin, vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë. <p>GVJ konstatoi se të gjithë aktorët e përfshirë në proces ishin të bashkëpunues dhe të koordinuar për të realizuar një proces sa më korrekt me vetëbesim për punën dhe kapacitetet e tyre. Institucioni tregoi aftësi menaxhuese dhe drejtuese largpamëse dhe përforcoi ndjesinë pozitive se stafi jep më të mirën duke punuar e bashkëvepruar konform rregullave, në harmoni të plotë.</p> <p>Studentët u shprehën entuziastë për programin e studimit. Ata referuan se janë të përfshirë në vetëvlerësim përmes pyetësorëve, propozimeve të këshillit studentor si dhe përmes përfaqësuesve të tyre në GVB.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Evidenca 6.9 Rregullore Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë;</i> - <i>Evidenca 1.4 Rregullore e Përgjithshme "Albanian University";</i> - <i>Evidenca 1.5 Rreg e Fakultetit të Shkencave Mjekësore.;</i> - <i>Evidenca 1.6 Rregullore Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë;</i> - <i>Evidenca 6.8 Pyetësorët e studentëve v.a 2022-2023.</i> - <i>Evidenca HI Ngritja e GVB.</i>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademi dhe administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>GVJ, gjatë vizitës në institucion dhe bisedave të zhvilluara, me drejtues, stafin akademik, studentët konstaton dhe mund të pohojmë një gjithëpërfshirje në procesin e veprimtarisë së NJSBC të pedagogëve, stafit administrativ, të cilët organizohen në mbledhje të vazhdueshme mujore të Departamentit si hallka e parë e shprehjes së nevojave për përmirësime apo ndryshime në programet e studimit. GVJ konstatoi se në përbërje të NJSBC ka përfaqësues të njësisë kryesore, njësisë bazë, anëtarë të personelit akademik dhe përfaqësuesin e studentëve.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Evidenca 6.9 Rregullore Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë;</i> - <i>Evidenca 6.8 Pyetësorët e studentëve v.a 2022-2023.</i> - <i>Evidenca 5.9 Pyetësori i studentëve "Alumni".</i> - <i>Evidenca 4.6 Pyetësori personeli akademik v.a 2021-2022.</i>

<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>GVJ mendon se AU është i angazhuar në respektimin e integritetit akademik dhe në shmangien e çdo diskriminimi apo pabarazie të të gjithë palëve në këtë proces vlerësimi. Përzgjedhja e aktorëve të brendshëm në proceset periodike të vlerësimit bëhet nga personeli akademik ku merren parasysh disa kritere të përfshirjes si, performanca akademike, integriteti, kompetencat profesionale; mundësitë për grumbullimin e informacionit dhe përpunimin e tij me qëllim realizimin e vlerësimeve të ndryshme. Instrumenti kryesor i vlerësimit të programit të studimit, pyetsori, është realizuar në kushte të plota anonimiteti. Nuk janë referuar ankesa nga personeli apo studentët për diskriminim apo pabarazi. Në procesin e vlerësimit respektohet integriteti akademik dhe shmanget çdo lloj forme diskriminimi apo pabarazie kundrejt stafit akademik apo studenteve.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 6.9 Rregullore Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë; - Evidenca 6.8 Pyetësorët e studentëve v.a 2022-2023. - Evidenca 4.6 Pyetesor personeli akademik v.a 2021-2022.
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Qëllimi i NJSBC është arritja e objektivave strategjike në përputhje me vizionin dhe misionin e institucionit. NJSBC funksionon me bazë Rregulloren për Sigurimin e Cilësisë; legjislacionit në fuqi, si dhe rregulloreve të brendshme të AU dhe Statutit të AU. Po ashtu dhe vlerësimi i jashtëm i cili koordinohet nga ASCAL shërben për sigurimin të cilësisë, në lidhje me programin e studimit. Ky vlerësim kryhet nëpërmjet hartimit të raporteve të vlerësimit të brendshëm, dhe më pas nga GVJ me anë të RVJ, pasqyrohet gjendja aktuale dhe jepen rekomandime me qëllim përmirësim të përmbushjes së standardeve të cilësisë. GVJ konstatoi se detyrat dhe roli i anëtarëve të NJSBC përcaktohen në rregulloren e funksionimit të NJSBC.</p> <p>GVJ konsideron që në përbërje të NJSBC duhet të jetë dhe një aktor i jashtëm.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 6.9 Rregullore Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë; - Evidenca 1.1 Statuti i "Albanian University" - Evidenca 1.4 Rregullore e Përgjithshme "Albanian University";

Konkluzione	<p><i>Sipas rregullores së NJSBC në përbërje të tij ka 5 anëtarë ku një është përfaqësues të studentëve. Struktura më e aktive në këtë proces është NJSBC, e cila bashkëpunon ngushtë me të gjithë strukturat e tjera dhe vecanërisht me njësinë bazë, për përmirësimin e rezultateve dhe rritjen e pritshmërive në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, në përputhje me standardet e cilësisë së AU, si dhe në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë. Në rregulloret e institucionit dhe në rregulloren e programit të studimit janë përcaktuar qartë detyrat konkrete për pozicionet individuale dhe njësitë në raport me sigurimin e cilësisë. Nuk janë referuar ankesa nga personeli apo studentët për diskriminim apo pabarazi. Në procesin e vlerësimit respektohet integriteti akademik dhe shmangjet cdo lloj forme diskriminimi apo pabarazie kundrejt stafit akademik apo studenteve. GVJ konsideron që në përbërje të NJSBC duhet të jetë dhe një aktor i jashtëm.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	<p>GVJ konstatoi se aktiviteti, programi, rregullore të ndryshme të funksionimit të AU janë të aksesueshëm nga i gjithë stafi akademik, ndihmës-akademik dhe studentët si dhe çdo informacion në lidhje me politikat dhe praktikrat që lidhen me sigurimin e Cilësisë në AU. Këto të dhëna janë transparente dhe publike për të gjithë palët e interesuara. Këto shfaqen në faqen zyrtare web të AU.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.4 Rregullore e Përgjithshme “Albanian University”; - Evidenca 1.5 Rreg e Fakultetit të Shkencave Mjekesore.; - Evidenca 1.6 Rregullore Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë; - Evidenca 1.7 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”;

<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>GVJ nga kontakti me përfaqësues të institucionit dhe shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar prej AU konstaton se institucioni respekton lirinë dhe etikën akademike dhe po ashtu të dhënat personale. AU ka të miratuara rregullore të funksionimit të programeve si dhe për ruajtjen e të dhënave ku përcaktohet detyrimi për mbrojtjen e të dhënave. Në faqen web publikohen të gjitha politikat dhe praktikrat e sigurimit të cilësisë të cilat janë të aksesueshme për të gjithë. Në takim me drejtues të institucionit sic jemi shprehur dhe në standartet e mësipërme, GVJ u informua se, NJSBC kryhen në mënyrë periodike shpërndarjen e pyetësorëve për të cilët është punuar edhe menduar që të jenë të personalizuar. Ato shpërndahen në mënyrë elektronike anonime me link përpara fillimit të sezonit të provimeve. Informacioni i mbledhur i vihet në dispozicion drejtuesve të njësive bazë. Institucioni publikon raportin e vetëvlerësimit të brendshëm për akreditimin institucional në faqen zyrtare web për të gjithë aktorët që kanë lidhje me universitetin dhe publikun e interesuar.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Evidenca 3.14 Faqja WEB e universitetit.</i> - <i>Evidenca 6.9 Rregullore Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë;</i>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Njësia e brendshme e sigurimit të cilësisë çdo fund viti akademik publikon raportin vjetor i cili i përcillet senatit akademik. Ky raport i dorëzohet Rektorit i detajuar, ndërsa publikohet një përmbledhje e tij pa emra konkret.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Evidenca 1.14 Raport Vjetor Institucional 2021-2022.</i> - <i>Evidenca 6.9 Rregullore Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë;</i>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se AU për të siguruar monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së programit të studimit, mbledh Senatit Akademik të AU për të monitoruar implementimin e përmirësimit të procesit mësimor, ku hartohen dhe një raport vjetor. Në këtë raport shqyrtohen problematikat dhe veprimet që duhen të ndërmerren për të siguruar përmirësimin.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Evidenca 1.14 Raport Vjetor Institucional 2021-2022.</i>



<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton një punë të mirë të bërë nga grupi i NJSBC, Tutori akademik si dhe përgjegjësi i programit në lidhje me ndërgjegjësimin për sigurimin e cilësisë në programin mësimor. Këto aktivitete bëhen dy herë në vit, në fund të semestrit të parë dhe në fund të vitit akademik.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.14 Raport Vjetor Institucional 2021-2022; - Evidenca 1.16 Relacion i tutoreve për praktikat; - Evidenca 3.5 Raport semestral i personelit akademik.; - Evidenca 1.11 Raport semestral Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë 2021-2022; - Evidenca 1.12 Raport vjetor Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë 2021-2022. 			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Aktiviteti, programi, rregullore të ndryshme të funksionimit të AU janë të aksesueshëm nga i gjithë stafi akademik, ndihmës-akademik dhe studentët si dhe çdo informacion në lidhje me politikat dhe praktikat që lidhen me sigurimin e Cilësisë në AU. AU konstaton se institucioni respekton lirinë dhe etikën akademike dhe po ashtu të dhënat personale. AU ka të miratuara rregullore të funksionimit të programeve si dhe për ruajtjen e të dhënave ku përcaktohet detyrimi për mbrojtjen e të dhënave. AU për të siguruar monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së programit të studimit, mbledh Senatin Akademik të AU për të monitoruar implementimin e përmirësimit të procesit mësimor, ku hartohen dhe një raport vjetor.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
---	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	--



Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Albanian University.”

Pikat e forta dhe afirmime

1. Numër i lartë i studentëve i regjistruar në këtë program studimi.
2. Staf i akademik dhe procesi i mësimdhënies vlerësohet rregullisht nga Drejtuesi i Departamentit dhe studentët.
3. Krijimi i një fondi specifik për stafin akademik për të financuar publikimin e punimeve shkencore.
4. Hartimi i raportit semestral të pedagogut, në fund të semestrit me informacione mbi mësimdhënien dhe zhvillimin e saj.
5. Institucioni i ofron studentëve në nevojë mbështetje ekonomike përmes bursave.

Pika të dobta

1. Mungesa e stafit akademik infermior me tituj akademik dhe grada shkencore (I.2, Kriteri 1; II.2, Kriteri 1; IV.1, Kriteri 1; IV.1, Kriteri 3).
2. Programi nuk mbulohet me 70% nga stafi akademik me kohë të plotë sipas VKM 41\2018 (IV.1, Kriteri 2).
3. Mos përfshirja e institucioneve partnere, studentëve alumni dhe Urdhërit të Infermierit në përditësimin e programit të studimit (II.4 Kriteri 5; II.5, Kriteri 1; II.5, Kriteri 2; II.5, Kriteri 3).
4. Mungesa e mobiliteteve të stafit akademik dhe studentëve në IAL jashtë vendit (II.4, Kriteri 4; III.4, Kriteri 4).
5. Pasurimi i bibliotekës ishte bërë në vitin 2018 për herë të fundit dhe përditësimin i fundit i bibliotekës është realizuar me libra të viteve 2015 e më herët (IV.3, Kriteri 1; IV.3, Kriteri 2; IV.3, Kriteri 3).
6. Në raportin vjetor të Institucionit, Njësia Bazë nuk raporton asnjë marrëveshje me IAL brenda apo jashtë vendit (I.3, Kriteri 2).

Rekomandime

1. Të ulen orët laboratorike dhe të rriten orët e praktikës;
2. Përditësimi i rregullt i syllabuseve dhe sidomos i literaturës së përdorur;



3. Të rritet numëri i mobiliteteve të stafit akademik dhe studentëve në kuadër të programeve Erasmus+ si dhe numëri i marrëveshjeve të bashkëpunimit me IAL jashtë vendit.
4. Të rritet bashkëpunimi me Urdhërin e Infermierit dhe të përfshihen studentët alumni dhe institucione të tjera në përmirësimin/përditësimin e programit të studimit.
5. Të pasurohet biblioteka e Institucionit me literaturë bashkëkohore.
6. Institucioni të rrisi numërin e aplikimeve në projekte kombëtare e ndërkombëtare.
7. GVJ konsideron se Institucioni duhet të ketë në përbërjen e vet staf ndihmës akademik të brendshëm, dhe jo ato që janë përgjegjës në mbikqyrjen e praktikave mësimore në spitale dhe qendra shëndetsore. Gjithashtu të rritet numri i tyre duke qenë se një person nuk është mjaftueshëm.
8. GVJ konsideron të rëndësishme rritjen e trajnimeve të mësimdhënies, specifikisht për anëtarët e këtij programi studimi.
9. GVJ konsideron që NJSBC të ketë në përbërje të tij dhe një aktor të jashtëm.
10. Të nënshkruhet marrëveshje bashkëpunimi me QSUT-në.
11. Të gjitha njësitë ndihmës akademik dhe administrative të hartojnë rregulloren e vet.
12. Të vendosen në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit.

Evaluation's conclusions for the second cycle study program Professional Master "Surgery Nursing" provided by the Higher Education Institution "Albanian University"

Strengths and affirmations

1. High number of enrolled students in this study program.
2. Regular evaluation of the academic staff and of the teaching process conducted by the Head of the Department and the students.
3. Establishment of a specific fund to finance the publication of scientific works of the academic staff.
4. The semestral report that is done by the academic staff at the end of each semester which includes information on the teaching process and its implementation.
5. The institution supports financially with scholarships the students in need.

Weaknesses

1. Absence of nursing staff with academic titles and scientific degrees (I.2, Criterion 1; II.2, Criterion 1; IV.1, Criterion 1; IV.1, Criterion 3).
2. The program is not covered by 70% of full-time academic staff according to DCM 41\2018 (IV.1, Criterion 2).
3. Non-inclusion of partner institutions, alumni and of the Nursing Order in the update of the study program (II.4 Criterion 5; II5, Criterion 1; II5, Criterion 2; II5, Criterion 3).
4. Lack of academic staff and students' mobility in HEIs abroad (II.4, Criterion 4; III.4, Criterion 4).
5. The enrichment of the library was done in 2018 for the last time and the last update of the library was carried out with books from 2015 and earlier (IV.3, Criterion 1; IV.3, Criterion 2; IV.3, Criterion 3).
6. In the Institution's annual report, the Basic Unit does not report any agreements with HEIs inside or outside the country (I.3, Criterion 2).

Recommendation

1. Reduce laboratory hours and increase practice hours.
2. Updating regularly the syllabuses and especially of the literature used.
3. Increase the number of mobility of academic staff and students within the Erasmus+ programs as well as the number of agreements with HEI outside Albania.
4. Increase the cooperation with the Nursing Order and involve alumni students and other institutions and stakeholders in improving/updating the study program.
5. To enrich the Institution's library with contemporary literature.
6. The institution should increase the number of applications in national and international projects.
7. EEC considers that the Institution should have in its composition internal academic support staff, and not those who are responsible for supervising teaching practices in hospitals and health centers. Also increase their number, since one person is not enough.
8. EEC considers it important to increase training activities, especially for the staff of this study program.
9. EEC considers that the Quality Assurance Unit could have in its composition an external actor in its composition.



10. To sign a cooperation agreement with QSUT.
11. All academic and administrative units should draw up their own regulations.
12. The Institution needs to implement electronic testing and evaluation systems.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

